REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

# RAPORT
# I VEPRIMTARISË SË
# ASHK VITI 2024

## Hyrje

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) organizohet dhe funksionin si institucion publik me vetëfinancim në varësi të Kryeministrit. ASHK është përgjegjëse për administrimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme dhe ofrimin e shërbimeve kadastrale dhe përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë.

Struktura dhe organika e ASHK në nivel qendror dhe vendor është miratuar së fundmi me Urdhrin e Kryeministrit nr.110, datë 16.07.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, i ndryshuar me Urdhrin nr.147, datë 01.08.2024. Aktualisht sipas kësaj strukture ASHK përbëhet nga 22 Drejtori Vendore dhe 3 Zyra Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme, struktura e së cilës ka në përbërje 10 drejtori dhe 23 sektor sa vijon:

- Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes
- Drejtoria për Median dhe Marrëdhëniet me Publikun
- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
- Drejtoria e Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar
- Drejtoria e Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë
- Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Menaxhimit të Sistemeve
- Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor
- Drejtoria e Financës
- Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve
- Drejtoria e Statistikave dhe Performancës

Aktiviteti i ASHK gjatë vitit 2024 është përqendruar në realizimin e objektivave të institucionit dhe kryesisht në këto drejtime kryesore:

- Përmirësimi dhe dhënia e shërbimeve kadastrale cilësore dhe brenda afateve të përcaktuara;
- Legalizimi i ndërtimeve informale dhe trajtimi i çështjeve të pronësisë;
- Intensifikimi në funksion të përmbylljes së procesit të regjistrimit fillestar, përmirësimit të të dhënave të regjistrit, digjitalizimit të dokumentacionit, kartelave dhe hartave kadastrale, hartimit të projektakteve për kalimin e të drejtës së pronësisë (parcela ndërtimore) dhe kompensimit të pronave;
- Menaxhimi, përmirësimi dhe sigurimi i sistemeve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit në funksion të regjistrimit të pasurive, proceseve kalimtare të pronësisë;
- Menaxhimi dhe shpërndarja e burimeve dhe të ardhurave;
- Plotësimi i stafit të burimeve njerëzore dhe shpërndarja e burimeve njerëzore në mënyrë eficente për realizimin e proceseve administrative të ngarkuara nga ligji, përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet rikonstruksionit të ambjenteve të drejtorive/zyrave vendore të ASHK-së, si dhe kompletimin e tyre me pajisje elektronike, orendi, etj;
- Prioritizimi dhe rritja e bashkëpunimit me të gjitha institucionet në funksion të procesit të identifikimit dhe përgatitjes së propozimeve të projektakteve në KM për kalimin në përgjegjësi administrimi/pronësi të pronave të paluajtshme të institucioneve shtetërore qëndrore apo organeve të vetëqeverisjes vendore.
- Ngritja e kapaciteve të ASHK nëpërmjet trajnimit të punonjësve.

## PASQYRA

**I. TË DHËNAT STATISTIKORE MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE KADSTRALE DHE PROCESEVE KALIMTARE**
Metodologjia dhe burimet e të dhënave
Indikatorët
Statistika lidhur me shërbimet kadastrale dhe proceset kalimtare

**II. MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE PUBLIKUN**
Objektivat kryesore
Aktivitet kryesore dhe rezultat e arritura
Rekomandime për vijimësinë

**III. AUDITIMI I BRENDSHËM**
Gjetjet kryesore sipas sistemeve
Rekomandimet e propozuara

**IV. MONITORIMI I REGJISTRIMIT FILLESTAR DHE PROCESIT TË KOMPENSIMIT**
Evidenca e ecurisë së procesit të regjistrimit fillestar
Evidenca e ecurisë së procesit të hartimit të drafteve të VKM të kompensimit të pronarëve
Ecuria e procesit të analizës dhe vlerësimit të pasurive

**V. MONITORIMI I TITUJVE TË PRONËSISË -PROCESET KALIMTARE**
Analizë sipas fushës së veprimtarisë dhe kompetencave
Problematika të konstatuara

**VI. HARTIMI I LEGJISLACIONIT, KONTOROLLI TEKNIKO-LIGJOR, ANTIKORRUPSIONI DHE ÇËSHTJET GJYQËSORE**
Aktet nëligjore dhe aktet e brendshme të miratuara dhe marrëveshjet e bashkëpunimit
Evidence e monitorimit të veprimtarisë së DVASHK përmes kontrolleve sporadike dhe periodike
Evidencë e trajtimit të kërkesë ankesave
Evidencë e çështjeve gjyqësore

**VII. BUXHETI DHE MENAXHIMI FINANCIAR**
Të ardhurat
Shpenzimet

**VIII. APELIMI DHE BASHKËQEVERISJA**
Evidencë nga sistemi i menaxhimit të ankesave nga Bashkëqeverisja
Analizë e tematikave të kërkesë/ankesave dhe evidencë e trajtimit të ankesave nga Apelimi
Problematika e konstatuara dhe rekomandime

**IX. SHËRBIMET, INVESTIMET DHE BURIMET NJERËZORE**
Evidenca e procedurave të prokurimit
Evidenca e trajtimit të nevojave të institucionit në drejtim të infrastrukturës për përmirësimin e ambjenteve të ushtrimit të veprimtarisë (godinave) të disa drejtorive/zyrave

Evidenca e burimeve njerëzore

## X. ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I SISTEMEVE

Analizë mbi procesin e krijimit dhe administrimit të përdoruesve, menaxhimi i komunikimeve dhe ndërveprimeve ndërinstitucionale, menaxhimi i riskut në sistem dhe suporti teknik

Objektiva për vitin 2025

## XI. EVIDENCA E PROCESIT TË INVENTARIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË PRONAVE SHTETËRORE

Evidenca në lidhje me procesin e invetarizimit dhe përditësimit të pronave shtetërore për institucionet qendrore dhe njësite e vetëqeverisjes vendore

# I. TË DHËNA STATISTIKORE MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE KADASTRALE DHE PROCESEVE KALIMTARE

Veprimtaria e Drejtorisë se Projekteve dhe Statistikave mbështetet në grumbullimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave nga:

- Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Sistemeve.
- Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së.
- Sistemi elektronik ALBSCAD, Skeda Digjitale dhe Moduli i Vendimeve të Legalizimit.

Të dhënat e mbledhura përpunohen në baza mujore për të ndërtuar raportime periodike, që shërbejnë si instrument për matjen dhe vlerësimin e performancës.

## 1. Metodologjia dhe Burimet e të Dhënave

Analiza bazohet në të dhëna statistikore të gjeneruara nga:

- Sistemi elektronik ALBSCAD.
- Skeda Digjitale e aplikimeve.
- Raportimet mujore të Drejtorive/Zyrave vendore.
- Moduli elektronik i vendimeve të legalizimit.

Periudha e analizuar: **2020–2024**, duke marrë vitin 2020 si pikë referimi për shkak të kalimit të shërbimeve online përmes portalit **e-Albania**.

## 2. Analiza e treguesit

### 3.1. Aplikimet për shërbimet kadastrale

**Përshkrimi i indikatorit**
Evidentimi i realizimit të treguesit të performancës për indikatorin "Shërbimet e Kadastrës" realizohet nëpërmjet të dhënave të marra nga databaza e aplikimeve të sistemit ALBSCAD të ASHK-së. Këto të dhëna administrohen dhe përcillen nga Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut, i cili ka përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe përpunimin e tyre.
Si vit fillestar i analizës është marrë vitit 2020, i cili përkon me vitin kur u mundësua kryerja e të githë aplikimeve online nëpërmjet portalit e-Albania.

**Vlera analitike**
Indikatori në fjalë mat volumin e përgjithshëm të aplikimeve të kryera nga qytetarët për shërbime kadastrale, duke shërbyer si bazë për vlerësimin e performancës së ofrimit të këtyre shërbimeve.
Raportimi dhe analiza e treguesve kryhen për periudhën 2020–2024, duke mundësuar një pasqyrë të qartë dhe të qëndrueshme të tendencave dhe ecurisë në kohë të kërkesave për shërbimet kadastrale.

**Tabela Nr. 1**

| Viti | Nr. total aplikime |
|---|---|
| 2020 | 295,146 |
| 2021 | 433,615 |
| 2022 | 475,260 |
| 2023 | 483,867 |
| 2024 | 449,702 |

**Grafiku Nr.1**




### 3.2. Koha mesatare e dhënies së shërbimit.

**Përshkrimi i indikatorit**

Ky tregues mat kohën mesatare (në ditë kalendarike) për përfundimin e një shërbimi të ofruar nga sportelet e shërbimeve kadastrale. Ai përcaktohet si diferenca ndërmjet datës së aplikimit nga qytetari dhe datës së përfundimit të shërbimit, pa marrë parasysh datën kur është kryer pagesa përkatëse.

Përllogaritja përfshin të gjitha aplikimet e regjistruara gjatë vitit përkatës, si ato që kanë marrë përgjigje, ashtu edhe ato që nuk janë trajtuar brenda vitit. Për aplikimet që mbeten pa përgjigje deri në fund të vitit, si datë përfundimtare e shërbimit merret data **31 Dhjetor** i atij viti.

**Vlera analitike**

Ky indikator ofron një vlerësim të qartë mbi efikasitetin e ofrimit të shërbimeve, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim në proceset operacionale.

**Tabela Nr. 2**

| Koha mesatare e dhënies së shërbimit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
| Ditë kalendarike | 24 | 23 | 21 | 14 | 22 |

**Grafiku Nr. 2**




### 3.3.Aplikimet me përgjigje.

**Përshkrimi i indiaktorit**

Ky indikator mat numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të cilave u është dhënë përgjigje nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së brenda vitit kalendarik përkatës. Ai përfshin çdo aplikim që është përmbyllur me një vendimmarrje administrative, pavarësisht nga koha e pritjes apo lloji i shërbimit të kërkuar.

Në përllogaritjen e këtij treguesi nuk përfshihen aplikimet që kanë mbetur në proces, pa u trajtuar deri në fund

të vitit referues.

**Vlera analitike**
Qëllimi i treguesit është të evidentojë efikasitetin operacional të sistemit të shërbimeve kadastrale dhe kapacitetin institucional për përpunimin dhe përmbylljen e kërkesave të qytetarëve. Ky tregues është i rëndësishëm për:

- Vlerësimin e përqindjes së përpunimit krahasuar me fluksin hyrës të aplikimeve;
- Matjen e kapacitetit të përgjigjes institucionale në kohë reale;
- Identifikimin e mbingarkesës ose pengesave në ciklin e ofrimit të shërbimeve.

**Tabela Nr. 3**

| Viti | Me përgjigje | Aplikime me përgjigje në % |
|---|---|---|
| 2020 | 291,587 | 98.8% |
| 2021 | 428,852 | 98.9% |
| 2022 | 473,303 | 99.59% |
| 2023 | 480,410 | 99.23% |
| 2024 | 437,365 | 97.26% |

**Grafiku Nr.3**




**Grafiku Nr. 4**




### 3.4. Aplikime pa përgjigje.

**Përshkrimi i indikatorit**
Ky tregues pasqyron numrin e aplikimeve të paraqitura nga qytetarët që nuk janë finalizuar me dhënie shërbimi brenda vitit kalendarik. Indikatori shpreh këtë të dhënë si numër absolut dhe në përqindje, në raport me totalin e aplikimeve të regjistruara gjatë të njëjtës periudhë.

## Vlera analitike

Ky tregues shërben si një element i rëndësishëm për të vlerësuar efikasitetin dhe kapacitetin e institucionit për të përmbushur kërkesat e qytetarëve në kohë, duke ndihmuar në identifikimin e ngarkesës së papërmbushur dhe nevojave për përmirësim në menaxhimin e fluksit të aplikimeve.

**Tabela Nr. 4**

| Viti | Aplikime pa përgjigje | Aplikime pa përgjigje në % |
|---|---|---|
| 2020 | 3,559 | 1.2% |
| 2021 | 4,763 | 1.1% |
| 2022 | 1,957 | 0.4% |
| 2023 | 3,457 | 0.8% |
| 2024 | 12,337 | 2.7% |

**Grafiku Nr. 5**




**Grafiku Nr.6**




## 3.5. Aplikimet nëpërmjet portalit qeveritar E-Albania.

### Përshkrimi i indikatorit

Ky tregues mat dhe analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të realizuara përmes Portalit Qeveritar e-Albania nga qytetarët. Indikatori evidenton nivelin e përdorimit të platformës digjitale për aksesimin e shërbimeve publike dhe kontribuon në vlerësimin e shkallës së digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve nga ASHK.

### Vlera analitike

Ky tregues shërben gjithashtu për të monitoruar tendencat në sjelljen e përdoruesve dhe për të identifikuar mundësitë për rritjen e aksesit dhe përmirësimin e përvojës së qytetarëve nëpërmjet shërbimeve online.

Tabela Nr. 5

| Viti | Aplikime e-Albania |
|---|---|
| 2020 | 154,338 |
| 2021 | 189,558 |
| 2022 | 176,622 |
| 2023 | 160,902 |
| 2024 | 124,649 |

Tabela Nr. 6

| Viti | Aplikime në e-Albania në % |
|---|---|
| 2020 | 52.3% |
| 2021 | 43.7% |
| 2022 | 37.6% |
| 2023 | 33.3% |
| 2024 | 27.7% |

Grafiku Nr.7




Grafiku Nr.8




### 3.6. Aplikime nëpërmjet sistemit të Dhomës Kombëtare të Noterisë NISA.

**Përshkrimi i indikatorit**

Ky tregues mat dhe analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera përmes **sistemit elektronik NISA**, platformë në përdorim nga **Dhoma Kombëtare e Noterisë**. Aplikimet realizohen nga noterët përmes zyrave noteriale, duke mundësuar **transmetimin e sigurt, të saktë dhe në kohë reale** të të dhënave kadastrale ndërmjet institucioneve.

**Vlera analitike**

Indikatori reflekton nivelin e integrimit dhe efikasitetit të bashkëpunimit ndërinstitucional në procesin e ofrimit të shërbimeve kadastrale dhe kontribuon në përmirësimin e transparencës, sigurisë juridike dhe shpejtësisë së procedurave për qytetarët dhe profesionistët ligjorë.

**Tabela Nr. 7**

| Viti | Aplikime nga sistemi NISA |
|---|---|
| 2021 | 236,310 |
| 2022 | 296,012 |
| 2023 | 320,742 |
| 2024 | 320,551 |

**Tabela Nr. 8**

| Viti | Aplikime nga sistemi NISA në % |
|---|---|
| 2021 | 54.5% |
| 2022 | 62.3% |
| 2023 | 66.3% |
| 2024 | 71.3% |

**Grafiku Nr.9**




**Grafiku Nr.10**




## 3.7. Aplikime nëpërmjet modulit "ASHK për Institucione".

**Përshkrimi i indikatorit**

Ky tregues analizon numrin e aplikimeve për shërbime kadastrale të kryera përmes modulit "ASHK për Institucione",

një platformë elektronike e dedikuar për përdorim nga institucionet publike si palë të interesuara.
Moduli u implementua në dhjetor 2020 me qëllim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit ndërmjet ASHK-së dhe institucioneve shtetërore, në përputhje me dispozitat e Ligjit për të Drejtën e Informimit si dhe për mbështetjen e nevojave funksionale të punës së tyre.

**Vlera analitike**
Ky sistem operon paralelisht me platformën standarde dhe ofron një sërë përfitimesh, duke përfshirë:

- Përshpejtimin e marrjes së informacionit zyrtar për institucionet publike;
- Thjeshtimin e ndërveprimit, përmes mundësisë për të kryer aplikime dhe për të marrë përgjigje në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- Lehtësimin e procesit të faturimit, nëpërmjet gjenerimit automatik të faturave financiare për shërbimet e përfituara;
- Zvogëlimin e ngarkesës së sistemit qendror, duke ndarë flukset institucionale nga ato të qytetarëve, çka përmirëson ndjeshëm kohën e përgjigjes dhe efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.

**Tabela Nr. 9**

| Viti | Aplikime nga sistemi ASHK për Institucione |
|---|---|
| 2021 | 7,747 |
| 2022 | 2,626 |
| 2023 | 2,223 |
| 2024 | 4,502 |

**Tabela Nr. 10**

| Viti | Aplikime nga sistemi ASHK për Institucione në % |
|---|---|
| 2021 | 1.78% |
| 2022 | 0.55% |
| 2023 | 0.45% |
| 2024 | 1% |

**Grafiku Nr.11**




## 4. Procedura Administrative e Legalizimit

### 4.1. Legalizimi i Objekteteve Informale

**Përshkrimi i indikatorit**

Ky tregues mat numrin e objekteve të legalizuara nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së gjatë periudhës kohore 2020–2024.

**Tabela Nr. 11**

| **PERIUDHA:** | **Leje/vendime për legalizimin /moslegalizimin e objekteve pa leje sipas viteve** |
|---|---|
| 2006-2009 | 1583 |
| 2010 | 1821 |
| 2011 | 4006 |
| 2012 | 5769 |
| 2013 | 8571 |
| 2014 | 15294 |
| 2015 | 24748 |
| 2016 | 48351 |
| 2017 | 26451 |
| 2018 | 30151 |
| 2019 | 12018 |
| 2020 | 20991 |
| 2021 | 25088 |
| 2022 | 18872 |
| 2023 | 10132 |
| 2024 | 11167 |

**Grafiku Nr.12**



Procesi i legalizimit të ndërtimeve informale është një proces afatgjatë, për shkak të numrit të madh të aplikimeve të kryera nga qytetarët ndër vite (duke filluar nga viti 2005), si dhe për shkak të natyrës së ndërlikuar të këtij procesi. Procesi i Legalizimit është gjithashtu një komponent i rëndësishëm për përmbylljen e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive, i cili, sipas Ligjit Nr. 20/2020, duhet të përfundojë brenda vitit 2028.

**Vlera analitike**

Gjatë periudhës 2006–2024, Drejtoritë Vendore të ASHK-së kanë kryer verifikimin teknik dhe ligjor të aplikimeve për legalizim, duke përfunduar me:

- **265,013** vendime pozitive, pra objekte të legalizuara, dhe
- **4,270** aplikime të skualifikuara, për shkak të mosplotësimit të kritereve ligjore.

Kjo shifër është objekt i ndryshimeve në vijim për disa arsye:

- Ekziston një numër i konsiderueshëm objektesh informale që përmbushin kriteret ligjore për legalizim, por për të cilat nuk është paraqitur ende aplikim nga ana e qytetarëve;
- Në shumë raste, për të njëjtin objekt janë kryer aplikime të përsëritura ndër vite nga subjekte të ndryshme ose të njëjta, duke krijuar dublikime që krijojnë ngarkesë të shtuar në trajtim.

## 4.2. Përjashtimi nga legalizimi i ndërtimeve pa leje.

**Përshkrimi i indikatorit**

Ky tregues mat numrin e vendimeve për përjashtim nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje. Ai pasqyron ato raste kur, pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe ligjor, konstatohet se objektet nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në kuadër të legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhojë nuk mund të legalizohen.

**Vlera analitike**

Treguesi reflekton nivelin e përputhshmërisë së aplikimeve me kërkesat ligjore dhe shërben si barometer për qartësinë e informimit publik dhe cilësinë e dokumentacionit të paraqitur.

**Tabela Nr. 12**

| Viti | Vendime për Moslegalizimi |
|---|---|
| 2020 | 94 |
| 2021 | 159 |
| 2022 | 410 |
| 2023 | 187 |
| 2024 | 70 |

**Grafiku Nr.13**




## 4.3. Formalizimi i objekteve të ndërtuara para vitit 1991.

### Përshkrimi i indikatorit

Procesi i formalizimit i objekteve të ndërtuara para vitit 1991 ka për qëllim pajisjen me dokumente pronësie të banesave të ndërtuara para vitit 1991, të cilat nuk janë regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme. Ky proces përfshin ndërtesat e ndërtuara në periudha të ndryshme historike, të cilat kanë mbetur pa dokumentacion ligjor të pronësisë.

### Kuadri ligjor dhe institucional

Procesi nisi në vitin 2012, fillimisht nga Bashkitë, në bazë të VKM-së Nr. 608/2012, "*Për përcaktimin e procedurës për formalizimin e objekteve të ndërtuara pa dokumente pronësie*". Më pas, me VKM-në Nr. 442/2018, "*Për përcaktimin e procedurës së kalimit të kompetencave për formalizimin e objekteve pa dokumente pronësie*", përgjegjësitë u transferuan nga Bashkitë tek ish-ALUIZNI.

Aktualisht, procesi i formalizimit kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të Ligjit Nr. 20/2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", dhe VKM-së Nr. 827, datë 30.09.2020, "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë për objektet pa titull pronësie, tokat funksionale dhe oborret në përdorim*".

### Vlera analitike

Ky proces synon sigurimin e sigurisë juridike të pronësisë për një numër të konsiderueshëm të banesave të vjetra, duke kontribuar në përmirësimin e regjistrave pronësorë dhe stabilitetin e tregut të pasurive të paluajtshme.

**Tabela Nr. 13**

| Viti | Vendime në zbatim të VKM-së Nr. 827/2020 |
|---|---|
| 2020 | 1,521 |
| 2021 | 2,211 |
| 2022 | 1,699 |
| 2023 | 1,098 |
| 2024 | 2,337 |

**Grafiku Nr. 14**




## 5. Procesi i Regjistrimit të Tokës Bujqësore

### Përshkrim i Përgjithshëm i Procesit

Procesi i regjistrimit të tokës bujqësore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, është kompetencë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila vepron si institucioni publik përgjegjës për administrimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni. Gjithashtu, ASHK ka për detyrë koordinimin dhe bashkërendimin e të gjitha proceseve përkatëse në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, si me Ministrinë e Bujqësisë, dhe me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV), të cilat kanë rol të rëndësishëm në administrimin e dokumentacionit historik të ndarjes së tokës dhe identifikimin e përfituesve.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional është i domosdoshëm për të siguruar verifikimin e të dhënave, evidentimin e problematikave ligjore apo teknike dhe për të garantuar një proces të rregullt dhe transparent regjistrimi. Përmes Drejtorive të saj Vendore, ASHK angazhohet në mbledhjen, verifikimin dhe përpunimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve përmes platformës digjitale e-Albania.

### Problematikat në Zbatimin e Procesit të Regjistrimit të AMTP-ve

Problematikat e hasura gjatë procesit të regjistrimit të AMTP-ve evidentohen nga ASHK rast pas rasti, gjatë trajtimit të kërkesave për regjistrimin e tyre. Ky proces përfshin një shqyrtim të detajuar të kritereve të ligjshmërisë së subjektit kërkues, si dhe të llojit të tokës për të siguruar se të dhënat dhe dokumentacioni që paraqiten janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet normative në fuqi. Kryesisht, problematika më e shpeshtë e evidentuar gjatë procesit të regjistrimit të AMTP-ve nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", lidhet me mbledhjen dhe administrimin e dokumentacionit arkivor që i përket procesit të ndarjes së tokës bujqësore, i cili duhet të sigurohet nga institucionet përkatëse: DAMT, NJVV dhe Prefekti i Qarkut, në përputhje me nenin 68 të këtij ligji.

Administrimi i këtij dokumentacioni në formën e një kopjeje të njësuar me origjinalin është thelbësor për realizimin e regjistrimit të AMTP-ve, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*" dhe kriteret e përcaktuara në VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 *Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve dhe sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtesë shtetërore dhe pronat shërbyese*".

### Lëshimi i Çertifikatës së Pronësisë për Tokën Bujqësore

Lëshimi i Çertifikatës së Pronësisë për Tokën Bujqësore është një proces që kushtëzohet nga iniciativa dhe vullneti i vetë pronarit ose i personit të interesuar, për të ndërmarrë veprime individuale për të aplikuar përkatësisht për shërbimin kadastral përmes rrugëve digjitale. Ky aplikim realizohet në mënyrë elektronike, në

platformën shtetërore e-Albania, dhe ka për qëllim pajisjen me certifikatën përkatëse të pronësisë, si një dokument ligjor që vërteton të drejtën e tij mbi pronën. Ky proces zhvillohet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 111/2018 "*Për Kadastrën*", i cili rregullon veprimtarinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe marrëdhëniet juridike që burojnë prej tyre, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 13.05.2020, "*Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale*", i cili përcakton në mënyrë të detajuar procedurat dhe tarifat përkatëse të shërbimeve të ofruara nga ASHK.

**Kalimi i tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi pa shpërblim.**

Ecuria e këtij procesi ndër vite ka qënë si më poshtë:

| Viti | Nr i vendimeve për kalimin e tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi |
|---|---|
| 2022 | 15 |
| 2023 | 6 |
| 2024 | 41 |




Gjatë vitit 2024 ASHK ka vijuar procesin e kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi në drejtoritë vendore Lezhë, Fier, Kukës, Dibër dhe Shkodër.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, për DVASHK-në Shkodër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së ka funksionuar, sekretariati teknik i taskës forcës së ngritur me VKM nr. 320, datë 31. 05.2023 "Për ngritjen e task-forcës për koordinimin e procesit të trajtimit të tokave bujqësore në përdorim, në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020", i ndryshuar.

**Të dhënat Statistikore dhe Vlerësimi i Ecurisë**

Gajtë periudhës 2019 – 2024, numri i Çertifikatave të Pronësisë për Tokën Bujqësore të regjistruara pranë ASHK-së është përafërsisht 77.530 çertifikata.

**Tabela Nr. 14**

| VITI | Nr. Çertifikave për Tokën Bujqësore |
|---|---|
| 2019 | 8,311 |
| 2020 | 18,576 |
| 2021 | 22,400 |
| 2022 | 18,296 |
| 2023 | 8,320 |
| 2024 | 1,627 |
| **TOTAL** | **77,530** |

**Grafiku nr. 15**




Ky tregues reflekton nivelin e angazhimit të qytetarëve për të formalizuar të drejtën e tyre mbi pronën bujqësore, si dhe ecurinë e procesit të regjistrimit gjatë kësaj periudhe. Pajisja me Çertifikata Pronësie mbetet i ndikuar nga disa faktorë, përfshirë kompleksitetin e dokumentacionit të trashëguar, fragmentizimi i tokës, mungesën e evidencave të plota arkivore, si dhe nivelin e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të pronarëve për të ndjekur procedurat përkatëse.

Gjithashtu, përdorimi i platformës digjitale e-Albania si mënyrë e vetme për aplikimin për shërbime kadastrale ka sjellë sfida për disa qytetarë, veçanërisht në zonat rurale, për shkak të mungesës së aksesit në teknologji apo njohurive të nevojshme digjitale. Megjithatë, përpjekjet për rritjen e transparencës, lehtësimin e procedurave dhe bashkëpunimin ndërinstitucional kanë ndikuar pozitivisht në vijimin e këtij procesi.

**Më poshtë jepen në formë tabelare dhe grafike të dhënat për shërbimet kadastrale dhe proceset kalimtare për vitin 2024 :**

| SHËRBIMET KADASTRALE 2024 | | | |
|---|---|---|---|
| NR. | DREJTORITË | APLIKIME TOTAL | APLIKIME ME PËRGJIGJE |
| 1 | BERAT | 9,447 | 9,051 |
| 2 | BULQIZË | 888 | 869 |
| 3 | DEVOLL | 1,375 | 1,314 |
| 4 | DIBËR | 3,039 | 2,710 |
| 5 | DR KAMEZ - VORE | 23,566 | 23,234 |
| 6 | DR RURALE 1 | 31,059 | 30,730 |
| 7 | DR RURALE 2 | 28,045 | 27,794 |
| 8 | DR TIRANA JUG | 38,828 | 38,671 |
| 9 | DR TIRANA VERI | 57,036 | 56,729 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 10 | DURRËS | 41,959 | 40,598 |
| 11 | ELBASAN | 17,481 | 16,684 |
| 12 | FIER | 21,079 | 19,804 |
| 13 | GJIROKASTËR | 5,960 | 5,241 |
| 14 | GRAMSH | 1,240 | 1,208 |
| 15 | HAS | 440 | 432 |
| 16 | KAVAJË | 18,206 | 18,097 |
| 17 | KOLONJË | 961 | 923 |
| 18 | KORÇË | 14,901 | 13,999 |
| 19 | KRUJË | 5,370 | 5,344 |
| 20 | KUÇOVË | 2,185 | 2,149 |
| 21 | KUKËS | 2,041 | 1,995 |
| 22 | LAC | 2,904 | 2,879 |
| 23 | LEZHË | 15,518 | 14,763 |
| 24 | LIBRAZHD | 2,521 | 2,451 |
| 25 | LUSHNJE | 8,966 | 8,672 |
| 26 | MALËSI E MADHE | 1,536 | 1,530 |
| 27 | MALLAKASTËR | 1,130 | 1,074 |
| 28 | MAT | 1,216 | 1,132 |
| 29 | MIRDITË | 864 | 847 |
| 30 | PEQIN | 1,178 | 1,114 |
| 31 | PËRMET | 1,773 | 1,691 |
| 32 | POGRADEC | 9,540 | 9,520 |
| 33 | PUKË | 613 | 569 |
| 34 | SARANDË | 17,634 | 16,071 |
| 35 | SHKODËR | 17,734 | 16,766 |
| 36 | SKRAPAR | 763 | 731 |
| 37 | TEPELENË | 2,001 | 1,819 |
| 38 | TROPOJË | 872 | 866 |
| 39 | VLORË | 37,833 | 37,294 |
| | **TOTAL** | **449,702** | **437,365** |




| SHËRBIMET KADASTRALE 2024 | | | |
|---|---|---|---|
| **NR.** | **DREJTORITË** | **APLIKIME E-ALBANIA** | **APLIKIME E-ALBANIA ME PËRGJIGJE** |
| 1 | BERAT | 2,149 | 2,063 |
| 2 | BULQIZË | 280 | 274 |
| 3 | DEVOLL | 551 | 520 |
| 4 | DIBËR | 580 | 500 |
| 5 | DR KAMEZ - VORE | 6,914 | 6,796 |
| 6 | DR RURALE 1 | 6,859 | 6,777 |
| 7 | DR RURALE 2 | 6,523 | 6,442 |
| 8 | DR TIRANA JUG | 8,427 | 8,384 |
| 9 | DR TIRANA VERI | 12,129 | 12,049 |
| 10 | DURRËS | 6,582 | 6,358 |
| 11 | ELBASAN | 3,618 | 3,460 |
| 12 | FIER | 8,252 | 7,596 |
| 13 | GJIROKASTËR | 3,217 | 2,824 |
| 14 | GRAMSH | 701 | 683 |
| 15 | HAS | 280 | 272 |
| 16 | KAVAJË | 2,720 | 2,699 |
| 17 | KOLONJË | 393 | 376 |
| 18 | KORÇË | 8,868 | 8,237 |
| 19 | KRUJË | 1,507 | 1,495 |
| 20 | KUÇOVË | 976 | 964 |
| 21 | KUKËS | 1,235 | 1,202 |
| 22 | LAC | 1,665 | 1,645 |
| 23 | LEZHË | 1,845 | 1,664 |
| 24 | LIBRAZHD | 1,460 | 1,403 |
| 25 | LUSHNJE | 2,816 | 2,707 |
| 26 | MALËSI E MADHE | 582 | 579 |
| 27 | MALLAKASTËR | 699 | 651 |
| 28 | MAT | 524 | 458 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **29** | **MIRDITË** | 420 | 410 |
| **30** | **PEQIN** | 247 | 230 |
| **31** | **PËRMET** | 710 | 671 |
| **32** | **POGRADEC** | 2,121 | 2,112 |
| **33** | **PUKË** | 322 | 297 |
| **34** | **SARANDË** | 8,509 | 7,378 |
| **35** | **SHKODËR** | 5,830 | 5,437 |
| **36** | **SKRAPAR** | 224 | 208 |
| **37** | **TEPELENË** | 1,542 | 1,385 |
| **38** | **TROPOJË** | 420 | 417 |
| **39** | **VLORË** | 11,952 | 11,700 |
| | **TOTAL** | **124,649** | **119,323** |



| SHËRBIMET KADASTRALE 2024 | | | |
|---|---|---|---|
| **NR.** | **DREJTORITË** | **APLIKIME NISA** | **APLIKIME NISA ME PËRGJIGJE** |
| **1** | **BERAT** | 7,182 | 6,878 |
| **2** | **BULQIZË** | 549 | 536 |
| **3** | **DEVOLL** | 815 | 786 |
| **4** | **DIBËR** | 2,366 | 2,122 |
| **5** | **DR KAMEZ - VORE** | 16,552 | 16,345 |
| **6** | **DR RURALE 1** | 23,883 | 23,665 |
| **7** | **DR RURALE 2** | 21,271 | 21,113 |
| **8** | **DR TIRANA JUG** | 30,117 | 30,004 |
| **9** | **DR TIRANA VERI** | 44,543 | 44,318 |
| **10** | **DURRËS** | 35,210 | 34,087 |
| **11** | **ELBASAN** | 13,808 | 13,173 |
| **12** | **FIER** | 12,768 | 12,152 |
| **13** | **GJIROKASTËR** | 2,693 | 2,376 |
| **14** | **GRAMSH** | 537 | 523 |
| **15** | **HAS** | 149 | 149 |
| **16** | **KAVAJË** | 15,374 | 15,287 |
| **17** | **KOLONJË** | 558 | 538 |
| **18** | **KORÇË** | 5,897 | 5,641 |
| **19** | **KRUJË** | 3,822 | 3,809 |
| **20** | **KUÇOVË** | 1,206 | 1,182 |
| **21** | **KUKËS** | 722 | 709 |
| **22** | **LAC** | 1,121 | 1,116 |
| **23** | **LEZHË** | 13,186 | 12,684 |
| **24** | **LIBRAZHD** | 1,018 | 1,005 |
| **25** | **LUSHNJE** | 6,121 | 5,939 |
| **26** | **MALËSI E MADHE** | 901 | 898 |
| **27** | **MALLAKASTËR** | 425 | 417 |
| **28** | **MAT** | 667 | 649 |
| **29** | **MIRDITË** | 424 | 417 |
| **30** | **PEQIN** | 927 | 881 |
| **31** | **PËRMET** | 1,044 | 1,002 |
| **32** | **POGRADEC** | 7,313 | 7,302 |
| **33** | **PUKË** | 255 | 236 |
| **34** | **SARANDË** | 9,081 | 8,653 |
| **35** | **SHKODËR** | 10,952 | 10,469 |
| **36** | **SKRAPAR** | 532 | 516 |
| **37** | **TEPELENË** | 448 | 425 |
| **38** | **TROPOJË** | 436 | 433 |
| **39** | **VLORË** | 25,678 | 25,395 |
| | **TOTAL** | **320,551** | **313,830** |




| SHËRBIMET KADASTRALE 2024 | | | |
|---|---|---|---|
| NR. | DREJTORITË | APLIKIME SISTEMET E TJERA | APLIKIME SISTEMET E TJERA ME PËRGJIGJE |
| 1 | BERAT | 116 | 110 |
| 2 | BULQIZË | 59 | 59 |
| 3 | DEVOLL | 9 | 8 |
| 4 | DIBËR | 93 | 88 |
| 5 | DR KAMEZ - VORE | 100 | 93 |
| 6 | DR RURALE 1 | 317 | 288 |
| 7 | DR RURALE 2 | 251 | 239 |
| 8 | DR TIRANA JUG | 284 | 283 |
| 9 | DR TIRANA VERI | 364 | 362 |
| 10 | DURRËS | 167 | 153 |
| 11 | ELBASAN | 55 | 51 |
| 12 | FIER | 59 | 56 |
| 13 | GJIROKASTËR | 50 | 41 |
| 14 | GRAMSH | 2 | 2 |
| 15 | HAS | 11 | 11 |
| 16 | KAVAJË | 112 | 111 |
| 17 | KOLONJË | 10 | 9 |
| 18 | KORÇË | 136 | 121 |
| 19 | KRUJË | 41 | 40 |
| 20 | KUÇOVË | 3 | 3 |
| 21 | KUKËS | 84 | 84 |
| 22 | LAC | 118 | 118 |
| 23 | LEZHË | 487 | 415 |
| 24 | LIBRAZHD | 43 | 43 |
| 25 | LUSHNJE | 29 | 26 |
| 26 | MALËSI E MADHE | 53 | 53 |
| 27 | MALLAKASTËR | 6 | 6 |
| 28 | MAT | 25 | 25 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **29** | **MIRDITË** | 20 | 20 |
| **30** | **PEQIN** | 4 | 3 |
| **31** | **PËRMET** | 19 | 18 |
| **32** | **POGRADEC** | 106 | 106 |
| **33** | **PUKË** | 36 | 36 |
| **34** | **SARANDË** | 44 | 40 |
| **35** | **SHKODËR** | 952 | 860 |
| **36** | **SKRAPAR** | 7 | 7 |
| **37** | **TEPELENË** | 11 | 9 |
| **38** | **TROPOJË** | 16 | 16 |
| **39** | **VLORË** | 203 | 199 |
| | **TOTAL** | **4,502** | **4,212** |



**Tabela lidhur me treguesit "Vendimet e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore për objektet e ndërtuara para vitit 1991"**

| OBJEKTET E NDËRTUARA PËRPARA VITIT 1991 NË ZBATIM TË VKM NR. 827/2020 JANAR-DHJETOR 2024 | |
|---|---|
| **DREJTORITË** | **JANAR-DHJETOR** |
| **TIRANA VERI** | 35 |
| **TIRANA JUG** | 26 |
| **TIRANA RURALE 1** | 17 |
| **TIRANA RURALE 2** | 26 |
| **KAMEZ VORE** | 91 |
| **BERAT** | 39 |
| **DIBER** | 50 |
| **DURRES** | 318 |
| **ELBASAN** | 31 |
| **FIER** | 66 |
| **GJIROKASTER** | 62 |
| **KUCOVE** | 12 |
| **KORCE** | 93 |
| **KRUJE** | 6 |
| **KUKES** | 94 |
| **KAVAJE** | 36 |
| **LEZHE** | 43 |
| **LUSHNJE** | 18 |
| **POGRADEC** | 36 |
| **SHKODER** | 57 |
| **SARANDE** | 633 |
| **TEPELENE** | 19 |
| **VLORE** | 681 |
| | **2486** |

| Viti | Nr i vendimeve për formalizimin e objekteve të ndërtuara para 10.08.1991/trojeve funksionale/oborreve në përdorim |
|---|---|
| 2019 | 249 |
| 2020 | 1521 |
| 2021 | 2211 |
| 2022 | 1699 |
| 2023 | 1098 |
| 2024 | 2486 |


Nr i vendimeve për formalizimin e objekteve të ndërtuara para 10.08.1991/trojeve funksionale/oborreve në përdorim
3000
2500
2000
1500
1000
500
0
249
1521
2211
1699
1098
2486
2019
2020
2021
2022
2023
2024


VKM 827 JANAR - DHJETOR 2024
800
700
600
500
400
300
200
100
0
35
26
17
26
91
39
50
318
31
66
62
12
93
6
94
36
43
18
36
57
633
19
681
TIRANA VERI
TIRANA JUG
TIRANA RURALE 1
TIRANA RURALE 2
KAMEZ VORE
BERAT
DIBER
DURRES
ELBASAN
FIER
GJIROKASTER
KUCOVE
KORCE
KRUJE
KUKES
KAVAJE
LEZHE
LUSHNJE
POGRADEC
SHKODER
SARANDE
TEPELENE
VLORE

Për vitin 2024 numri i vendimeve për miratimin edokumentit të pronësisë për objektet pa titull pronësie të ndërtuara para datës 10.08.1991, trojet e tyre funksionale dhe oborret në përdorim është 2486. Të dhënat sipas muajve janë sipas tabelës dhe grafikut të mëposhtme.

| **Muaji** | **Nr i vendimeve për formalizimin e objekteve të ndërtuara para 10.08.1991/trojeve funksionale/oborreve në përdorim** |
|---|---|
| Janar | 75 |
| Shkurt | 72 |
| Mars | 75 |
| Prill | 103 |
| Maj | 392 |
| Qershor | 467 |
| Korrik | 389 |
| Gusht | 95 |
| Shtator | 166 |
| Tetor | 160 |
| Nëntor | 126 |
| Dhjetor | 366 |
| Totali | 2486 |




Kurse të dhënat progresive në lidhje me këtë proces janë si vijon:

| **Viti** | **Nr progresiv i vendimeve për formalizimin e objekteve të ndërtuara para 10.08.1991/trojeve funksionale/oborreve në përdorim** |
|---|---|
| 2019 | 249 |
| 2020 | 1770 |
| 2021 | 3981 |
| 2022 | 5680 |
| 2023 | 6778 |
| 2024 | 9264 |




**Tabela lidhur me treguesit për rregjistrimin e AMTP-ve.**

**TABELA MUJORE E REGJISTRIMIT TË AMTP**
**JANAR -DHJETOR 2024**

| **DREJTORITË/ZYRAT E ASHK SIPAS QARQEVE** | **JANAR - DHJETOR 2024** | | |
|---|---|---|---|
| | **AMTP TË REGJISTRUARA PËR HERË TË PARË** | **AMTP TË REJA** (të lëshuara nga Bashkitë ) | **ÇERTIFIKATA PËR TOKËN BUJQËSORE** (AMTP TË REJA + TË VJETRA) (pa përfshirë ndarjet e pasurisë, shitjet etj.) |
| BERAT | 0 | 0 | 166 |
| SKRAPAR | 0 | 0 | 0 |
| DIBËR | 0 | 0 | 158 |
| BULQIZË | 0 | 0 | 0 |
| MAT | 0 | 0 | 0 |
| DURRËS/ SHIJAK | 0 | 0 | 4 |
| ELBASAN | 0 | 0 | 0 |
| GRAMSH | 0 | 0 | 3 |
| LIBRAZHD | 0 | 0 | 239 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| PEQIN | 2 | 2 | 562 |
| FIER | 0 | 0 | 0 |
| MALLAKASTER | 0 | 0 | 0 |
| GJIROKASTËR | 1 | 0 | 10 |
| PERMET | 0 | 0 | 356 |
| KAMEZ VORE | 0 | 0 | 0 |
| KAVAJE | 0 | 0 | 0 |
| KORÇË | 0 | 0 | 0 |
| DEVOLL | 0 | 0 | 0 |
| KOLONJË | 0 | 0 | 0 |
| KUCOVË | 0 | 0 | 20 |
| KRUJË | 0 | 0 | 15 |
| KUKËS | 0 | 1 | 21 |
| HAS | 0 | 0 | 0 |
| TROPOJE | 0 | 0 | 0 |
| LEZHË | 0 | 0 | 0 |
| KURBIN | 0 | 0 | 0 |
| MIRDITË | 0 | 0 | 0 |
| LUSHNJE | 1 | 0 | 1 |
| DIVJAKË | 0 | 0 | 0 |
| POGRADEC | 0 | 0 | 7 |
| SARANDË/DELVINË | 0 | 0 | 0 |
| SHKODËR | 0 | 0 | 0 |
| M. MADHE | 16 | 0 | 16 |
| PUKE | 0 | 8 | 8 |
| TEPELENË | 0 | 0 | 32 |
| TIRANA RURALE 1 | 0 | 0 | 2 |
| TIRANA RURALE 2 | 1 | 0 | 7 |
| VLORË/HIMARË | 85 | 34 | 0 |
| **TOTAL** | **106** | **45** | **1627** |









**Tabela lidhur me treguesit për legalizimin**

**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

**EVIDENCË MBI ECURINË E PROCESIT TË LEGALIZIMEVE, PËR VITIN 2024**

| NR. | VENDIME PËRFUNDIMTARE | | | | VENDIME TË NDËRMJETME | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | DREJTORIA VENDORE | NR. I VENDIMEVE TË LEGALIZIMIT | NR. I VENDIMEVE TË MOSLEGALIZIMIT | NR. I URDHRAVE TË MOSPËRFSHIRJES NË PROCESIN E MOSLEGALIZIMIT | NR. I URDHRAVE TË PEZULLIMIT TË PROCESIT TË MOSLEGALIZIMIT - NENI 29 | NR. I URDHRAVE TË PEZULLIMIT TË PROCESIT TË MOSLEGALIZIMIT - PROCESE GJYQËSORE ETJ... |
| 1 | BERAT | 485 | 12 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | DIBËR | 342 | 0 | 20 | 30 | 0 |
| 3 | DURRËS | 989 | 4 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | ELBASAN | 755 | 0 | 2 | 0 | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | FIER | 685 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | GJIROKASTËR | 86 | 25 | 87 | 0 | 0 |
| 7 | KAMËZ VORË | 1,087 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| 8 | KAVAJË | 451 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 9 | KORÇË | 424 | 2 | 56 | 0 | 0 |
| 10 | KRUJË | 267 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 11 | KUÇOVË | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 12 | KUKËS | 231 | 0 | 29 | 0 | 0 |
| 13 | LEZHË | 437 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | LUSHNJE | 367 | 1 | 2 | 0 | 0 |
| 15 | POGRADEC | 526 | 5 | 9 | 0 | 24 |
| 16 | SARANDË | 156 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| 17 | SHKODËR | 279 | 3 | 0 | 0 | 0 |
| 18 | TEPELENË | 12 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 19 | TIRANA VERI | 762 | 7 | 11 | 44 | 0 |
| 20 | TIRANA JUG | 573 | 2 | 9 | 63 | 0 |
| 21 | TIRANA RURALE 1 | 501 | 1 | 1 | 0 | 0 |
| 22 | TIRANA RURALE 2 | 526 | 1 | 30 | 0 | 0 |
| 23 | VLORË | 314 | 4 | 2 | 0 | 0 |
| 24 | ZONAT E STIMULUARA | 484 | 0 | 0 | 18 | 0 |
| | **TOTAL** | **10839** | **70** | **258** | **155** | **24** |

| | |
|---|---|
| **11167** | **179** |




Sikurse kuptohet nga të dhënat e mësipërme ka rritje të ndjeshme të vendimeve për **legalizim/moslegalizim të objekteve pa leje gjatë muajve Tetor, Nëntor dhe Dhjetor**.









Kurse përsa i përket numrit progresiv të vendimeve për legazim/moslegalizim të objekteve pa leje është si më poshtë:

| VITI | Leje/vendime për legalizimin /moslegalizimin e objekteve pa leje sipas viteve |
|---|---|
| 2006-2009 | 1583 |
| 2010 | 3404 |
| 2011 | 7410 |
| 2012 | 13179 |
| 2013 | 21750 |
| 2014 | 37044 |
| 2015 | 61792 |
| 2016 | 110143 |
| 2017 | 136594 |
| 2018 | 166745 |
| 2019 | 178763 |
| 2020 | 199754 |
| 2021 | 224842 |
| 2022 | 243714 |
| 2023 | 253846 |
| 2024 | 265013 |




kompensimi i pronarëve joposedues për rastet rastet kur objekti i egalizuar është ndërtuar në truall me pronarë.

Ecuria e këtij procesi ndër vite ka qënë si vijon:

| VITI | NR I PASURIVE TË TRAJTUARA |
|---|---|
| 2008 | 31 |
| 2009 | 232 |
| 2010 | 75 |
| 2011 | 291 |
| 2012 | 199 |
| 2013 | 335 |
| 2014 | 50 |
| 2015 | 415 |
| 2016 | 493 |
| 2017 | 231 |
| 2018 | 731 |
| 2019 | 1024 |
| 2020 | 1933 |
| 2021 | 1443 |
| 2022 | 1547 |
| 2023 | 815 |
| 2024 | 387 |
| | |



## SKEDA DIGJITALE

| DREJTORIA | VENDIME LEGALIZIMI TË NGARKUARA TEK SKEDA DIGJITALE |
|---|---|
| BERAT | |
| DIBËR | 142 |
| DURRËS | |
| ELBASAN | |
| FIER | |
| GJIROKASTËR | 104 |
| KAMËZ-VORË | |
| KAVAJË | |
| KORÇË | |
| KRUJË | 203 |
| KUÇOVË | |
| KUKËS | |
| LEZHË | |
| LUSHNJË | |
| POGRADEC | |
| SARANDË | |
| SHKODËR | |
| TEPELENË | |
| TIRANA VERI | |
| TIRANA JUG | 1 |
| TIRANA RURALE 1 | |
| TIRANA RURALE 2 | |
| VLORË | |
| Z. STIMULUARA | |
| **Total Drejtoritë** | **450** |

## II. MARRËDHËNIE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

Drejtoria për Median dhe Marrëdhënien me Publikun u krijua në shtator të vitit 2024, si pjesë e përpjekjeve për të ndërtuar një institucion më të hapur, më të komunikueshëm dhe më pranë qytetarit.

**Objektivat kryesore të drejtorisë përfshijnë:**

- Fuqizimin e imazhit publik të institucionit;
- Ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me publikun e gjerë, mediat dhe aktorët institucionalë;
- Krijimin e urave të besimit me qytetarët përmes një komunikimi të qartë, të saktë dhe koherent.

### Aktivitetet kryesore dhe rezultatet e arritura (Shtator – Dhjetor 2024)

**1. Komunikimi digjital dhe rrjetet sociale**
Menaxhimi i profileve zyrtare në rrjetet sociale (Facebook, Instagram) është një ndër funksionet themelore të kësaj drejtorie. Nga 1 tetor deri më 31 dhjetor 2024 janë realizuar dhe publikuar:

- **63 postime informuese** që synojnë edukimin dhe orientimin e qytetarëve mbi:
  - shërbimet kadastrale,
  - mënyrat e aplikimit përmes e-Albania,
  - njoftime për vendimet e legalizimeve sipas drejtorive vendore,
  - promovimin e aktiviteteve institucionale dhe bashkëpunimeve strategjike.

**2. Fillimi i punës për Strategjinë së Komunikimit**
Në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe në kuadër të projektit *"Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe lehtësimi i ekzekutimeve të vendimeve të GJEDNJ në Shqipëri"*, nisëm bashkëpunimin për hartimin për herë të parë të Strategjisë së Komunikimit të ASHK-së.
Kjo strategji synon të përfaqësojë një plan të qartë për forcimin e komunikimit me qytetarët dhe mediat, përmes standardizimit të përmbajtjes, fuqizimit të tonit institucional, si dhe ndërtimit të një rrjeti të brendshëm komunikimi.

**3. Shërbimi ndaj qytetarëve dhe ndërtimi i rrjetit të komunikimit**

- Janë ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e shërbimit përmes numrit të gjelbër 0800 8811 dhe emailit zyrtar pronaime@ashk.gov.al.
- Në dhjetor 2024, nisi formimi i Grupit Ad-Hoc të Komunikimit, me përfaqësues si pika fokale nga çdo drejtori vendore ASHK, duke synuar ngritjen e një strukture funksionale të komunikimit brenda institucionit – që garanton një përgjigje të unifikuar dhe të orientuar drejt qytetarit në të gjitha kanalet.

**4. Monitorimi i komunikimit hyrës dhe ndërtimi i databazës**
Me qëllim ndjekjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit ndaj qytetarëve, gjatë kësaj periudhe është përgatitur një **databazë e dedikuar për mbajtjen e të dhënave mbi kërkesat për informacion** që vijnë përmes numrit të gjelbër 0800 8811 dhe emailit zyrtar pronaime@ashk.gov.al. Kjo bazë të dhënash na

mundëson analizimin periodik të pyetjeve më të shpeshta, identifikimin e problematikave të përsëritura dhe përmirësimin e qasjes së komunikimit publik.

- **Mesatarisht çdo muaj**, ASHK trajton:
    - **rreth 400 telefonata** përmes numrit të gjelbër
    - **rreth 300 email-e** me pyetje dhe kërkesa për informacion

**5. Performanca e përmbajtjes digjitale**
Postimet në rrjetet sociale kanë pasur një impakt të qëndrueshëm dhe në rritje, çka tregon interesin e lartë të ndjekësve për informacionin e ofruar.

- Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2024, përmbajtjet tona kanë arritur:
    - një **mesatare prej 13,000 shikimesh (views)** për postim
    - një **reach mujor prej rreth 6,000 përdoruesish**

Këto të dhëna tregojnë jo vetëm për shtrirjen e mirë të përmbajtjes, por edhe për rëndësinë që qytetarët i kushtojnë informacionit të saktë dhe zyrtar në fushën e shërbimeve kadastrale.

## Rekomandime për vijimësinë (2025)

- Hartimi i Strategjisë së Komunikimit më mbështetjen e Këshillit të Europës;
- Zbatimi i Strategjisë së Komunikimit me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin e shërbimit përmes grupit AdHoc të komunikimit si dhe për:
        - Rikonceptimin e faqes zyrtare në internet të ASHK
        - Përmirësimin e informacionit në ndërfaqet e aplikimeve për shërbimet që ASHK ofron përmes portalit e-albania;
        - Përmirësimin e shërbimit të ofruar përmes numrit të gjelbër 08008811, duke mundësuar pritjen në linjë përmes një centrali si dhe regjistrimin e telefonatave;
- Zgjerimi i kapaciteteve të stafit për përgatitjen e përmbajtjeve informuese (tekst, video, infografikë);

# III. AUDITIMI I BRENDSHËM

Në zbatim të Programit Vjetor të Auditimit të Brëndshëm për vitin 2024, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.2605 datë 26.12.2023 "Për miratimin e Programit Strategjik për Auditimin e Brendshëm 2024-2026 dhe Programit Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024", ligjit nr.114 datë: 22.10.2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", për vitin 2024 janë planifikuar angazhime auditimi në 9 subjekte nga të cilat janë realizuar angazhime të Auditimit të Brendshëm në 5 subjekte.

Në realizimin e Planit Vjetor 2024, risku është vlerësuar sipas fushave të sistemeve përkatëse dhe konkretisht:
- Risku nga mos tarifimi i saktë i shërbimeve të kryera.
- Risku nga pagesat on-line për shërbimet në ASHK.
- Risku i derdhjes së të ardhurave në të gjitha Bankat e Nivelit të Dytë.
- Risku nga kryerja e shërbimeve pa arkëtimin e vlerave të tyre.
- Risku i xhirimit të plotë të vlerës së mbledhur të të ardhurave të ASHK-së, nga Posta Shqiptare.
- Risku nga llogaritja e pasaktë e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pasurisë së paluajtshme.
- Risku nga mos evidentimi i saktë i aktiveve.
- Risku i sistemimit të veprimeve nga derdhje në llogaritë e gabuara.
- Risku i pagesave të anulluara brënda ditës (shërbime, tatime, taksa etj), dhe të kaluara si të rregullta në sektorët e përpunimit të kërkesave.
- Etj.

Në subjektet e audituara programet e auditimit u përqëndruan në sistemet e përputhshmërisë dhe të performancës si sisteme me risk të lartë.
Risku i personelit (megjithë masat e marra, nëpërmjet trajnimeve të punonjësve të rinj, në drejtim të aftësimit të tyre tekniko profesional), paraqitet aktiv në; tarifimin e shërbimeve, arkëtimin on-line, administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor, rakordimin e të ardhurave, llogaritjen dhe arkëtimin e tatimit, si dhe zbatimin e afateve të shërbimeve.

- **Gjetjet kryesore sipas sistemeve.**

Për vitin 2024 nga auditimet e kryera në 5 subjekte, kanë rezultuar gjetjet sipas fushave me sistemin e kombinuar , si më poshtë:
- Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në tre subjekte.
- Zbatim jo korrekt i tarifave të shërbimeve në katër subjekte.
- Shkelje e mangësi në llogaritjen e tatimit në tre subjekte
- Mangësi në zbatimin e procedurave prokuruese në tre subjekte.
- U konstatuan shërbime dhënë institucioneve të paarkëtuara, në pesë subjekte.
- Parregullsi në lidhje me dokumentacionin tekniko-ligjor të regjistrimit në arkivë, në katër subjekte.
- Tejkalim i afateve në dhënien e shërbimit në pesë subjekte.
- Nuk janë efiçentë postet e punës sipas urdhrave të brendshëm, në dy subjekte.

- Rezultuan vonesa nga menaxhimi, në evadimin e praktikave të përfunduara në një subjekt.
- Rezulton që drejtimi i aktivitetit dhe komunikimi me stafin nuk kryhet çdo muaj dhe i dokumentuar, në tre subjekte.
- Nuk është bërë markimi me vulë numratore i referencave, në dy subjekte.
- Pasqyra e llogaritjes së tatimit nga kalimi i pronësisë, nuk është pjesë e referencës së regjistrimit në çdo rast, në dy subjekte.
- Në arkivë dosjet e referencave nuk kanë inventar, për të evidentuar mungesat ose dublimet, në pesë subjekte.
- U evidentuan raste që dalja e Vendimit të Legalizimit nuk shoqërohet me njoftimin e detyrimit për parcelën, në pesë subjekte.
- U konstatuan dosje të përfunduara të legalizimit që nuk kishin orto foton e objektit pjesë të tyre, në katër subjekte.
- Në katër subjekte u konstatuan raste të shkeljes së afateve ligjore në emetimin e vendimeve të legalizimit.
- Urdhri i Titullarit për nxjerrjen nga arkiva dhe punimin e dosjes së legalizimit, nuk ishte pjesë e saj në çdo rast për katër subjekte.
- U evidentua se Posta Shqiptare nuk bën në fund të çdo dite, xhirimin e të ardhurave të ASHK-së, në llogarinë e saj në Bankën e Nivelit të Dytë, në kundërshtim me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e përbashkët, në një subjekt

- **Rekomandimet e propozuara.**

Në përfundim të cdo mision auditimi janë dhënë për subjektin e audituar, rekomandime për të ndihmuar në korrigjimin e veprimeve, në mënyrë që të shtohet vlera e organizatës.
Janë dhënë gjithsej 61 rekomandime, nga të cilat 49 rekomandime janë raportuar të zbatuara, ndërsa 12 rekomandime janë në proces zbatimi. Ndjekja e mëtejshme e zbatimit të tyre është planifikuar për auditim, në vitin 2024.
Për rekomandimet me dëm ekonomik është kërkuar arkëtimi i dëmit në masën 100%.

Nga rekomandimet e dhëna:

- Në tre subjekte u la rekomandim që të analizohej nga Menaxhimi dhe të nxirren përgjegjësitë konkrete për rekomandimet e pranuara, por të pa zbatuara, të lëna nga auditimi i mëparshëm, pasi risku i moszbatimit të tyre mbetet përgjegjësi e Menaxhimit.
- Është lënë rekomandim në pesë subjektet të audituara, që të analizohen rezultatet e testeve të zbatimit të afateve të shërbimeve, duke përcaktuar kontrolle shtesë për përmirësimin e performancës.
- Në tre subjekte është lënë rekomandim që dokumentacioni i procedurave prokuruese të në zbatim të kërkesave ligjore për të.
- Në pesë subjekte u la rekomandim, që dosjet e referencave në arkivë të pajisen me inventar duke bërë të mundur dokumentimin rast pas rasti të mungesave, dublimeve të tyre etj.
- U la rekomandim në dy subjekte që lëvizja e dokumentacionit (hyrje, dalje) nga arkiva të bëhet e dokumentuar konform edhe detyrimeve të ligjit “44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe Rregullores nr.2079, datë:11.06.2007 “Për arkivimin e dokumentacionit ligjor në ZVRPP”, Kreu IV “Përpunimi tekniko shkencor i dokumentave të arkivës”, pika 1.6.

- Në katër subjekte u la rekomandim që administrimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në arkivë të bëhet në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe të Rregullores nr.2079, datë 11.06.2007 "Për arkivimin e dokumentacionit ligjor në ZVRPP".
- Në një subjekt u la rekomandim që nga Menaxhimi të mos ketë vonesa në evadimin e praktikave të përfunduara.
- U la rekomandim në pesë subjekte, që të ndiqet arkëtimi i shërbimeve dhëna për institucionet.
- U la rekomandim në tre subjekte që takimet me stafin, për analizën e rezultateve, problematika të konstatuara etj, të bëhen në mënyrë periodike dhe të dokumentohen.
- Në dy subjekte u la rekomandim që të vijojë markimi i referencave të regjistrimit me vulën e kuqe numratore në zbatim të kërkesave Rregullores nr.2079, datë 11.06.2007 "Për arkivimin e dokumentacionit ligjor në ZVRPP".
- U la rekomandim në dy subjekte, që pasqyra e llogaritjes së tatimit të jetë pjesë e referencës së regjistrimit të kalimit të pronësisë në çdo rast.
- Në tre subjekte u la rekomandim që rivlerësimi i përdorur i pasurisë mos të mbartet në kartelën e re të saj pasi është shfuqizuar.
- U la rekomandim në pesë subjekte që, në rastet e ndërtimeve informale mbi parcelë ndërtimore "shtet", me emetimin e vendimit të legalizimit, qytetari të njoftohet edhe për detyrimin e parcelës ndërtimore.
- Në katër subjekte, u la rekomandim që orto foto e objektit të jetë në çdo rast pjesë e dosjes së përfunduar të legalizimit.
- Të zbatohet afati ligjor 60 ditor nga evidentimi në terren deri në daljen e vendimit të legalizimit, u la rekomandim në katër subjekte.
- Në pesë subjekte u la rekomandim që çdo dosje e përfunduar e legalizimit duhet të arkivohet pasi të jetë bërë inventari i brendshëm i saj.
- U la rekomandim në një subjekt, që në çdo rast të prokurimeve për riparime, nga komisioni i prokurimit të hartohet raporti mbi leverdisshmërinë ekonomike të prokurimit, në raport me vlerën e mbetur të paisjeve që riparohen.
- U la rekomandim në dy subjekt që, Menaxhimi të vlerësojë me objektivitet dhe prioritet kapacitetet e burimeve njerëzore dhe në rast se nevojitet, për mbarëvajtje të punës, me urdhëra të brendshëm, të bëjë pozicionim të specialistëve në poste të tjera nga ato të përcaktuara në Urdhërat e Emërimit, me qëllim arritjen e objektivave.
- Në një rast u la rekomandim që, Posta Shqiptare në detyrim të marrëveshjes së përbashkët, të bëjë në fund të çdo dite xhirimin në llogarinë e ASHK-së në Bankën e Nivelit të Dytë.
- Për diferencat e konstatuara në zbatimin e tarifave në katër subjekte, u rekomandua që të arkëtohen 100 % në favor të të ardhurave të ASHK-së.
- Për diferencat në llogaritjen dhe arkëtimin e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë të konstatuara në tre subjekte të audituara, u la rekomandim arkëtimi i tyre 100% në favor të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve.
- Për diferencat në llogaritjen dhe arkëtimin e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë të konstatuara në dy subjekte të audituara, u la rekomandim arkëtimi i tyre, 97% në favor të Bashkive në qytetet përkatëse dhe 3% në favor të të ardhurave të ASHK-së, si agjent tatimor.
- Etj

## IV. MONITORIMI I REGJISTRIMIT FILLESTAR DHE PROCESIT TË KOMPENSIMIT

Drejtoria e Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar ka në përbërje të saj 3 sektorë sa vijon:
**Sektori i Regjistimit Fillestar dhe Përmirësimit**
**Sektori i Kompensimit dhe Hartografisë**
**Sektori i Analizes dhe Vleresimit të Pasurive**

**Sektori i Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit**,
Fusha e veprimit

i. Monitorimi i fazave të punës, për procesin e Regjistrimit Fillestar dhe procesin e Përmirësimit të Regjistrit, nëpërmjet korrespondencës apo kontrolleve tematike në strukturat operuese të ASHK, sipas kërkesës së titullarit të Agjencisë apo eprorëve përkatës.
ii. Përgatitja e Raport - kontrolleve të produkteve digjitale të punës për Regjistrimin Fillestar dhe Përmirësimin e Regjistrit të paraqitura nga operatorët e autorizuar, në drejtim të përmbushjes së standardeve të miratuara, sipas kërkesës së titullarit të Agjencisë apo eprorëve përkatës.
iii. Përgatitja e raporteve për monitorimin/kontrollin e kryer, duke u shprehur për zbatimin e standardeve, duke evidentuar problemet, si dhe duke dhënë orientimet përkatëse për plotësimin e mangësive dhe zgjidhjen e tyre.
iv. Mbajtja, përditësimi dhe dhënia e informacionit mbi ecurinë e Regjistrimit Fillestar dhe të Përmirësimit të Regjistrit për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
v. Zgjidhja teknike dhe ligjore të çështjeve të ngarkuara, në përputhje me funksionet që mbulon sektori, duke bashkëpunuar edhe me struktura të tjera të institucionit.
vi. Përgatitja dhe hartimit të materialeve me natyrë rregullatore për përcaktimin e procedurave standarde dhe kritereve të vlerësimit të cilësisë së produkteve të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke bashkëpunuar edhe me struktura / grupe pune të ngarkuara brenda apo jashtë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Gjatë periudhës Janar 2024 – Dhjetor 2024 është përmbyllur procesi Regjistrimit Fillestar për 30 Zona Kadastrale të janë listuar si më poshtë:

| NR. | EMRI ZK | NR.ZK | DVASHK/ZVASHK | PASURI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | SUC | 3534 | MAT | 1301 |
| 2 | JUBICE | 2010 | MALESI E MADHE | 362 |
| 3 | HARDHIAS | 1930 | ELBASAN | 1470 |
| 4 | FIERZE | 1616 | ELBASAN | 2244 |
| 5 | DERSNIK | 1473 | KORCE | 2957 |
| 6 | QAFE GRADE | 3079 | MALESI E MADHE | 1005 |
| 7 | GRADEC | 1836 | MALESI E MADHE | 991 |
| 8 | SOPOT | 3491 | BULQIZE | 1762 |
| 9 | QINAM | 3117 | KOLONJE | 1603 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 10 | GDHESHTE | 1697 | KUKES | 364 |
| 11 | NIVICE BLL.1 | 2806 | SARANDE | 500 |
| 12 | DAREZEZE E RE | 1451 | FIER | 3304 |
| 13 | BURONJE | 1323 | SARANDE | 334 |
| 14 | CAUSH | 1360 | SARANDE | 1540 |
| 15 | FINIQ | 1623 | SARANDE | 4123 |
| 16 | FRASHER | 1637 | GJIROKASTER | 504 |
| 17 | KALLDRUN | 2047 | MALESI E MADHE | 877 |
| 18 | LUBONJE | 2503 | KORCE | 1456 |
| 19 | SASAJ | 3265 | SARANDE | 275 |
| 20 | SHKJEZE | 3389 | SHKODER | 972 |
| 21 | STRAVEC | 3989 | LUSHNJE | 372 |
| 22 | CURRAJ I EPERM | 1431 | KUKES | 1109 |
| 23 | VUKEL | 3839 | MALESI E MADHE | 760 |
| 24 | SELCE | 3278 | MALESI E MADHE | 714 |
| 25 | NIKC | 2794 | MALESI E MADHE | 352 |
| 26 | QEREC-MULAJ | 3097 | KUKES | 724 |
| 27 | SHIPSKE | 3375 | KORCE | 611 |
| 28 | STANAJ | 3507 | ELBASAN | 553 |
| 29 | BROJE | 1284 | MALESI E MADHE | 495 |
| 30 | DOVOLAN | 1521 | MALESI E MADHE | 779 |

Sektori Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit ka ndjekur procedurat dhe pregatitur materialin për miratim nga Këshilli Drejtues i ASHK-së, për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit për kryerjen e procedurave të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit.

Gjatë vitit 2024 janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimime institucionet e mëposhtme:

1. Me Bashkinë Malësi e Madhe për kryrjen e procesit të RF për ZK 3560 Tamarë dhe ZK 3815 Vorfe.
2. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH-Bashkia BELSH.
3. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia BERAT.
4. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia DEVOLL.
5. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia DIBËR
6. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia GRAMSH.
7. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia KOLONJË.
8. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia KORCË.
9. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia KUKËS.
10. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia MALËSI E MADHE.
11. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia PËRMET.
12. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia PUSTEC.
13. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia SHKODËR.
14. Marrëveshje 3-palëshe ASHK-FSHZH- Bashkia TROPOJË.

Për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2024, janë trajtuar shkresa me natyrë teknike si dhe janë hartuar Raporte Kontrolli, të cilat paraqiten në tabelën përmbledhëse më poshtë:

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NENTOR | DHJETOR | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **SHKRESA** | 1 | 49 | 1 | 43 | 3 | 4 | 59 | 0 | 21 | 14 | 14 | 35 | 244 |
| **RAPORT KONTROLLI RF** | 2 | 3 | 5 | 3 | 4 | 3 | 8 | 1 | 5 | 6 | 5 | 6 | 51 |
| **RAPORTE KONTROLLI PERMIRESIMI** | 10 | 3 | 3 | 10 | 5 | 4 | 10 | 1 | 2 | 1 | 4 | 4 | 57 |

**Sektori i Kompensimit dhe të Hartografisë (GIS)**

Sektori në periudhën Janar-Shtator 2024 ka funksionuar sipas strukturës paraardhëse nën emërtimin Sektori i Kompensimit dhe ka patur në përbërje 1 përgjegjës dhe 5 specialist, ndërkohë që në periudhën Shtator-Dhjetor ka funksionuar sipas strukturës së re nën emërtimin Sektorit Kompensimit dhe të Hartografisë (GIS) dhe ka në përbërje një përgjegjës dhe 4 specialist.

Gjatë vitit 2024 Sektori i Kompesimit dhe Hartografisë (GIS) ka realizuar :

a) Përpunimi i Informacionit Gjeohapësinor të administruar në sistemin ALBSCAD për temën “Parcelat Kadastrale”dhe “Ndërtesat Kadastrale”në përputhje me VKM nr.321 dt.27.04.2016 dhe dërguar Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor(ASIG) në vijim të bashkëpunimit midis ASHK-ASIG
b) Përpunimi i Zonave Kadastrale, Parcelave dhe Ndërtesave të Regjistrimit Fillestar në KRGJSH që nuk ndodhen ne sistemin ALBSCAD dhe dërguar ASIG të cilat I kishte në mungesë.
c) Përpunimi I hartave për përcaktimin e cmimeve mesatare referuese të banesave për 62 Bashki për kontratat e shitblerjeve të viteve 2022-2023 dhe 2024.
d) Verifikim koordinatash dhe hartash të zonave për projektVKM e-akte.
e) Nxjerrjen e Zonave Kadastrale për lejimin e kultivimit të canabis për qëllime industriale
f) Dërgim informacioni ATP në format dëg dhe shapefile për hartat e pyje kullotave
g) Nxjerrje informacioni sipërfaqe dhe numër pasurie për pyje kullotat të ndara sipas Bashkive.
h) Pregatitje informacioni për sipërfaqet totale dhe numrat total të pasurive për llojet e pasurive(ndërtesë, apartament,godinë,njësi etj) për cdo zonë fiskale në bashkinë e Tiranës.
i) Pregatitje shapefile për 3058 ZK, ku përfunduar janë 2784ZK, në process 30zk, do të fillojne RF 106 zk dhe pa regjistrim fillestar 138 zona kadastrale.
j) Pregatitje shapefile të zonave kadastrale sipas Drejtorive të reja te ASHK
k) Bashkëpunim me sektorin Tekniko-Ligjor për ceshtjet hartografike
l) Bashkëpunim me Drejtorinë e Pronave Shtetërore për konvetimin e hartave ne DËG në Krgjsh.
m) Krijimin e materialeve te ndryshme hartografike për qëllim nxjerrjen e pronarëve (Shtet-Privat).
n) Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar nga sektori i Kompesimit dhe Hartografisë (GIS), 410 shkresa (kthim përgjigje) mbi problematika të ndryshme në lidhje me hartografinë dhe kompensimin. Janë trajtuar gjithsej 502 dokumentacione tekniko-ligjore të ardhura nga drejtoritë vendore, mbi

kompensimin financiar të pronarëve të ligjshëm, pasuritë e të cilëve jane zënë nga parcelat e ndërtimeve të legalizuara.

o) Ka hartuar gjithsej 7 projekt vendime të cilat janë miratuar në KM për : "Kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtëshme që preken nga ndërtimet e legalizuara" të detajuara si më poshtë në formë tabelare:

**EVIDENCA E VKM TE KOMPENSIMIT TË PRONARËVE PËR SIPËRFAQET TAKUESE TË ZËNA NGA NDËRTIMET INFORMALE PËR PERIUDHËN (JANAR-DHJETOR) VITI 2024**

| Nr rendor | Listat e V.K.M. te Kompensimit Te Miratuara | Numri I pasurive te legalizuara | Numri i pasurive te trajtuara per kompensim | Numri i Trashëgimtarëve Perfitues | Masa e kompensimit (m2) | Vlera e kompensimit (lek) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *81* | Nr 162, Dt 20.03.2024 | 112 | 124 | 488 | 27,445.30 | 243,825,263.84 |
| *82* | Nr 336, Dt 05.06.2024 | 95 | 104 | 794 | 19,291.90 | 241,974,903.80 |
| *83* | Nr 481, Dt 24.07.2024 | 34 | 41 | 382 | 9,761.40 | 187,951,902.87 |
| *84* | Nr 606, Dt 02.10.2024 | 93 | 118 | 470 | 28,682.60 | 251,170,138.99 |
| *85* | Nr 3, Dt 14.01.2025 | 386 | 420 | 2,253 | 88,358.40 | 1,011,135,155.99 |
| ***SHUMA TOTALE*** | | ***720*** | ***807*** | ***4387*** | ***173,539.60*** | ***1,936,057,365.49*** |

**Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive**

Sektori në periudhën Janar-Shtator 2024 ka funksionuar sipas strukturës paraardhëse nën emërtimin Sektori i Vlerësimit të Pasurive dhe ka patur në përbërje 1 përgjegjës dhe 2 specialist, ndërkohë që në periudhën Shtator-Dhjetor ka funksionuar sipas strukturës së re nën emërtimin Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive dhe ka në përbërje një përgjegjës dhe 3 specialist.

Puna e Sektorit të Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka qenë e fokusuar në aktivitetet e mëposhtme:

*A. Përgatitja e projektaktit "Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë";*
*B. Përgatitja e hartës së vlerës së tokës;*
*C. Trajtimi i kërkesave dhe shkresave të ndryshme institucionale në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme.*

**A. Përgatitja e projektaktit mbi metodologjinë e përgatitjes së hartës së vlerës së tokës.**

Bazuar në përcaktimet ligjore të pikës k të nenit 9 të Ligjit nr. 111/2018 ''Për Kadastrën'', me orientim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka

vijuar punën për trajtimin e komenteve të institucioneve të ndryshme publike në lidhje me projektaktin mbi metodologjinë e përgatitjes së hartës së vlerës së tokës dhe relacionit përkatës, i cili nga ish-Drejtoria e Hartografisë dhe Regjistrit i ishte përcjellë ish-Drejtorisë së Çështjeve Juridike për të vijuar me proceset e konsultimit dhe miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Gjatë procesit të konsultimit të projektaktit janë administruar dhe trajtuar komentet e Kryeministrisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, ku here pas here ka patur dhe takime konsultuese. Në muajin Shkurt të vitit 2024 është përcjell në Kryeministri drafti i fundit i projektaktit ku janë përfshirë edhe komentet e ardhura.

Në vijim të konsultimeve, në datën 3 Qershor 2024 së bashku me ish-Drejtorin e Kadastrës dhe Hartografisë, kemi patur një takim në Kryeministri për këtë çështje, ku kemi ilustruar dhe me shembull konkret se si do të jetë harta e vlerës së tokës sipas metodologjisë së propozuar.

Përgatitja e modelit ilustrues për diskutim u krye për pasuritë e llojit ”TRUALL” në një territor të Bashkisë Tiranë i përbërë nga **9 Zona Kadastrale**, për të cilën u krye hedhja e pozicionit gjeografik të rreth **276 vlerave të shitjes.**

Ndërkohë, që me shkresën e Kryeministrisë nr.696/10 prot., datë 31.10.2024, administruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së me nr.3177/2 prot., datë 04.11.2024, na është kthyer projektakti për ripunim. Në vijim të kësaj shkrese kemi informuar Kryeministrinë, ku nga ana jonë është çmuar e nevojshme që ky projektakt të kalojë dhe përfshihet në Programin Analitik të Projektakteve për vitin 2025.

**B.Përgatitja e hartës së vlerës së tokës.**

Gjatë vitit 2024, Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka punuar me nën-aktivitetet e ndryshme për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës, si më poshtë:

1. *Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me anë të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë.*
2. *Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë dhe organizimi i tyre për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës.*
3. *Përllogaritja e vlerës së pasurisë.*
4. *Identifikimi i pozicionit gjeografik të vlerave përfaqësuese të transaksioneve të kalimit të pronësisë dhe pozicionimi i tyre mbi Hartën Kadastrale dhe ortofoto.*

**1. Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me anë të kontratave të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë.**

Në bazë të Vendimit të KM Nr. 658, datë 26.09.2012 ‘‘Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë’’, të dhënat mbi transaksionet e kalimit të pronësisë me anë të kontratave të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë që do të përdoren për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës, janë të dhënat zyrtare të administruara nga zyrat dhe drejtoritë vendore të ASHK-së sipas informacionit të regjistrit kadastral.

Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive pas kërkimeve të kryera në sistemin informatik të pasurive të paluajtshme ka mundur të gjenerojë për vitin 2024 të dhënat për **6 935 traksaksione** gjithsej për kontrata shitje

mbi pasuritë e llojit tokë.

2. **Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë dhe organizimi i tyre për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës.**

Një nga proceset më të rëndësishme gjatë përgatitjes së hartës së vlerës së tokës është përpunimi i të dhënave të administruara dhe organizimi i tyre.
Të dhënat e grumbulluara përmbajnë informacione për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme ku janë kryer transaksione të kalimit të pronësisë me anë të kontratave të shitjes. Fillimisht kemi veçuar të dhënat digjitale për pasuritë e paluajtshme të llojit tokë bujqësore, tokë truall, tokë pyjore dhe tokë kullosore në programin informatik excel, duke i organizuar dhe grupuar ato sipas zonave kadastrale ku gjendet pozicioni gjeografik i pasurisë së paluajtshme përkatëse. Më pas, kemi eleminuar të dhënat me probleme, sa i përket gabimeve që lidhen me, numrin e pasurisë, vlerën e pasurisë, llojin e pasurisë, dublimet, etj.
Gjatë përpunimit të të dhënave janë zbatuar kriteret dhe standartet e përcaktuara nga Vendimi i KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 487, datë 27.11.2012 “Mbi procedurat për zbatimin e Vendimit nr. 658, datë, 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””.
Për të qënë sa më afër vlerave përfaqësuese të transaksioneve të kryera, kemi hequr vlerat që u përkasin pasurive të paluajtshme me sipërfaqe përkatësisht, për trojet më të vogla se 100 m$^2$, për tokë bujqësore më të vogla se 500 m$^2$, për tokë pyjore dhe kullosore më të vogël se 2 000 m$^2$. Gjithashtu, kemi eleminuar edhe vlerat anomalisht të ulëta apo të larta.
***Nga 6 935 rekorde të dhënash gjithsej, kanë rezultuar:***

- ***1 973 rekorde tokë truall;***
- ***4 284 rekorde tokë bujqësore;***
- ***96 rekorde tokë pyjore;***
- ***53 rekorde tokë kullosore.***

3. **Përllogaritja e vlerës së pasurisë.**

Përllogaritja e vlerës së pasurisë kryhet duke zbatuar kriteret dhe standartet e përcaktuara nga Vendimi i KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 487, datë 27.11.2012 “Mbi procedurat për zbatimin e Vendimit nr. 658, datë, 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””, si dhe Vendimi i KM nr. 1034, datë 16.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””.
Përllogaritja e vlerës së pasurisë kryhet për çdo zonë kadastrale ku janë administruar të dhëna mbi transaksionet me pasuritë e paluajtshme. Për zonat kadastrale ku të dhënat janë në mungesë është ruajtur vlera e përcaktuar sipas hartës së vlerës së miratuar nga Këshilli i Ministrave në vendimin paraardhës.
Përllogaritja e vlerës kalon në këto etapa:

- Përcaktohet çmimi lek/m$^2$ sipas vlerave të kontratave të shitjes,
- Identifikimi i vlerës së çmimit minimal dhe maksimal për m$^2$ për secilin lloj pasurie dhe për çdo zonë kadastrale, si dhe përcaktimi i çmimit mesatar për m$^2$,
- Përjashtimi fillimisht i vlerave 5% më të ulëta dhe 5% më të larta të vlerave të administruara; dhe në rastet kur pas këtij eleminimi nuk përllogaritet një vlerë e pasurisë, vijohet duke eleminuar vlerat 10% më të ulët dhe 10 % më të lartë të vlerave të administruara,

- Llogaritet moda për çdo zonë kadastrale sipas llojeve të pasurisë,
- Llogaritet mesorja për çdo zonë kadastrale sipas llojeve të pasurisë,
- Përcaktohet vlera e pasurisë për çdo zonë kadastrale sipas llojeve të pasurisë.

Gjatë përllogaritjeve kryhet dhe verifikimi i saktësisë së rezultatit sipas aneksit 1/1 të metodologjisë së miratuar me VKM Nr. 658, datë 26.09.2012 "Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë".

Pasqyrimi i të dhënave sipas etapave të lartpërmendura kryhet sipas formatit të mëposhtëm:

| Nr. | Bashkia | ZK | Lloji pasurise | Vlerat per m2 | Zona e Vleres | Vlera mesatare | Heq 5% | Heq 10 % | Moda | Mesorja | Niveli I Vleres |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | |

Gjatë përllogaritjeve kryhet dhe verifikimi i saktësisë së rezultatit sipas aneksit 1/1 të metodologjisë së miratuar me VKM Nr. 658, datë 26.09.2012 "Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë".

Për të dhënat e vitit 2024 ky proces ka filluar të kryhet ne Janar të vitit 2025.

**4. Identifikimi i pozicionit gjeografik të vlerave përfaqësuese të transaksioneve të kalimit të pronësisë dhe pozicionimi i tyre mbi Hartën Kadastrale dhe ortofoto.**

Vlerat përfaqësuese të përdorura për përllogaritjen e vlerës së pasurisë azhornohen në hartën kadastrale të administruar nga ASHK-ja, sipas pozicionit gjeografik të pasurisë së paluajtshme së cilës i përket referuar të dhënave për numrin e pasurisë dhe numrin e zonës kadastrale.
Hartat kadastrale të përdorura janë informacionet digjitale për çdo zonë kadastrale sipas gjendjes së regjistrimit fillestar në formatin *dëg, si dhe imazhe të skanuara të hartave kadastrale manuale ku jepen transaksionet e azhornuara. Gjatë procesit të pozicionimit të vlerave përfaqësuese të transksioneve mbi hartën kadastrale të zonave kadatrale përkatëse janë identifikuar problematika që lidhen me pasaktësitë e vet hartës kadastrale si dhe me pamundësin për të identifikuar pasurinë e paluajtshme përkatëse në këtë hartë.
Pozicionimi gjeografik i vlerave është kryer sipas identifikimit të pozicionit të pasurisë së paluajtshme mbi ortofoto duke përdorur programin informatik QGIS.

Të dhëna statistikore mbi këtë aktivitet jepen si më poshtë.

- ***nga 1 973 rekorde për tokën truall, janë pozicionuar gjeografikisht 473 rekorde;***
- ***nga 4 284 rekorde për tokën bujqësore, janë pozicionuar gjeografikisht 1 141 rekorde;***
- ***nga 96 rekorde për tokën pyjore, janë pozicionuar gjeografikisht 0 rekorde;***
- ***nga 53 rekorde për tokën kullosore, janë pozicionuar gjeografikisht 0 rekorde;***

**C. Trajtimi i kërkesave dhe shkresave të ndryshme për informacione në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme.**

Gjatë vitit 2024 Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Pasurive ka punuar edhe në lidhje me trajtimin e korrespondencës së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme, kryesisht ato që kanë të bëjnë me të dhënat mbi

transaksionet e kontratave të shitjes.
Kështu, në zbatim të pikës 2 të Udhëzimit nr. 1, datë 17.03.2023 “Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e çmimit mesatar të shitjes së banesave në treg”, në muajt Qershor, Korrik dhe Gusht është punuar për të evaduar të gjithë korrespondencën e Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtorive rajonale të Entit Kombëtar të Banesave me Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë vendore të ASHK-së në lidhje me dhënien e informacionit mbi të dhënat e kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme të llojit apartament, njësi, garazhde, bodrume, etj. për një përiudhë nga Janari 2022 deri në Shtator 2024.
Eshtë dhënë informacion për rreth **57 292 kontrata shitje.**
Ky informacion është përgatitur me ndihmën e Drejtorisë së IT, ku nga rreth **250 000 rekorde** na është dashur të filtrojmë dhe të pastrojmë të dhënat nga anomali të ndryshme për të konkluduar në një informacion të saktë dhe përfaqësues prej **57 292 rekorde**.
Gjithashtu, është punuar edhe për përgatitjen e informacioneve të ndryshme mbi transaksionet e pasurive të paluajtshme për grupet e ndryshme të interesit.

## V. MONITORIMI I TITUJVE TË PRONËSISË -PROCESET KALIMTARE

**Drejtoria e Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë ka në përbërje të saj 3 sektorë:**
1.Sektori i Mbikëqyrjes së Legalizimeve dhe Proceseve Kalimtare.
2.Sektori i Privatizimeve, Objekteve pa Tituj, Trojeve Funksionale dhe Oborreve në Përdorim.
3.Sektori i AMTP-ve.
Më poshtë jepet analiza e secilit sektor për vitin 2024, për veprimtarinë e tyre sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të ushtruara prej tyre.

- **Sektori i Mbikëqyrjes së Legalizimeve dhe Proceseve Kalimtare**

Sektori i mbikëqyrjes së legalizimeve dhe proceseve kalimtare, referuar strukturës së miratuar përbëhet nga Përgjegjësi dhe 4 specialistë, aktualisht jane 3 specialistë, dhe kryen veprimtarinë e mëposhtme:

- Trajton dhe shqyrton kerkesë/ankesat, korrespondenca me drejtoritë vendore dhe me institucionet e tjera.
- Mban kontakte me sektorët e tjerë të drejtorisë për marrjen e të dhënave të ndryshme, si dhe për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet gjatë shqyrtimit të kerkesë/ankesave.
- Monitoron zbatimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, në varësi të problematikave të hasura, sipas korrespondencës me drejtoritë vendore dhe/ose subjektet ankues, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas etapave të zhvillimit të këtij procesi.
-Evidenton problematika, paqartësi apo pasaktësi, bën verifikime të nevojshme gjatë zbatimit të procedurave administrative për legalizim, në drejtoritë e varësisë, merr masa konkrete për zgjidhjen e problemeve, duke i orientuar ato sipas rastit.
-Në zbatim të orientimeve të Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Drejtorisë përkatëse, punon për unifikimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale.
- Merr pjesë në seminare, trajnime, etj., si dhe përgatit materialet përkatëse në përputhje me objektin e veprimtarisë, për drejtoritë vendore.
- Në bashkëpunim me strukturat e tjera të institucionit kontribuon në organizimin e veprimtarive të ndryshme për informimin dhe sensibilizimin e opinionit publik, mbi procesin e legalizimit.
- Në bazë të treguesve kryesore në shkallë vendi dhe situatës aktuale të ecurisë së procesit harton plan veprime e marrje masash për përmirësimin dhe përshpejtimin e procesit të legalizimit.
- Kryen çdo detyrë tjetër që lidhet me funksionet e këtij sektori, që i ngarkohet nga eprorët.

Në Sektorin e Mbikqyrjes së Legalizimeve, gjatë vitit 2024 **janë administruar dhe trajtuar 3519 shkresa,** nga të cilat **347shkresa** (afishime publike) dhe **3172 shkresa** (kërkesë-ankesa qytetarësh, kthim përgjigje/informacione nga drejtoritë vendore, shkresa nga institucione të ndryshme që bashkërendojnë punën me ASHK, etj).
Problematika kryesore ka qenë vonesa në trajtimin administrativ të praktikave të legalizimit, si dhe kërkesave për miratimin e titullit të pronësisë për objektet pa titull (ndërtuar para vitit 1991), trojeve të tyre funksionale dhe oborreve në përdorim.

Nga ky sektor, përveç trajtimit të ankesave të subjekteve, kryhet edhe procesi i afishimit publik në faqen zyrate të ASHK-së, në zbatim të pikës 31, të VKM nr. 1040/2020 dhe pikës 22 të VKm nr. 827/2020, i cili monitorohet nëpërmjet adresës elektronike afishime.web@ashk.gov.al.
Ky sektor në bashkëpunim edhe me sektorë të tjerë ka dhënë kontributin e tij për të mundësuar bashkëpunimin me Bashkitë në zbatim të VKM-së nr. 435 datë 26.06.2024.

Gjithashtu, gjatë këtij viti ka mbledhur të dhënat statistikore lidhur me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje ( deri ne implementimin e strukturës së re keto të dhëna përfshinin edhe vendimet për miratimin e dokumentit të pronësisë për ndërtimet para datës 10.08.1991, trojet e tyre funksionale dhe oborret në përdorim).

- **Sektori i Privatizimeve, Objekteve pa tituj, Trojeve funksionale dhe Oborreve në përdorim**

Sektori i privatizimeve, objekteve pa tituj, trojeve funksionale dhe oborreve në përdorim, referuar strukturës së miratuar përbëhet nga Përgjegjësi dhe 3 specialistë, aktualisht janë 2 specialistë, dhe kryen veprimtarinë e mëposhtme:

- Trajton dhe shqyrton kërkesë/ankesat, korrespondeca me drejtoritë e vartësisë dhe me institucionet e tjera që lidhen me procedura e kalimit të pronësisë të të objekteve të ndërtuara para vitit 1991, trojeve funksional dhe oborreve në përdorim në referim të VKM Nr.827 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë…"
- Mban kontakte me sektorët e tjerë të drejtorië për marrjen e të dhënave të ndryshme, si dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti gjatë shqyrtimit të kërkesë/ankesave.
- Mbikqyr procesin e kalimit të pronësisë të objekteve pa tituj, trojeve funksional dhe oborreve në përdorim, në varësi të problematikave të hasura, sipas korrespondencës me drejtoritë vendore dhe/ose subjektet ankues, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas etapave të zhvillimit të këtij procesi.
- Evidenton problematika, paqartësi apo pasaktësi, bën verifikime të nevojshme gjatë zbatimit të procedurave administrative, në drejtorinë e vartësisë, merr masa konkrete për zgjidhjen e problematikave , duke i orientuar ato sipas rastit.
- Propozon për akte ligjore dhe nënligjore, si dhe akte të tjera me karakter normative, që rregullojnë mardhëniet juridike dhe administrative, gjatë procesit të kalimit të pronësisë për objektet pa tituj, trojet funksional dhe oborret në përdorim.
- Në zbatim të orientimeve të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Drejtorisë, punon për unifikimin e procedurave të kalimit të pronësisë.
- Organizon seminare, trajnime etj. Si dhe përgatit materialet përkatëse në përputhje me objektin e veprimtarisë, për drejtorinë e vartësisë.
- Në bashkëpunim me strukturat e tjera të institucionit kontribuon në organizimin e veprimtarive të ndryshme për informimin dhe sensibilizimin e opinionit publik mbi procesin e kalimit të pronësisë për objektet pa tituj, trojet funksional dhe oborret në përdorim.
- Në bazë të treguesve kryesorë në shkallë vendi dhe situates aktuale të ecurisë së procesit harton plan veprime e marrje masadh për përmirësimin dhe përshpejtimin e procesit të kalimit të pronësisë.
- Kryen çdo detyrë tjetër që lidhet me funksionet e këtij sektori, që ngarkohet nga eprorët.

Në këtë sektor, gjatë vitit 2024 (Tetor-Nëntor-Dhjetor / periudha e implementimit të strukturës), **janë administruar dhe trajtuar 178 shkresa** (kërkesë-ankesa qytetarësh, kthim përgjigje, shkresa nga institucione të ndryshme që bashkërendojnë punën me ASHK, etj..).

Problematika kryesore ka qenë vonesa në trajtimin administrativ të kërkesave për miratimin e titullit të pronësisë për objektet pa titull (ndërtuar para vitit 1991), trojeve të tyre funksionale dhe oborreve në përdorim, si dhe të regjistrimit të trojeve të dhëna për ndërtim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe per rregullimin e marredhenieve juridike te pronesise bi keto troje per efekt regjistrimi.

- **Sektori i AMTP-ve**

Sektori i AMTP-ve, përbëhet nga Përgjegjësi dhe 3 specialistë ( jurist, inxhinjer) dhe është përgjegjës / kryen veprimtarinë e mëposhtme:

-Trajtimin e ankesave të subjekteve në lidhje me regjistrimin e AMTP-ve të dhëna përpara hyrjes në fuqi të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe procesin e kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi për përdoruesit e tokës bujqësore.
-Monitorimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi për përdoruesit dhe regjistrimin e saj.
-Dhënien e asistencës për drejtoritë vendore të ASHK – së në varësi të problematikave të hasura nga ana e tyre.
-Evidenton problematika, paqartësi apo pasaktësi, bën verifikime të nevojshme gjatë zbatimit të procedurave administrative për regjistrimin e AMTP-ve dhe kalimin e TB nga përdorimi në pronësi, në drejtoritë e varësisë, merr masa konkrete për zgjidhjen e problemeve, duke i orientuar ato sipas rastit.
-Në zbatim të orientimeve të Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Drejtorisë përkatëse, punon për unifikimin e procedurave të regjistrimit të AMTP-ve dhe kalimin e TB nga përdorimi në pronësi.
- Kryen çdo detyrë tjetër që lidhet me funksionet e këtij sektori, që i ngarkohet nga eprorët.

Konkretisht, sa më sipër nga ana e sektorit gjatë vitit 2024 janë trajtuar **1314 shkresa**, të paraqitura nga individë apo institucione të ndryshme. Problematikat kryesore të trajtuara nga shkresat e mësipërme janë:

1- Vonesa në regjistrimin e AMTP-ve,
2- Përgjigjet jo korrekte dhe sipërfaqsore nga ana e drejtorive vendore të ASHK-së në kuadër të trajtimit të kërkesave për shërbime kadastrale.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 stafi i sektorit të AMTP-ve ka kryer edhe veprimtari të tjera në funksion të mbarëvajtjes së punës së sektorit: Konkretisht:

1- Kanë qënë pjesë e sekretariatit teknik të taskës forcës së ngritur me VKM nr. 320, datë 31. 05.2023 “Për ngritjen e task-forcës për koordinimin e procesit të trajtimit të tokave

bujqësore në përdorim, në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020", i ndryshuar. Sekretariati ka funksionuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme në mënyrë të vazhdueshme.

2- Kanë marrë pjesë në monitorimin e cilësisë së shërbimeve kadastrale të drejtorive vendore.
3- Kanë qënë pjesë e grupit të punës për hartimin e aktit nënligjore në zbatim të nenit 15 të ligjit 20/2020 "Për përfundimit e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH".
4- Kanë kryer trajnimin për drejtorinë vendore të ASHK-së Shkodër në lidhje me procesin e kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi në kuadër të Njësisë së Trajnimeve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
5- Ka ndjekur zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK-së dhe AZHBR, nr. 784/3 prot., datë 25.03.2024, në kuadër të projektit "Nafta për Bujqësinë".

**PROBLEMATIKA:**

Pavarsisht se afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit të ndarjes së tokës ka qënë data 07 Mars 2021, dorëzimi i këtij dokumentacioni mbetet akoma problem. Konkretisht akoma nuk është dorëzuar plotësisht dokumentacioni i ndarjes së tokës nga:

-DAMT pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, Berat, Gjirokastër dhe Kukës.

-Prefekturat e qarkut të Beratit, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës.

Kurse, nga ana e bashkive është dorëzuar gjithë dokumentacioni arkivor i administruar, por duhet thënë që ky dokumentacion është shumë i mangët.

Mënyra e administrimit të këtij dokumentacioni, i cili është baza për shqyrtimin e kritereve ligjore për regjistrimin e AMTP-ve të dhëna përpara hyrje snë fuqi të ligjit 20/2020 "për përfundimin e proceseve kalimtare në RSH" dhe kalimin e Tokës Bujqësore nga përdorimi, në pronësi, pa shpërblim, e vështirëson finalizimin e tij.

# VI. HARTIMI I LEGJISLACIONIT, KONTOROLLI TEKNIKO-LIGJOR, ANTIKORRUPSIONI DHE ÇËSHTJET GJYQËSORE

**Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor ka në përbërje të saj 4 sektorë:**
1. Sektori i Hartimit të Legjislacionit
2. Sektori i Kontrollit Tekniko-Ligjor
3. Sektori i Antikorrupsionit
4. Sektori i Çështjeve Gjyqësore

Më poshtë jepet analiza e secilit sektor për vitin 2024, për veprimtarinë e tyre sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të ushtruara prej tyre.

- **Sektori i Hartimit të Legjislacionit**

Sektori i Hartimit te Legjislacionti në strukuturë përbëhet nga 4 punonjës, 1 përgjegjës dhe 3 specialist. Në funksion të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni për kadastrën, si dhe ai për proceset kalimtare të pronësisë, Sektori i Hartimit të Legjislacionit, ka hartuar mbi 99 % të akteve nënligjore (projektvendime të Këshillit të Ministrave), në zbatim të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" dhe ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH".

Referuar fushës së saj të veprimtarisë për vitin 2024 nga Sektori i Hartimit të Legjislacionit janë përmbushur funksionet administrative në drejtimet sa vijon:

**Hartimi i akteve nënligjore**
Akte nënligjore në zbatim të Ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" dhe Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH" të hartuara dhe miratuara në vitin 2024 janë sa vijon:

| Nr. | Aktet nënligjore të miratuara për vitin 2024 |
|---|---|
| 1 | **Vendim i Këshillit të Ministrave nr.639, datë 16.10.2024 "**Për përcaktimin e elementeve formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi". |
| 2 | **Vendim i Këshillit të Ministrave nr.638, datë 16.10.2024** "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të bashkërendimit të punës ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave". |
| 3 | **Vendim i Këshillit të Ministrave nr.319, datë 29.5.2024** "Për disa ndryshime në vendimin nr.782, datë 7.10.2020,"Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale"; |
| 4 | **Vendimi i Keshillit të Ministrave nr.465, datë 17.07.2024** "Për disa shtesa në vendimin nr.1179, datë 24.12.2020, "Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës |

| | |
|---|---|
| | së të dhënave për pasuritë e paluajtshme dhe për miratimin e listës së institucioneve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave” |
| 5 | **Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.1, datë 17.07.2024** “Për miratimin e modelit dhe përcaktimin e rregullave të mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit si dhe të procedurave të regjistrimit të kontratës së sipërmarrjes/porosisë dhe të premtim shitjes”**;** |
| 6 | **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 24.7.2024** “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.322,datë 31.5.2023,“Për miratimin e strukturës së pages dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve administrative në Agjencinë Shtetërore të kadastrës”; |
| 7 | **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 12.8.2024** “Për një ndryshim në vendimin nr.322, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve administrative në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”,të ndryshuar; |
| 8 | **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 10.10.2024** “Për disa ndryshime në vendiminnr.1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave,“Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”; |
| 9 | **Vendim i Keshillit të Ministrave nr.752, datë 13.12.2024** “Për miratimin e rregullave për administrimin e regjistrit të objekteve të konfiskuara,të dhënave parësore e dytësore të tij, subjekteve të interesuara dhe nivelit të aksesit”; |
| 10 | **Urdhër i Kryeministrit nr.110, date 16.07.2024** “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ASHK-së” ndryshuar me Urdhrin nr.147, datë 01.08.2024. |

**Akte të brendshme të miratuara në ASHK në vitin 2024**

| Nr. | Akte të miratuara |
|---|---|
| 1. | **Urdhër i DP nr.829, datë 09.05.2024** “Për miratimin e modelit të matrikullit në zbatim të VKM nr.605, datë 29.07.2020”; |
| 2 | **Urdhër nr.513, datë 05.03.2024** “Për ngritjen dhe organizimin e Njësisë së Trajnimeve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”; |
| 3. | **Urdhër nr.585, datë 18.03.2024** “Mbi miratimin e rregullores “Mbi funksionimin e Njësië së Trajnimeve për punonjësit e strukturave të ASHK-së” ; |
| 4. | **Udhëzim nr.788, datë 30.04.2024** “Për miratimin e modeleve të akteve në zbatim të pikës 32 të VKM nr.1189, datë 24.12.2020”; |

| | |
|---|---|
| 5 | **Udhëzim nr.1318, datë 18.07.2024** "Modeli dhe mënyra e plotësimit të dokumentacionit teknik"; |
| 6 | **Udhëzim nr.1320, datë 18.07.2024** "Për miratimin e dokumentacionit hartografik që hartohet për objektet pa titull pronësie, truallit të tyre funksional dhe të oborreve në përdorim"; |
| 7 | **Urdhër i DP nr.1456, datë 06.09.2024** "Për përditësimin dhe saktësimin e listës së dokumentacionit tekniko ligjor të kërkesave për shërbime kadastrale që ofrohen nga Drejtoritë/Zyrat Vendore të ASHK-së në zbatim të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën"; |
| 8 | **Udhëzim nr.1557, datë 18.09.2024** "Për rregullat e hollësishme për mënyrën e plotësimit dhe administrimit të akteve kadastrale" |

**Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet/entet publike të realizuara në vitin 2024**

- Marrëveshje Bashkëpunimi midis ASHK dhe Koorporatës së Investimeve Shqiptare nr.3953/44 prot, datë 12.03.2024;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Universitetit të Tiranës dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr.10395 prot, datë 23.06.2024;
- Marrëveshje bashkëpunimi midis ASIG dhe ASHK nr.544/2/11182/1 prot, datë 25.09.2024;
- Aneksi ½ nr. 5243 prot., datë 15.04.2024 "Për disa ndryshime në Protokollin Teknik të ndërveprimit ASHK-NISA të marrëveshjes së bashkëpunimit nr.185 prot., datë 08.01.2020 të lidhur midis ASHK dhe Dhomës së Noterisë";
- Marrëveshjet midis ASHK-së dhe Bashkive në kuadër të përmbylljes së procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje në zbatim të VKM nr.435, date 26.06.2024 "Për një shtesë në Vendimin nr.867, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore".

**Dhënie mendimi për 74 projektakte të përcjella për mendim në ASHK nga institucione të tjera për vitin 2024.**

**Shkresa unifikuese/orientuese në vitin 2024**

- Shkresa nr.1382 prot., datë 21.01.2024 "Mbi regjistrimin e akt marrëveshjeve të ndërmjetësimit";
- Shkresa nr.13240 prot., datë 13.11.2024 "Mbi mënyrën e trajtimit të shërbimeve kadastrale";
- Shkresa nr.12541/1 prot., datë 18.11.2024 "Mbi mënyrën e ndërveprimit ASHK- Dhoma Kombëtare e Noterisë në kuadër të trajtimit të shërbimeve kadastrale të aplikuara nëpërmjet sistemit NISA";

- Shkresë nr.5971/39 prot., datë 07.11.2024 "Lidhur me kërkesat e përmbaruesve gjyqësore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë lidhur me objekt dëmshpërblim page".

**Trajnimet në ASHK për vitin 2024**

ASHK gjatë vitit 2024 me qellim rritjen e nivelit profesional të punojësve të drejtorive vendore të ASHK-së, performancës së tyre, kapaciteteve të burimeve njerëzore, përnirësimit të cilësisë në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative, rritjes së performancës, Drejtoria e Përgjithshme ka zhvilluar trajnime mujore për drejtoritë vendore të ASHK-së sipas programit dhe kalendarit vjetor të miratuar, sipas akteve të mëposhtme:

- **Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm nr.688, datë 04.04.2024** "Për miratimin e Programit dhe Kalendarit Vjetor të Trajnimit të ASHK-së për vitin 2024", i ndryshuar me Urdhrin nr.1906, datë 24.10.2024;
- **Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm nr.685, datë 04.04.2024 "**Për miratimin e listës së trajnerëve të brendshëm të ASHK-së për zhvillimin e programit vjetor të trajnimit për vitin 2024", i ndryshuar me Urdhrin nr.192, datë 28.10.2024.

**Korrespondencë shkresore për vitin 2024 me institucione apo DVASHK për problematika lidhur me pasuritë e paluajtshme, apo subjektet në total 750 shkresa.**

- **Sektori i Kontrollit Tekniko-Ligjor**

Sektori i Kontrollit Tekniko-ligjor përbëhet nga Përgjegjësi dhe 8 specialistë ( jurist, inxhinjer, arkitekt) dhe është përgjegjës / kryen veprimtarinë e mëposhtme:

- Ushtron kontrolle tekniko-ligjore mbi bazën e programeve periodike të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, pranë drejtorive/zyrave vendore të ASHK, për respektimin e dispozitave të Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH" dhe Ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën", si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre.
- Harton projektaktet/aktet përkatëse të kontrollit, dhe i paraqet ato për miratim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK, në përputhje me pikën dh, të nenit 9, të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".
- Kryen kontroll administrativ mbi aktet e drejtorive/zyrave vendore mbi bazën e ankesave të paraqitura pranë Drejtorisë së Përgjithshme.
- Propozon masa organizative, disiplinore dhe gjoba për kundërvajtjet administrative të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit, në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative dhe Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", dhe Ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën".
- Për vitin 2024 është miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.780, datë 29.04.2024, planveprimi për kryerjen e kontrolleve në Drejtoritë/Zyrat Vendore të ASHK-së në zbatim të Ligjit nr.111/2018 " Për Kadastrën" dhe Ligjit nr.20/2020 " Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre duke përcaktuar tematikat përkatëse, si dhe afatet e monitorimit dhe kontrollit.

- Për 3 mujorëshin e parë të vitit 2024, nga Sektori i Kontrollit Tekniko-ligjor dhe të Cilësisë së Shërbimit në zbatim të Urdhërit nr. 53, datë 15.01.2024 - Mbi zbatimin e shkresës nr.14395 prot., datë 26.10.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme *" Për verifikimin e pasqyrimit të veprimeve në hartat manuale, përpunimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të regjistrimit në arkivë të referencave",* është ushtruar kontroll në Drejtoritë / Zyrat Vendore të ASHK-së dhe janë lënë masa administrative për zbatim menjëherë dhe në vazhdim me Akt Kontrollin Nr.4513, datë 27.03.2024, si dhe nisur nga performanca e punës janë propozuar masa disiplinore "Vërejtje" (9 masa disiplinore ) dhe / ose "Tërheqje vëmendje"( 5 masa disiplinore) për Drejtorët / Përgjegjësit e Drejtorive /Zyrave Vendore të ASHK-së, ( në total 13 masa disiplinore).

- Në mbështetje të Kreut X nenet 77 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, pikës dh, të nenit 9, të ligjit nr.111/2018, "Për Kadastrën", si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 557, datë 12.03.2024, *"Për kryerjen e kontrollit të proceseve të punës në dhënien e shërbimeve kadastrale në Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës",* është ushtruar kontroll në Drejtoritë Vendore të ASHK-së, mbi proceset e punës lidhur me trajtimin e kërkesave/aplikimeve nga Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe të Cilësisë së Shërbimit, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, si dhe Sektori i Bashkëqeverisjes në datat 13 – 23 Mars 2024, dhe janë lënë masa administrative për zbatim menjëherë dhe në vazhdim me Akt Kontrollin Nr.8578, datë 03.07.2024, si dhe nisur nga performanca e punës janë propozuar masa disiplinore "Tërheqje vëmendje" ( 28 masa disiplinore), "Vërejtje"( 62 masa disiplinore), dhe "Vërejtje me shkrim"( 18 masa disiplinore) për specialistë, përgjegjës të sektorit të regjistrimit dhe shërbimeve të kadastrës, si dhe për Drejtorët / Përgjegjësit e Drejtorive /Zyrave Vendore të ASHK-së( në total 108 masa disiplinore).

- Për 3 mujorëshin e dytë të vitit 2024, në zbatim të pikës dh, të nenit 9, të ligjit nr.111/2018, "Për Kadastrën", nenit 34 të Ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.827, datë 30.09.2020 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve funksionale dhe oborreve në përdorim", si dhe Urdhërit Nr.781, datë 29.04.2024 *" Për kryerjen e kontrollit në Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastres "* është ushtruar kontroll në të gjitha Drejtoritë Vendore të ASHK-së mbi zbatimin e procedurave administrative për vendimmarrjet në zbatim të nenit 34 të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.827, datë 30.09.2020 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve funksionale dhe oborreve në përdorim", për periudhën Janar 2022 deri në Qeshor 2023. Në vijim nga Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor, janë lënë 185 masa administrative për zbatim menjëherë dhe në vazhdim, si janë propozuar 103 masa disiplinore për nëpunësit / specialistët përgjegjës.

- Gjithashtu, paralelisht është vijuar për periudhën janar – dhjetor 2024 nga SKTL me shqyrtimin dhe trajtimin e 384 ankesave të qytetarëve/ subjekteve të ndryshme, 12 Memo

për verifikim të përcjella nga Drejtor të DVASHK, nga Drejtori dhe Sektorë të ndryshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, lidhur me kërkesë / ankesa të subjekteve të administruara shkresërisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së lidhur me mos zbatimin / respektimin e afateve në trajtimin e kërkesave/ aplikimeve të paraqitura për shërbime kadastrale, për problematika të ndryshme për të cilat nuk ka një përgjigje / qëndrim shterues nga drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-ve ku janë propozuar 32 masa disiplinore, ku për 3 prej këtyre hetimeve administrative janë kryer kallëzime penale në Mars të vitit 2025, si dhe Sektorit të Kontrollit Tekniko Ligjor i janë deleguar edhe 8 raporte të Ministrisë së Drejtesisë (Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit) të cilat janë përcjellë për kompetencë dhe zbatim pranë DVASHK.

- **Sektori i Antikorrupsionit**

Sektori i Antikorrupsionit, objekt të veprimtarisë së tij ka kryesisht trajtimin e kërkesë/ankesave të ndryshme, nga qytetarët, nga subjekte private ashtu edhe publikë, si dhe shkresa të cilat kanë ardhur nga institucionet shtetërore si Ministria e Drejtësisë, KLSH, Institucioni i Avokatit të Popullit, etj.

Objekti i kërkesave/ankesave lidhet kryesisht me:

1. Për regjistrim të titujve të pronësisë;
2. Për pajisje me dokumenta pronësie;
3. Për marrjen e kopje të vërtetuar të dokumenteve tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme/faqe.
4. Për vendosje apo heqje kufizimesh të përkohshme, në kartelat e pasurive;
5. Përfundimin e procedurave të legalizimit;
6. Miratimin e VKM për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore/kompesimin e pronarit të truallit;
7. Kërkesa për kalimin e pronësisë të objekteve pa titull /truallit funksional oborrit në përdorim.
8. Kërkesa për rregjistrim të tokës bujqësore, si dhe kalimin e pronësisë pa shpërblim të tokës bujqësore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, Sektori i Antikorrupsionit, ka deleguar 885 praktika pranë drejtorive vendore të ASHK-së për shqyrtim/ trajtim administrativ e informim, nga të cilat 473 janë trajtuar.

| Emërtimi i Drejtorisë | Dërguar | Trajtuar |
|---|---|---|
| DVASHK Berat | 46 | 34 |
| DVASHK Dibër | 14 | 6 |
| DVASHK Durrës | 83 | 53 |
| DVASHK Elbasan | 35 | 20 |
| DVASHK Fier | 54 | 31 |
| DVASHK Gjirokastër | 25 | 9 |

| | | |
|---|---|---|
| DVASHK Kamëz - Vorë | 44 | 38 |
| DVASHK Kavajë | 23 | 6 |
| DVASHK Korçë | 34 | 18 |
| DVASHK Krujë | 5 | 2 |
| DVASHK Kuçovë | 7 | 4 |
| DVASHK Kukës | 11 | 7 |
| DVASHK Lezhë | 18 | 7 |
| DVASHK Lushnjë | 14 | 9 |
| DVASHK Pogradec | 11 | 7 |
| DVASHK Sarandë | 44 | 29 |
| DVASHK Shkodër | 65 | 15 |
| DVASHK Tepelenë | 4 | 0 |
| DVASHK Tirana Veri | 97 | 45 |
| DVASHK Tirana Jug | 58 | 49 |
| DVASHK Tirana Rurale 1 | 46 | 17 |
| DVASHK Tirana Rurale 2 | 40 | 17 |
| DVASHK Vlorë | 106 | 50 |
| DVASHK Zonat e Stimuluara | 1 | 0 |
| **TOTALI** | **885** | **473** |

- **Sektori i Çështjeve Gjyqësore**

Për vitin 2024, nga raportimet e kryera nga drejtoritë dhe zyrat vendore të ASHK, rezulton se:
Numri i përgjithshem i gjyqeve të zhvilluara, është **504 çështje**
Numri i çështjeve të fitura është, **386 çeshtje**
Numri i çështjeve të humbura, **118 çështje.**

Në kuadër të raportit për analizen vjetore të ASHK për vitin 2024, indikatori që raportohet nga Sektori i Çeshtjeve Gjyqësore ka të bëjë me trendin e gjyqeve të fituara në raport me gjyqet e zhvilluara.

# VII. BUXHETI DHE MENAXHIMI FINANCIAR.

**A. Të ardhurat**
**B. Shpenzimet**

## A. Të ardhurat nga shërbimet dhe legalizimet e pasurive të paluajtshme

### *1. Planifikimi buxhetor.*

Në mbështetje të ligjit nr.11/2018 "Për Kadastrën", ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin I ndryshuar, ASHK **ka përgatitur Programin Buxhetor** për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 25 Drejtoritë e varësisë për vitin 2024. Në zbatim të Vendimit nr.40 datë 24..01.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2024", shkresës me Nr.2142 prot., datë 05.02.2024 "Dërgohet detajimi i buxhetit për vitin 2024"nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, është kryer detajimi i fondeve buxhetore dhe detajimi i limiteve mujore për drejtoritë e varësisë të ASHK-së. Kjo procedure është realizuar edhe për numrin e punonjësve, të miratuar për Institucionin (në strukturë dhe me kontratë). Si rezultat, Drejtoria e Përgjithshme dhe të gjitha Drejtoritë e varësise së ASHK-së, filluan vitin buxhetor 2024 me fonde dhe numër punonjësish të miratuar, me vendim të Këshillit Drejtues dhe VKM-së për Buxhetin për vitin 2024 , në përputhje me procedurat dhe afatet ligjore.

### *2. Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve të veta buxhetore .*

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka bërë menaxhimin dhe monitorimin periodik të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme dhe të gjitha Drejtoritë Vendore të ASHK-së, për cdo muaj dhe progresive për periudhën Janar-Dhjetor 2024. Në përmbushje të detyrimit ligjor janë përgatitur periodikisht, cdo muaj evidencat e monitorimit të shpenzimeve dhe të të ardhurave të realizuara nga shërbimet nga regjistrimi dhe të ardhurat e realizuara nga legalizimi.
Për periudhën Janar- Dhjetor 2024, janë administruar dhe menaxhuar fondet sipas programit buxhetor:

- Të ardhura(Nga shërbimet dhe legalizimet)
- Shpenzime

Të ardhurat në total për periudhën Janar – Dhjetor 2024 janë realizuar në masën 3,142,592,108 lekë, ose 116% krahasuar me planin ose 432,592,108 lekë më shumë. Të ardhurat e realizuara nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme (ofrimi I shërbimeve ) janë realizuar në masën 2,541,608,403 lekë ose 115%, ose 331,608,403 lekë më shumë, dhe të ardhurat e realizuara nga legalizimi (parcelë ndërtimore +të tjera) janë realizuar në masën 544,439,446 lekë, ose 108.8%, ose 44,439,446 lekë më shumë, në krahasim me planin, të cilat janë paraqitur në mënyrë tabelare si më poshtë:

Në /lekë

| Të ardhurat e ASHK-së në total (Regjistrimi + legalizimi ) | | |
|---|---|---|
| Periudha | Plani Janar-Dhjetor 2024 | Fakti Janar-Dhjetor 2024 |
| Vlera | 2,710,000,000 | 3,142,592,108 |

| Të ardhurat e ASHK-së nga regjistrimi | | |
|---|---|---|
| Periudha | Plani Janar-Dhjetor 2024 | Fakti Janar-Dhjetor 2024 |
| Vlera | 2,210,000,000 | 2,541,608,403 |

| Të ardhurat e ASHK-së nga legalizimi | | |
|---|---|---|
| Periudha | Plani Janar-Dhjetor 2024 | Fakti Janar-Dhjetor 2024 |
| Vlera | 500,000,000 | 544,439,446 |

Totali i të ardhurave bashkë me pjesën takuese të ATP-së prej 853,691,930 lekë është 3,996,284,038 lekë
Në realizimin e të arsdhurave mbi plan ka ndikuar rritja e numrit të shërbimeve dhe të ardhurave nga shërbimet duke filluar nga muaji Korrik e deri në fund të Dhjetorit
Të ardhura sherbime Janar-Dhjetor 2024

| NR | PERIUDHA | NR SHER. | ARDHURAT |
|---|---|---|---|
| 1 | JANAR | 122,846 | 224,908,172 |
| 2 | SHKURT | 77,946 | 172,970,744 |
| 3 | MARS | 113,626 | 250,450,750 |
| 4 | PRILL | 106,307 | 256,971,647 |
| 5 | MAJ | 116,765 | 378,437,738 |
| 6 | QERSHOR | 83,463 | 208,766,796 |
| 7 | KORRIK | 102,442 | 249,589,700 |
| 8 | GUSHT | 86,897 | 247,269,791 |
| 9 | SHTATOR | 89,183 | 249,955,984 |
| 10 | TETOR | 142,347 | 323,214,963 |
| 11 | NENTOR | 99,384 | 256,175,016 |
| 12 | DHJETOR | 133,820 | 323,880,807 |
| | **SHUMA** | **1,275,026** | **3,142,592,108** |

Ndërsa krahasuar me vitin 2023 të ardhurat të detajuara në muaj janë si më poshtë:
Të ardhurat e realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2023/ 2024 të paraqitura në mynyrë tabelare dhe grafike rezultojnë si më poshtë:

Të ardhurat sipas muajve Janar-Dhjetor 2023/2024

Në lekë

| NR | PERIUDHA | ARDHURAT 2023 | ARDHURAT 2024 |
|---|---|---|---|
| 1 | JANAR | 265,393,817 | 224,908,172 |
| 2 | SHKURT | 225,064,651 | 172,970,744 |
| 3 | MARS | 272,065,656 | 250,450,750 |
| 4 | PRILL | 149,801,996 | 256,971,647 |
| 5 | MAJ | 264,627,722 | 378,437,738 |
| 6 | QERSHOR | 273,069,515 | 208,766,796 |
| 7 | KORRIK | 174,699,897 | 249,589,700 |
| 8 | GUSHT | 199,494,678 | 247,269,791 |
| 9 | SHTATOR | 214,330,643 | 249,955,984 |
| 10 | TETOR | 227,400,300 | 323,214,963 |
| 11 | NENTOR | 203,386,069 | 256,175,016 |
| 12 | DHJETOR | 347,570,321 | 323,880,807 |

| | TOTALI | 2,816,905,266 | 3,142,592,108 |
|---|---|---|---|




Sipas tabelës së mësipërme rezulton që të ardhurat e realizuara për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 janë 111.5 % ose 325,686,842 lekë më shumë se në 2023

Në realizimin e të ardhurave nga regjistrimi peshën më të madhe e zenë të ardhurat nga shërbimet e mëposhtme:

1) Lëshim certifikate pronësise (12% te totalit te te ardhurave)
2) Lëshim kopje kartele te pasurise (14% te totalit te te ardhurave)
3) Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale (12 % të totalit të të ardhurave)

Në të ardhurat për periudhën Janar-Dhjetor 2024 nga shërbimet **nuk përfshihen:**

1.Të ardhurat që ASHK vjel dhe derdh në buxhetin e shtetit si agjent tatimor për:

- Tatimin mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë (15%)

2.Të ardhurat që ASHK vjel nga legalizimi

- Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe Zonat Turistike për ATP-në(përkatësisht në masën 70% dhe 50% )

Në/lekë

| Nr | Emërtimi | Vlera 15% | Vlera ATP |
|---|---|---|---|
| 1 | Tatimi mbi te ardhurat nga kalimii pronësisë 15% | **5,586,371,521** | |
| 2 | Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe Zonat turistike për ATP-në | | 853,691,930 |
| | Nga kjo(3):Transferuar në ATP | | 833,229,601 |

<u>**Të ardhurat nga Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë** për periudhën Janar-Dhjetor 2024</u>

Në zbatim të Ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ardhurat që ASHK vjel si agjent tatimor për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë, derdhen:

a) 97 % për buxhetin e Bashkisë apo Njesise Administrative, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.
b) 3% në buxhetin përkatës të DrejtoriveVendore të ASHK-së, në llogaritë respektive jobuxhetore.

| NR | EMERTIMI | VLERA |
|---|---|---|
| 1 | **TIRANA VERI** | 6,832,827 |
| 2 | **TIRANA JUG** | 5,006,997 |
| 3 | **VLORË** | 2,673,382 |
| 4 | **DURRËS** | 2,561,630 |
| 5 | **TIRANA RURALE 2** | 1,562,006 |
| 6 | **KAVAJË** | 1,434,530 |
| 7 | **LEZHË** | 1,145,692 |
| 8 | **TIRANA RURALE 1** | 885,188 |
| 9 | **FIER** | 467,430 |
| 10 | **ELBASAN** | 425,545 |
| 11 | **SHKODER** | 296,794 |
| 12 | **KAMËZ -VORË** | 256,067 |
| 13 | **KORÇË** | 252,007 |
| 14 | **SARANDË** | 215,926 |
| 15 | **LUSHNJE** | 122,571 |
| 16 | **POGRADEC** | 94,388 |
| 17 | **KRUJË** | 81,976 |
| 18 | **BERAT** | 76,507 |
| 19 | **GJIROKASTER** | 48,802 |
| 20 | **KUÇOVË** | 7,088 |
| 21 | **DIBER** | 6,366 |
| 22 | **TEPELENË** | 1,806 |
| 23 | **KUKËS** | 593 |
| | **TOTALI** | **24,456,117** |




Të ardhurat totale nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë **24,456,117** lekë.

Drejtoritë Vendore që kanë pasur më shumë kalime pronësie të pasurive që kanë qenë në pronësi të subjekteve tregtare janë: Tirana Veri , Tirana Jug, Vlorë, Durrës, Tirana Rurale 2, Kavajë, Lezhë, Tirana Rurale 1, Fier, Elbasan, Shkodër, Kamëz-Vorë etj.

**<u>Numri i shërbimeve nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme për periudhën Janar- Dhjetor 2024</u>**

Njësia aktuale e matjes së nivelit të punës në sistemin e regjistrimit është "shërbimi". Në këtë kontekst një "shërbim" ështe çdo transaksion që ndodh në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës kur kërkohet një kopje e kartelës, një kërkesë për lëshimin e çertifikatës, një kerkesë për regjistrimin e një dokumenti apo kërkesa për shërbime të tjera, ndër 76 shërbimet e ndryshme që ofron ASHK.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024 numri i shërbimeve është **1,275,026** dhe është realizuar 111% krahasuar me planin, ose 124,933 shërbime më shume dhe 110.6 % krahasuar me vitin 2023. Në mënyrë tabelare paraqitet si më poshtë:

| **Numri i sherbimeve te arketuara ne ASHK , Janar - Dhjetor 2024** | | |
|---|---|---|
| **Plani** | | **Fakti** |
| **Totali** | **1,150,000** | **1,275,026** |

| **Numri I sherbimeve te arketuara ne ASHK , Janar - Dhjetor 2023/2024** | | |
|---|---|---|
| **Fakti 2023** | | **Fakti 2024** |
| **Totali** | **1,152,298** | **1,275,026** |

Shërbimet të cilat zenë peshën specifike më të madhe janë:
Lëshim certifikate pronësije 18 %
Lëshim fragment harte kadastrale 23%
Lëshim kopje kartele 26%

### B. Shpenzimet nga të ardhurat

Në mbështetje të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", në bazë të Urdhërit nr. 15 date 31.01.2022, Urdhërit nr.236, datë 22.12.2023, Urdhërit nr.147, datë 1.08.2024 të Kryeministrit ,"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Shteterore të Kadastrës "dhe në zbatim të Udhëzimeve "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", njësitë shpenzuese të Institucionit tonë (DP dhe DV) vazhdojne veprimtarinë e tyre në bazë të të ardhurave të realizuara ku kryejnë shpenzimet për paga sigurime shoqerore, mallra, shërbime dhe investime sipas buxhetit të disponueshëm të planifikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2024
Ndryshimet në nivelin e pagave kanë ardhur si rezultat i zbatimit të VKM Nr.421, datë 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime , në vendimin Nr.325,datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave Për miratimin e strukturës së pagave,niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë ,të Zëvëndësministrit,funksionarëve të kabineteve, prefektit,nënprefektit,nëpunësve civilë dhe nëpunësvene disa institucione të administratës publike"", dhe Vendimit nr.422,datë 26.06.2024 "Për një ndryshim në vendimin nr.326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, në disa institucione të administratës publike" të ndryshuar".

**1.Shpenzimet e personelit** për cdo njësi shpenzuese janë ekzekutuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 24.01.2024 " Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2024" Urdherin nr. 15 date 31.01.2022, Urdhërit nr.236, datë,22.12.2023,Urdhër nr.147, datë 1.08.2024 të Kryeministrit ," Për miratimin e struktures dhe te organikes te agjencise Shteterore te Kadastres , si dhe ndryshimeve në nivelin e pagave , si rezultat i zbatimit të VKM nr.421, datë 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime , në vendimin Nr.325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës së pagave,niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë ,të Zëvëndësministrit,funksionarëve të kabineteve, prefektit,nënprefektit,nëpunësve civilë dhe nëpunësvene disa institucione të administratës publike", dhe Vendimit nr.422,datë 26.06.2024 "Për një ndryshim në vendimin nr.326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, në disa institucione të administratës publike"të ndryshuar.

**Realizimi i shpenzimeve në total për paga , sigurime , fond të vecantë, shpenzime operative dhe investime rezulton si më poshtë për periudhën Janar-Dhjetor 2024**

| Nr. | Artikulli | Zërat e shpenzimeve | Plan | Fakt | Realizimi ne % sipas zerave |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 600 | Paga Strukture+Kontrate | 2,175,615,956 | 2,065,277,763 | 95% |
| 2 | 606 | Fondi I vecante | 65,510,000 | 3,208,386 | 5% |
| 3 | 601 | Sig.shoq.shendetesore | 364,032,954 | 349,577,784 | 96% |
| 4 | 602 | Shpenzime operative | 594,946,000 | 455,452,836 | 77% |
| 5 | 231 | Investime te trupezuara | 687,930,000 | 432,813,597 | 63% |
| 6 | 230 | Investime te patrupezuara | 656,926,000 | 59,676,548 | 9% |
| | | **Totali shpenzime** | **4,544,960,910** | **3,366,006,914** | **74%** |

Shpenzimet e Agjencisë Shtetërore të Kadasrës për artikujt 600,601,606(paga,sigurime, fond i vecante) për cdo njësi shpenzuese rezulton si me poshtë vijon:

Në lekë

| NR | EMERTIMI | Totali 600-Paga (struktura +kontrate ) | | Totali 601(Struktura+ kontrat) | | 606 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
| 1 | DREJTORIA E PËRGJITHSHME | 269,685,708 | 247,159,187 | 43,617,512 | 40,701,577 | 62,003,000 | 481,200 |
| 2 | TIRANA VERI | 112,559,112 | 112,188,353 | 18,792,012 | 18,516,052 | 140,000 | 133,389 |
| 3 | TIRANA JUG | 122,687,400 | 120,642,784 | 20,888,796 | 20,355,365 | 228,000 | 222,200 |
| 4 | TIRANA RURALE 1 | 101,845,512 | 96,699,699 | 17,029,946 | 16,345,746 | 30,000 | 30,000 |
| 5 | TIRANA RURALE 2 | 115,834,480 | 114,837,024 | 19,227,458 | 19,072,818 | 193,000 | 172,340 |
| 6 | DURRËS | 117,645,648 | 103,386,311 | 19,647,105 | 18,351,566 | 237,000 | 8,500 |
| 7 | ELBASAN | 133,002,496 | 132,739,380 | 23,693,417 | 23,580,557 | 346,000 | 140,000 |
| 8 | VLORË | 101,025,152 | 89,876,885 | 16,871,146 | 14,893,994 | 302,000 | 286,400 |
| 9 | KAMËZ -VORË | 102,992,640 | 100,838,837 | 17,200,171 | 17,012,356 | 255,000 | 255,060 |
| 10 | SHKODER | 96,063,464 | 85,953,430 | 16,041,739 | 13,678,614 | 129,000 | 124,000 |
| 11 | FIER | 105,004,128 | 98,879,670 | 17,535,689 | 16,717,492 | 316,000 | 287,000 |
| 12 | KORÇË | 75,863,376 | 70,935,197 | 12,729,455 | 12,039,147 | 149,000 | 134,980 |
| 13 | LEZHË | 91,621,584 | 91,434,813 | 15,300,805 | 15,188,937 | 271,000 | 187,187 |
| 14 | BERAT | 51,754,080 | 57,497,130 | 8,836,931 | 10,013,069 | 30,000 | 30,000 |
| 15 | KAVAJË | 51,142,104 | 49,784,668 | 8,512,275 | 8,511,480 | 80,000 | 110,000 |
| 16 | GJIROKASTER | 43,517,520 | 42,512,963 | 7,267,426 | 7,052,826 | 122,000 | 116,400 |
| 17 | KRUJË | 43,962,720 | 40,307,456 | 7,341,774 | 6,814,194 | 107,000 | 146,400 |
| 18 | LUSHNJE | 55,630,560 | 50,992,704 | 9,290,304 | 8,565,783 | 177,000 | 171,200 |
| 19 | POGRADEC | 41,717,520 | 42,293,361 | 6,966,826 | 7,037,601 | 15,000 | 0 |
| 20 | SARANDË | 57,060,520 | 57,007,050 | 9,562,307 | 9,560,345 | - | 8,700 |
| 21 | DIBER | 45,849,632 | 44,283,557 | 7,687,103 | 7,483,109 | 30,000 | 20,000 |
| 22 | KUKËS | 37,158,680 | 36,810,414 | 6,221,500 | 6,113,538 | 30,000 | 20,000 |
| 23 | ZONAT E STIMULUARA | 41,819,160 | 38,661,153 | 6,983,800 | 6,517,793 | 15,000 | 31,809 |
| 24 | KUÇOVË | 13,526,200 | 0 | 2,246,777 | 0 | - | |
| 25 | TEPELENË | 13,625,480 | 9,593,941 | 2,280,662 | 1,676,810 | - | |
| 26 | Drejt.Prones Shteterore | 13,500,000 | 9,226,883 | 2,300,000 | 1,098,334 | | |
| 27 | Qendra Kadastres Digjitale | 119,521,080 | 120,734,913 | 19,960,020 | 22,678,682 | 305,000 | 91,621 |
| | **TOTALI** | **2,175,615,956** | **2,065,277,763** | **364,032,954** | **349,577,784** | **65,510,000** | **3,208,386** |

**2.Shpenzimet operative dhe investimet**, janë shpërndarë për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 25 Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për **për periudhën Janar- Dhjetor 2024** duke u mbështetur në limitin buxhetor të planifikuar dhe nevojat që kanë këto drejtori.

| NR | EMERTIMI | SHPENZIME OP. 602 | | INVESTIME 231 | | INVESTIME 230 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
| 1 | DREJTORIA E PËRGJITHSHME | 282,511,000 | 246,817,303 | 687,930,000 | 399,790,559 | 656,926,000 | 92,699,586 |
| 2 | TIRANA VERI | 13,660,000 | 10,810,033 | | 0 | | 0 |
| 3 | TIRANA JUG | 15,610,000 | 8,866,085 | | | | 0 |
| 4 | TIRANA RURALE 1 | 13,100,000 | 7,755,881 | | | | |
| 5 | TIRANA RURALE 2 | 10,580,000 | 7,735,233 | | | | 0 |
| 6 | DURRËS | 21,230,000 | 12,198,967 | | | | 0 |
| 7 | ELBASAN | 15,525,000 | 9,298,597 | | | | 0 |
| 8 | VLORË | 20,930,000 | 18,154,782 | | | | 0 |
| 9 | KAMËZ -VORË | 11,935,000 | 5,658,932 | | | | 0 |
| 10 | SHKODER | 17,340,000 | 8,923,757 | | | | 0 |
| 11 | FIER | 17,960,000 | 11,498,190 | | | | 0 |
| 12 | KORÇË | 16,105,000 | 11,403,152 | | | | 0 |
| 13 | LEZHË | 19,130,000 | 15,324,893 | | | | 0 |
| 14 | BERAT | 16,380,000 | 14,315,585 | | | | 0 |
| 15 | KAVAJË | 15,350,000 | 3,801,343 | | | | 0 |
| 16 | GJIROKASTER | 9,990,000 | 9,572,656 | | | | 0 |
| 17 | KRUJË | 5,000,000 | 1,213,203 | | | | 0 |
| 18 | LUSHNJE | 11,040,000 | 8,288,417 | | | | 0 |
| 19 | POGRADEC | 8,925,000 | 6,351,173 | | | | 0 |
| 20 | SARANDË | 11,850,000 | 11,365,881 | | | | 0 |
| 21 | DIBER | 4,165,000 | 3,743,224 | | | | 0 |
| 22 | KUKËS | 9,500,000 | 9,453,493 | | | | 0 |
| 23 | ZONAT E STIMULUARA | 5,290,000 | 1,279,453 | | | | 0 |
| 24 | KUÇOVË | 1,150,000 | - | | | | 0 |
| 25 | TEPELENË | 9,060,000 | 5,329,392 | | | | 0 |
| 26 | Drejt.Prones Shteterore | 50,000 | 16,763 | | | | |
| 27 | Qendra Kadastres Digjitale | 11,580,000 | 6,276,447 | | | | |
| | **TOTALI** | **594,946,000** | **455,452,836** | **687,930,000** | **399,790,559** | **656,926,000** | **92,699,586** |

Në realizimin faktik të shpenzimeve operative në masën 77 % ka ndikuar likujdimi I vendimeve gjyqësore ,shpenzimet për qeramarje shpenzimet për ruajtjen e ambjenteve, shpenzimet për internet intranet etj..

Ndërsa në zërin shpenzime për investime të trupëzuara dhe të patrupëzuara puna ka qenë e përqëndruar në drejtim të rikonstruksionit për objektet e dëmtura nga tërmeti, dhe të informatizimit të sistemit të kadastrës në drejtim të mirëmbajtjeve për përmiresimin e sitemit të ASHK-se dhe përmirësimit të infrastrukturës rrjetit fizik të DP dhe DV

Në zërin shpenzime për investime të trupëzuara janë përfshirë edhe shpenzimet për blerje paisje kompjuterike ,etj. dhe orendi.

### INVESTIME TË TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUARA

000/Lekë

| Artikulli | Lloji I investimit | Plani Vjetor | Janar – Dhjetor 2024 |
|---|---|---|---|
| 1 | Pajisje kompj. 231,printera ,kondicioner,camera | 70,000 | 19,208 |
| 2 | Rikonstruksion Godina ASHK-se Vlore | 41,000 | 40,728 |
| 3 | Rikonsrtuksion Godina Jordan Misja | 283,853 | 270,002 |
| 4 | Rikonstruksion Godina ASHK-se Kukes | 52,004 | 42,273 |
| 5 | Rikonstruksion Godina e ASHK-se Lushnje | 81,195 | 0 |
| 6 | Rikonstruksion Godina e ASHK-se Gjirokaster | 32,192 | 0 |
| 7 | Rikonstruksion Godina e ASHK-se Elbasan | 28,087 | 0 |
| 8 | Orendi zyre | 50,000 | 19,740 |
| 9 | Pajisje GSP | 49,600 | 7,840 |
| **231** | **Totali 231** | **687,930** | **399,791** |
| 1 | Permiresimi I infrastruktures se ASHK-se dhe rrjetit fizik te Drejtorive Vendore(Mirembajtje) | 39,512 | 39,512 |
| 2 | Permiresimi I isistemit te ASHK-se (softe) | 427,800 | - |
| 3 | Permiresimi I sistemit te ASHK(Mirembajtje) | 55,614 | 53,188 |
| 4 | Sistemi i menaxhimit të incidenteve, teknike dhe | 114,000 | 0 |
| 5 | Blerje projekte | 20,000 | 0 |
| **230** | **Totali 230** | **656,926** | **92,700** |
|  | **TOTALI 231+230** | **1,344,856** | **492,490** |

Për mbulimin e shpenzimeve për periudhën Janar- Dhjetor 2024 Drejtoritë Vendore kanë përdorur të ardhurat e veta të realizuara nga shërbimet e regjistrimit dhe nga legalizimi. Në të ardhurat e tyre përfshihen dhe të ardhurat e realizuara nga parcela ndërtimore pjesa që i takon institucionit.

**Pranë ASHK-së ndiqet dhe Projekti "Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme"nga QKD**

Bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 747, date 09.12.2021 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Kryeministrinë, për financimin e projektit të Agjencisë Shetërore të Kadastrës "Digjitalizimi i të dhënave Kadastrale të Pasurive të Paluajtshme", Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i u akordua një fond prej 652.000.000 lekësh për digjitalizimin e kartelave të Pasurive të Paluajtshme dhe skanimin e dokumentacionit tekniko- ligjor (referenca), për vitet 2022-2023.
Zbatimi i këtij projekti sipas VKM 747 ka filluar ne Prill te vitit 2022 dhe sipas fondeve ne dispozicion ka vazhduar aktivitetin e tij deri ne Qershor 2024.
Gjatë periudhës Prill 2022 deri ne Dhjetor 2024 janë realizuar kartela te digjitalizuara dhe skanim referencash si me poshtë:
Sipas planifikimit rezulton që totali i kartelave për tu digjitalizuar është **4,039,862 kartela** nga te cilat për periudhën Prill 2022- Qershor 2024 jane realizuar **rreth 29%** te tyre, ose **1,188,321 kartela** . Mbeten per tu digjitalizuar dhe **2,851,541 kartela** për periudhën Korrik 2024 – Qershor 2026

Gjatë periudhës Janar- Maj 2025 janë digjitalizuar **rreth 1,132,700** kartela ose 40 % e tyre , mbeten dhe **1,718,841 kartela** per tu digjitalizuar për periudhën Qershor 2025 deri në Qershor 2026.
Realizuar kartela të digjitalizuara ne total : **2,321,021 kartela ose 57% e tyre.**
Sipas planifikimit rezulton që totali i referencave për tu skanuar është **2,770,304 referenca** nga te cilat për periudhën Prill 2022- Qershor 2024 jane realizuar **rreth 43%** e tyre, ose **1,198,328 referenca** . Mbeten per tu skanuar referenca per periudhen Korrik 2024 deri ne Dhjetor 2025 **dhe 1,571,976** nga te cilat per periudhen Korrik 2024- Maj 2025 jane realizuar skanim referencash **820,581 referenca ose 52 % e tyre.** Për periudhën Qershor 2025 – Dhjetor 2025 mbeten per tu skanuar dhe 751,395 referenca te cilat jane parashikuar qe te perfundohen brenda muajit Dhjetor 2025
Realizuar skanime referencash ne total : **2,018,909 referenca ose 73% e tyre krahasuar me totalin e referencave prej 2,770,304 referenca.**

Drejtoria e Qendrës së Kadastres Digjitale ka bërë një përparim të dukshëm gjatë periudhave të raportuara, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve kadastrale. Sektori i digjitalizimit dhe ai i skanimit të dokumenteve kanë realizuar nivele të larta të performancës, ndërsa sektori i përmirësimit dhe ai i regjistrimit fillestar kanë siguruar një administrim të saktë dhe të shpejtë të kërkesave.

Ky progres vazhdon të mbështesë zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të sigurt për menaxhimin e të dhënave kadastrale dhe pasurive të paluajtshme.

Shpenzimet e projektit te **“Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme” sipas viteve rezultojne si më poshtë vijon:**

| | |
|---|---|
| Grand qeveritar per projketin e dixhitalizimit QKD 2022 | 652,000,000 |
| Shpenzime paga, sig, operative viti 2022 | 92,303,061 |
| Blerje pajisje dhe orendi viti 2022 | 42,538,199 |
| **Gjendja ne fund te vitit 2022** | **517,158,740** |
| Shpenzime paga, sig, operative viti 2023 | 227,147,499 |
| Blerje pajisje dhe orendi viti 2023 | 4,161,000 |
| **Gjendja në fund të vitit 2023** | **285,850,240** |
| Financim nga ASHK gjatë vitit 2024 | 142,910,346 |
| Shpenzime paga, sig, operative viti 2024 | 413,125,745 |
| Blerje pajisje dhe orendi viti 2024 | 5,694,000 |
| **Gjendja në fund të vitit 2024** | **9,940,841** |

Për të përmbylur gjithë procesin e digjitalizimit të kartelave të pasurive të paluajtshme si dhe skanimin e dokumentave tekniko-ligjor (referencat ) u pa e domosdoshme vijimësia e këtij projekti dhe shtyrja në afat për realizimin e tij deri në Qershor të vitit 2026.,Për këtë arsye u kërkua sërish financim nga buxheti i shtetit si më poshtë::
Vlera e financuar nga buxheti i shtetit eshte **743,532,838 lekë per vitet 2024-2025**

Fondi i financuar shperndahet si me poshte vijon:

Në lekë

| | |
|---|---|
| Vlera totale e financimit nga Buxheti I Shtetit | 743,532,838 |
| Zbritur fondi nga te ardhurat e ASHK | 142,910,346 |
| Vlera e financimit | 600,622,492 |
| Vlera e shpenzuar Janar-Maj 2025 | 184,120,210 |

| | |
|---|---|
| **Vlere per tú shpenzuar Maj 2025 - Dhjetor 2025** | **416,502,282** |

Gjatë periudhës Prill 2022 deri ne Dhjetor 2024 janë realizuar kartela te digjitalizuara dhe skanim referencash si me poshtë:
Realizuar kartela të digjitalizuara ne total : **2,321,021 kartela ose 57% e tyre nga 4,039,862 kartela ne total**
Realizuar skanime referencash ne total : **2,018,909 referenca ose 73% e tyre krahasuar me totalin e referencave prej 2,770,304 referenca.**
Per vijimesine e projektit per vitin 2026 duhet te kerkohet miratimi i vazhdimesise se projektit nga Keshilli Drejtues dhe me pas sipas shkreses nr.7526/3 datë 8.10.2024 “”Kerkese mbi financimin e zgjatjes se periudhes per vazhdimin e projektit “”*Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme*” do te kerkohet mbeshtja me fonde nga buxheti i shtetit **në vlerën 216,605,562 lekë.**
Në mënyrë të përmbledhur në zbatim të buxhetit të ardhurat dhe shpenzimet e ASHK-së për periudhën Janar - Dhjetor 2024, paraqiten si më poshtë:

**REALIZIMI I BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2024**

Në 000/leke Në lekë

| #NAME? | BUXHETI JANAR - DHJETOR 2024 miratuar me vkm,nr.40 dt.24,01,2024 | Fakt Janar-Dhjetor 2024 |
|---|---|---|
| **TOTALI I TË ARDHURAVE** | **4,875,659** | **5,368,096,700** |
| Të ardhura nga shërbimet | 2,210,287 | 2,541,608,397 |
| Të ardhura nga transferimi I parcelës ndërtimore pjesa takuese e institucionit | 300,000 | 438,559,399 |
| Të ardhura të tjera (nga sherb.legalizimit) | 200,000 | 153,576,048 |
| Fonde që trashëgohen nga viti 2023 | 2,165,372 | 2,225,504,019 |
| Te ardhura nga bashkite si transferte | | 8,848,838 |
| **Fonde të akorduara nga Buxheti I shtetit** | **282,671** | 0 |
| **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **4,857,690** | **3,366,257,613** |
| **Shpenzime personeli** | **2,755,447** | **2,418,063,934** |
| Paga për punonjësit sipas strukturës organike të miratuar | 1,897,742 | 1,637,544,128 |
| Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjesit në organikë | 290,450 | 275,851,816 |
| Paga për punonjësit me kontratë(690) | 411,210 | 427,733,636 |
| Kontribute për Sigurime Shoqerore për punonjësit me kontratë | 68,672 | 73,725,968 |
| Fondi i vecantë i pagave | 87,373 | 3,208,386 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | **Shpenzime operative** | **652,687** | **455,452,836** |
| | Shpenzime për mallra dhe shërbime | 594,946 | 455,452,836 |
| | Shpenzime operative QKD(projekt) | 57,741 | 0 |
| | **Transferta nga buxheti I shtetit** | **282,671** | **0** |
| 3 | **Shpenzime Kapitale** | **1,344,856** | **492,490,145** |
| 230 | **Investime kapitale të patrupëzuara** | **656,926** | **92,699,586** |
| | Ifrastruktura e ASHKse dhe rrjetit fizik te Drejtorive Vendore | | 39,511,800 |
| | Mirembajtje sipas kont.Permiresimi I sistemit te ASHK | | 53,187,786 |
| | Shpenzime projekti nga fondet e ASHK | | 132,976,612 |
| 231 | **Investime kapitale të trupëzuara(Rikonstruksion +Infrastrukture IT)** | **687,930** | **399,790,559** |
| 1 | Rikonstruksione (Drejtorite Vendore te ASHK-se Tirane+Vlore+Kukës etj) | 518,330 | 353,002,259 |
| 2 | Blerje paisje elektronike+GNSS | 119,600 | 19,208,400 |
| 3 | Orendi | 50,000 | 19,740,000 |
| 4 | **Pajisje GSP** | | 7,839,900 |
| 4 | **Sistemim veprimi** | | 250698 |
| 5 | **Fondi Rezervë** | **104,700** | **0** |
| 1 | Fondi Rezervë | 104,700 | |
| | **TË ARDHURA (-) SHPENZIME(te ardhura te pashperndara)pa fond rezerve** | **17,970** | **1,868,862,476** |
| | **Fondi rezerve** | | **104,699,512** |
| | **Te ardhura per tu trasheguar me fond rezerve** | | **1,973,561,988** |

## Fondi rezervë

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 218 datë 20.03.2013 "Për miratimin e kufijve dhe kritereve të përdorimit të fondit rezervë të ish Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për vitin 2024 nuk u planifikua Fond rezervë, meqenëse Fondi rezervë i krijuar për vitet 2013, 2014 dhe 2015 i cili kap vlerën në total 104.700 mijë lekë nuk është përdorur. Në zbatim të ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", ky fond rezervë i akumuluar trashëgohet dhe mund të përdoret në rast nevoje për mbulimin e dëmshpërblimeve.

**Bashkëlidhur gjeni pasqyrat financiare dhe relacioni perfundimtar i mbylljes së pasqyrave financiare për periudhen janar – dhjetor 2024 dhe Bilancin e vitit 2024**

# VIII. APELIMI DHE BASHKËQEVERISJA

**Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes në kuadër të veprimtarisë së saj bën:**
1. Trajtimin në përputhje me ligjin material dhe atë procedurial, brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.A, ankesat e paraqitura nga qytetarët apo institucionet shtetërore, lidhur me veprimet ose mosveprimet e kryera nga Drejtoritë/Zyrat vendore të ASHK në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 111/2018 "Për Kadastrën" dhe ligjin nr. 20/2020 "Për proceset kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".
2. Procesimin nga sistemi i menaxhimit të ankesave, ankesat e regjistruara nga qytetarët në faqen https://www.shqiperiaqeduam.al dhe të gjitha rastet për kategoritë e paraqitura në platformën e bashkëqeverisjes, në përputhje me ligjin nr.107/2021 "Për bashkëqeverisjen";

**Sektori i Bashkëqeverisjes**
*Objektivi i Sektorit: Procesimi nga sistemi i menaxhimit të ankesave, ankesat e regjistruara nga qytetarët dhe bizneset në faqen https://www.shqiperiaqeduam.al dhe sigurimi i menaxhimit në kohë, në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi brenda afateve dhe me përgjegjshmëri të të gjitha rasteve të ardhura nga platforma, adresimin dhe zgjidhjen e problematikave.*

- **Viti 2024 (Periudha 1.01.2024-31.12.2024)**
  Për vitin 2024 janë regjistruar 8722 ankesa në Platformën e Bashkëqeverisjes, të cilat janë deleguar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) në Kryeministri në Drejtoritë Vendore të ASHK-së dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.
  Në fund të vitit 2024, **nga 8722 ankesa** të regjistruara te Seksioni **"Ankesa Ime" ka përfunduar shqyrtimi i 8208 ankesave**, ndërsa 514 ankesa do të vijonin trajtimin në vitin 2025. **Janë zgjidhur 2256 ankesa** i përkasin individëve.
  Në fund të vitit 2024, te Seksioni **"Biznesi im"** janë **regjistruar 127 ankesa**, nga të cilat janë përfunduar **125 ankesa** dhe 2 ankesa do të vijonin trajtimin në vitin 2025. **Janë zgjidhur 49 ankesa** që i përkasin **bizneseve.**
  **Çështjet e zgjidhura** gjatë vitit 2024 **janë në total 2305,** të ndara **sipas tipologjisë:** [878 ankesa - *Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese;* 533 ankesa - *Certifikatë pronësie;* 187 ankesa -*Aplikime për procedurat e legalizimit;* 155 ankesa - *Vërtetim pozitiv/negativ për pasuri të paluajtshme;* 95 ankesa – *aplikim për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore;* 80 ankesa-*kërkesë për informacion/dokumentacion;* 55 ankesa-*legalizime;* 53 ankesa-*regjistrimi i kontratave;* 38 ankesa- *oborre në përdorim;* *28 ankesa* - *kërkesa për korrigjim dokumentacioni;* 27 ankesa - *regjistrim akti trashëgimie;* 27 ankesa-*informacion kadastral;* 21 ankesa-*regjistrim/fshirje inskripti;* 15 ankesa-*regjistrim i tokave bujqësore;* 11 ankesa- *regjistrim fillestar]*
  **Rastet e suksesit** të regjistruara për vitin 2024 janë **404 raste suksesi** në total, (**389** raste suksesi për ankesat e **individëve** dhe **15** raste suksesi për ankesat e **biznesit**), të ndara sipas **tipologjisë:** [109 ankesa - *Leje legalizimi, aplikim për regjsitrim të akteve administrative/gjyqësore, Pagesa kadastrale*- ASHK Kamëz-Vorë; 91 ankesa - *fatura pagese parcele ndërtimore, problematikë me shërbimin AV0, Leje Legalizimi, Regjistrimi i kontratave, Regjistrim/Fshirje inskripti*-ASHK Fier; 74 ankesa - *Regjistrimi i kontratave, Regjistrim/Fshirje inskripti, akt trashëgimie, Certifikatë*-ASHK Durrës; 44 ankesa - *oborre në përdorim, Regjistrimi i kontratave, kërkësë për informacion/kopje dokumentacioni, vërtetim pozitiv/negativ* - ASHK Shkodër; 30 ankesa - *regjistrim i tokave bujqësore, regjistrim i aktit të trashëgimisë, aplikime për procedurat e legalizimit, Certifikatë pronësie, kartelë pasurie dhe hartë treguese*- ASHK Lushnje; 24 ankesa - *Regjistrimi i kontratave, informacion/kopje dokumentacioni, legalizim, aplikime për procedurat e legalizimit, Certifikatë*- ASHK Sarandë; 14 ankesa - *oborre në përdorim, regjistrim/fshirje inskripti, certifikatë pronësie,* - ASHK Korçë*]*.

Gjithashtu, për vitin 2024, **janë administruar** **në rrugë zyrtare** pranë Sektorit të Bashkëqeverisjes në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, **272 ankesa** që lidheshin kryesisht me vonesa në marrjen e shërbimeve kadastrale.

Roli i Sektorit të Bashkëqeverisjes përgjatë vitit 2024:

- **Ndjekja e ankesave që i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së si dhe ndjekja e ankesave të adresuara Drejtorive Vendore të ASHK-së** nëpërmjet komunikimeve javore menjëherë me dërgimin e raportit përmbledhës të ankesave që i adresohen platformës së Bashkëqeverisjes nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje në drejtim të ASHK-së. Komunikimet janë mbajtur me Drejtorët e Drejtorive dhe me pikat e kontaktit të bashkëqeverisjes së këtyre drejtorive. Ky proces është monitoruar në vazhdimësi nga ana e Sektorit të Bashkëqeverisjes çdo javë dhe sa herë ka lindur nevoja për komunikim me drejtoritë vendore në varësi të ankesave të qytetarëve dhe bizneseve.
- **Sektori i Bashkëqeverisjes në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së/ ka luajtur një rol rregullator dhe ndërmjetës mdis Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe Drejtorive Vendore të ASHK-ve** për ti dhënë zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi çdo ankese/çështje që është adresuar në platformën e bashkëqeverisjes.
- **Në bashkëpunim me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje**, Drejtoren e Përgjithshme dhe koordinatorët e saj në Kryeministri janë zhvilluar takime në vijimësi (prill/maj -online, dhe qershor/korrik me prezencë fizike me Drejtorët Vendore të ASHK-së dhe pikat e kontaktit të Bashkëqeverisjes lidhur me ecurinë e trajtimit të ankesave të Platformës së Bashkëqeverisjes me fokus në kthimin e përgjigjeve bazuar në ligj ankuesve, përgjigje shteruese për ankesat dhe përgjigje cilësore dhe fokus tek ecuria e procesit të legalizimeve për ankesat e regjistruara në Platformë që i përkasin periudhës së vetëdeklarimit 2005-2006.
- **Ngritja e strukturës përgjegjëse për trajtimet** sipas fushës së përgjegjësisë së drejtorive të ASHK-së. Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes sipas programit dhe kalendarit mujor të trajnimit të ASHK të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm gjatë muajit qershor të vitit 2024, ka zhvilluar trajnimet përkatëse për pikat e kontaktit të Bashkëqeverisjes të gjitha Drejtorive Vendore të ASHK, përkatësisht janë trajnuar 50 punonjës që trajtojnë ankesat e bashkëqeverisjes që i përkasim DV ASHK Tirana Veri, Tirana Jug, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Durrës, Kamëz Vorë, Kavajë, Krujë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Lezhë, Kukës, Dibër, Tepelenë, Gjirokastër, Sarandë, Kuçovë, Berat, Lushnje, Fier dhe Vlorë , në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.513, datë 05.03.2024 dhe Urdhrit Nr.688, datë 04.04.2024 *"Për miratimin e programit dhe kalendarit vjetor të trajnimeve të ASHK për vitin 2024",* duke venë theksin tek cilësia e përgjigjeve/përgjigje shteruese në lidhje me ankesat e paraqitura në platformë.

**Temat e trajuara:** Trajnimi i pikave të kontaktit të Bashkëqeverisjes pranë Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës:
*- për ti dhënë zgjidhje çështjeve/rasteve që vijnë në seksionet e platformës "Me ty për Shqipërinë që duam".*

*- për të trajtuar ankesat e grupeve të interesit ndaj institucionit, të cilët pasi kanë ndjekur procedurat ose parashikimet ligjore përkatëse, nuk kanë marrë nga institucioni publik informacionin apo shërbimin publik të kërkuar.*
*- për të garantuar përfitimin e shërbimeve ndaj çdo shtetasi, nëpërmjet proçedurave administrative të thjeshta dhe transparente, brenda afateve të parashikuara në ligj.*
*- për të orientuar pikat e kontaktit të Bashkëqeverisjes për rastet që i adresohen platoformës nuk janë ankesa, por çështjet lidhen me ankime adminsitrative dhe duhet të parashtrohen me shkrim përmes postës në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.*

- Implementimi i Platformës së Re të Bashkëqeverisjes në muajin tetor 2024, gjë e cila mundësoi aksesimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të ankesave nga drejtoritë vendore të ASHK-së dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së dhe kthimi i përgjigjeve për ankesat e deleguara direkt në platformë. (*drejtorët vendorë, pikat e kontaktit të bashkëqeverisjes në Drejtoritë vendore dhe pikat e kontaktit në Drejtorinë e Përgjithshme*). Deri në muajin Tetor 2024 ankesat delegoheshin nga ADB në drejtim të ASHK-së nëpërmjet e-maileve. Në kuadër të implementimit të Platformës së Re të Bashkëqeverisjës u zhvilluan trajnime nga AKSHI dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje për përdorimin e Platformës për drejtoritë vendore të ASHK-së dhe Drejtorinë e Përgjithshme (online dhe fizike). Me ristrukturimin e ASHK-së, lind nevoja për përditësimin/ndryshimin e pikave të kontaktit të bashkëqeverisjes në drejtoritë vendore të ASHK dhe sektori i bashkëqeverisjes në bashkëpunim me Drejtorinë e IT, ka ndjekur çdo çështje e cila lidhej me aksesimin e plotë dhe logimin e përdoruesve të ri, shfaqjen e ankesave për secilën drejtori dhe gjithcka në funksion të përdorimit të plotë të Platformës së Bashkëqeverisjes.

- **Më poshtë në mënyrë të detajuar gjendet përmbledhje vjetore dhe progresive e ankesave për vitin 2024:**

**❖ RAPORTIMI VJETOR**
**PLATFORMA ‘SHQIPËRIA QË DUAM’**
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**
**JANAR – DHJETOR 2024**

**❖ PËRMBLEDHJE VJETORE DHE PROGRESIVE E ÇËSHTJEVE**

**❖ ANKESA IME**

| MINISTRI QYTETARË | Total vjetor akumulativ | Çështje në Platformë Proces | | Çështje Protokoll i Proces | | Çështje vjetore në proces Platformë dhe Protokoll në total | | | Total vjetor për çështjet e përfunduara | | Total progresiv për çështjet e përfunduara | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Afat | Jashtë Afatit | Afat | Jashtë Afatit | Afat | Jashtë Afatit | Proçes total | Zgjidhur | Përfunduar | Zgjidhur | Përfunduar |
| **Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)** | **8,722** | 1 | 463 | 0 | 50 | 1 | 513 | **514** | 2,256 | 8,208 | 8,104 | 36,334 |

## BIZNESI IM

| BASHKËQEVERISJA ME BIZNESE | Total vjetor akumulativ | Çështje në Platformë Proçes | | Çështje Protokolli Proçes | | Çështje vjetore në proçes Platformë dhe Protokoll në total | | | Total vjetor për çështjet e përfunduara | | Total progresiv për çështjet e përfunduara | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Afat | Jashtë Afatit | Afat | Jashtë Afatit | Afat | Jashtë Afatit | Proçes total | Zgjidhur | Përfunduar | Zgjidhur | Përfunduar |
| **Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)** | | | | | | | | | | | | |
| Ankesa | **119** | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 2 | **2** | 47 | 117 | 185 | 633 |
| Kërkesa | **8** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** | 2 | 8 | 49 | 168 |
| **TOTAL ÇËSHTJE** | **127** | **0** | **1** | **0** | **1** | **0** | **2** | **2** | **49** | **125** | **234** | **801** |

### ÇËSHTJET E REJA GJATË VITIT SIPAS INSTITUCIONEVE

| Ministritë | Drejtoritë dhe Institucionet e varësisë | Qytetarë | Biznese | Numri i Çështjeve |
|---|---|---|---|---|
| **Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)** | Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër | 2 | 0 | 2 |
| | Vlorë | 1 | 0 | 1 |
| | ASHK Kurbin | 26 | 0 | 26 |
| | ASHK Përmet | 11 | 0 | 11 |
| | ASHK Peqin | 3 | 0 | 3 |
| | ASHK Kavajë | 144 | 5 | 149 |
| | ASHK Devoll | 16 | 0 | 16 |
| | ASHK Pogradec | 61 | 4 | 65 |
| | ASHK Has | 1 | 0 | 1 |
| | ASHK Kolonjë | 16 | 0 | 16 |
| | ASHK Librazhd | 27 | 0 | 27 |
| | ASHK Pukë | 10 | 0 | 10 |
| | ASHK Kamëz – Vorë | 438 | 9 | 447 |
| | ASHK Gramsh | 9 | 0 | 9 |
| | ASHK Lushnje | 218 | 0 | 218 |
| | ASHK Mat | 17 | 0 | 17 |
| | Qëndra e Kadastrës Digjitale | 33 | 0 | 33 |
| | ASHK Malësi e Madhe | 15 | 0 | 15 |
| | ASHK Tirana Jug | 354 | 5 | 359 |
| | ASHK Dibër | 38 | 0 | 38 |
| | ASHK Durrës-Kavajë-Krujë | 102 | 1 | 103 |
| | ASHK Tropoje | 25 | 0 | 25 |
| | Delegat-Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I) | 301 | 4 | 305 |
| | ASHK Skrapar | 9 | 0 | 9 |
| | Delegati-ASHK Berat | 3 | 0 | 3 |
| | ASHK Bulqizë | 9 | 0 | 9 |
| | Delegati-Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I) (Biznesi) | 0 | 2 | 2 |
| | ASHK Gjirokastër | 76 | 0 | 76 |
| | ASHK Elbasan-Librazhd-Gramsh-Peqin | 47 | 1 | 48 |
| | ASHK Krujë | 55 | 0 | 55 |
| | ASHK Lezhë-Mirditë-Kurbin | 51 | 1 | 52 |
| | ASHK Mallakastër | 32 | 0 | 32 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ASHK Fier-Mallakastër | 59 | 0 | 59 |
| | ASHK Elbasan | 357 | 2 | 359 |
| | ASHK Shkodër-Pukë | 124 | 1 | 125 |
| | ASHK Lezhë | 47 | 2 | 49 |
| | ASHK Sarandë | 235 | 3 | 238 |
| | ASHK Divjakë | 3 | 0 | 3 |
| | ASHK Fier | 357 | 4 | 361 |
| | ASHK Mirdite | 26 | 0 | 26 |
| | ASHK Tepelene | 41 | 0 | 41 |
| | ASHK Berat | 187 | 2 | 189 |
| | ASHK Zonat e Stimuluara | 17 | 0 | 17 |
| | ASHK Tirana Rurale 2 | 369 | 13 | 382 |
| | ASHK Tirana Rurale 1 | 378 | 5 | 383 |
| | ASHK Durrës | 422 | 13 | 435 |
| | ASHK Gjirokastër-Tepelenë-Përmet | 37 | 0 | 37 |
| | Drejtoria Qëndrore e ASHK | 277 | 2 | 279 |
| | Agjencia Shtetërore e Kadastrës | 882 | 5 | 887 |
| | ASHK Korçë | 144 | 3 | 147 |
| | ASHK Korçë-Devoll-Kolonjë | 8 | 0 | 8 |
| | ASHK Kuçovë | 18 | 1 | 19 |
| | ASHK Berat-Kuçovë-Skrapar | 36 | 0 | 36 |
| | ASHK Kukës | 15 | 0 | 15 |
| | ASHK Shkodër | 499 | 5 | 504 |
| | ASHK Tirana Veri | 607 | 11 | 618 |
| | ASHK Vlorë | 502 | 11 | 513 |
| | Koordinator-Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I) | 66 | 1 | 67 |
| | Koordinator/Delegat | 16 | 0 | 16 |
| | Pa institucion | 25 | 0 | 25 |
| **Totali** | | **7,904** | **116** | **8,020** |

## ÇËSHTJE TË ZGJIDHURA GJATË VITIT SIPAS TIPOLOGJISË

| Ministria | TIPOLOGJITË e çështjeve të zgjidhura | Qytetarë | Biznese | Numri i Çështjeve |
|---|---|---|---|---|
| **Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I)** | Informacion | 3 | 0 | 3 |
| | Fatura e pagesës | 3 | 0 | 3 |
| | Denoncim | 2 | 0 | 2 |
| | Ankim administrativ pranë ASHK Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes | 2 | 0 | 2 |
| | Vërtetim | 10 | 0 | 10 |
| | Aplikime e-albania | 1 | 0 | 1 |
| | Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese | 858 | 20 | 878 |
| | Regjistrime Fillestare | 5 | 0 | 5 |
| | Oborre në përdorim | 38 | 0 | 38 |
| | Regjistrim i tokave bujqësore | 15 | 0 | 15 |
| | Problematikë me aplikimin AV0(zero), shërbimi E-Albania | 1 | 0 | 1 |
| | Leje legalizimi | 5 | 0 | 5 |
| | Regjistrim i lejeve të ndërtimit | 5 | 0 | 5 |
| | Regjistrimi i Kontratave | 53 | 0 | 53 |
| | Mungesë shërbimi kadastral | 2 | 0 | 2 |
| | Regjistrim/fshirje inskripti | 19 | 2 | 21 |
| | Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme | 155 | 0 | 155 |
| | Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni | 80 | 0 | 80 |
| | Legalizim | 54 | 1 | 55 |
| | Certifikate | 3 | 0 | 3 |
| | Aplikim Oborre në përdorim | 4 | 0 | 4 |
| | Aplikime për procedurat e legalizimit | 187 | 0 | 187 |
| | Mungesë shërbimi | 2 | 2 | 4 |
| | Rivlerësim Pasurie | 2 | 0 | 2 |
| | Çertifikatë pronësie | 518 | 15 | 533 |
| | Aplikime për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore | 92 | 3 | 95 |
| | Kërkesë për korrigjim dokumentacioni | 28 | 0 | 28 |
| | Regjistrim i aktit të trashëgimisë | 27 | 0 | 27 |
| | Aplikim Ndërtim pa leje | 1 | 0 | 1 |
| | Regjistrim i kontratave bankare | 1 | 0 | 1 |
| | Akt administrativ/gjyqësor | 5 | 0 | 5 |
| | Akt trashëgimie | 5 | 0 | 5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Ankim administrativ / apelim | 1 | 0 | 1 |
| | Aplikim online AV0(zero) | 3 | 0 | 3 |
| | Dokumentacion kadastral | 5 | 0 | 5 |
| | Kartele pasurie, Harte treguese | 5 | 0 | 5 |
| | Informacion kadastral | 27 | 0 | 27 |
| | Kartelë pasurie | 10 | 2 | 12 |
| | Korrigjim dokumentacioni | 3 | 0 | 3 |
| | Pagesa kadastrale | 2 | 0 | 2 |
| | Regjistrim fillestar | 7 | 4 | 11 |
| | Toka bujqësore | 7 | 0 | 7 |
| | **TOTAL** | **2,256** | **49** | **2,305** |

## NISMA IME

| Institucioni | Proces | Jashtë afatit | Të zgjidhura gjatë vitit | Të përfunduara gjatë vitit | Të zgjidhura progresive | Të përfunduara progresive |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I) | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 4 |

## NISMA IME - Listimi

Nuk ka hyrje për këtë periudhë.

## FJALA IME

| Institucioni | Proces | Jashtë afatit | Të zgjidhura gjatë vitit | Të përfunduara gjatë vitit | Të zgjidhura progresive | Të përfunduara progresive |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |

## FJALA IME - Listimi

Nuk ka hyrje për këtë periudhë.

## DUA TË KONTRIBUOJ

| Institucioni | Proces | Jashtë afatit | Të zgjidhura gjatë vitit | Të përfunduara gjatë vitit | Të zgjidhura progresive | Të përfunduara progresive |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I) | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 |

## RASTE SUKSESI NE TOTAL

| MINISTRIA | INSTITUCIONI | RASTE SUKSESI VJETOR | | Total Viti | RASTE SUKSESI PROGRESIV | | Total | TIPOLOGJIA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Qytetarë | Biznes | | Qytetarë | Biznes | | |
| Kryeministria\Agjencia Shtetërore e Kadastrës (I) | ASHK Pogradec | 1 | 0 | 1 | 3 | 0 | 3 | Çertifikatë pronësie, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | ASHK Kavajë | 7 | 0 | 7 | 15 | 0 | 15 | Regjistrim/fshirje inskripti, Legalizim, Çertifikatë pronësie, Aplikime për procedurat e legalizimit, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | ASHK Mat | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | Aplikime për procedurat e legalizimit, Kërkesë për pajisje me çertifikatë pronësie |
| | ASHK Pukë | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | ASHK Devoll | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | Oborre në përdorim |
| | ASHK Librazhd | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | ASHK Tropoje | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | ASHK Berat | 10 | 0 | 10 | 17 | 0 | 17 | Regjistrim i tokave bujqësore, Regjistrim/fshirje inskripti, Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni, Legalizim, Certifikate |
| | ASHK Dibër | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **ASHK Durrës** | 35 | 1 | 36 | 70 | 4 | 74 | Regjistrimi i Kontratave, Regjistrim/fshirje inskripti, Mos shfaqje dokumentacioni ASHK në rubrikën dokumentet e mia, shërbimi E-Albania, Akt trashëgimie, Certifikate |
| | **ASHK Elbasan** | 18 | 1 | 19 | 53 | 2 | 55 | Informacion, Regjistrim i lejeve të ndërtimit, Regjistrimi i Kontratave, Aplikime për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore, Rivlerësim Pasurie |
| | **ASHK Fier** | 28 | 2 | 30 | 88 | 3 | 91 | Fatura e pagesës, Problematikë me aplikimin AV0(zero), shërbimi E-Albania, Leje legalizimi, Regjistrimi i Kontratave, Regjistrim/fshirje inskripti |
| | **ASHK Gjirokastër** | 5 | 0 | 5 | 6 | 0 | 6 | Çertifikatë pronësie, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | **ASHK Kamëz – Vorë** | 41 | 4 | 45 | 103 | 6 | 109 | Leje legalizimi, Mungesë shërbimi, Rivlerësim Pasurie, Aplikime për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore, Pagesa kadastrale |
| | **ASHK Korçë** | 8 | 2 | 10 | 12 | 2 | 14 | Oborre në përdorim, Regjistrim/fshirje inskripti, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Informacion kadastral, Çertifikatë pronësie |
| | **ASHK Krujë** | 5 | 0 | 5 | 8 | 0 | 8 | Aplikime për procedurat e legalizimit, Çertifikatë pronësie, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | **ASHK Kuçovë** | 1 | 1 | 2 | 2 | 1 | 3 | Regjistrim fillestar, Regjistrimi i Kontratave |
| | **ASHK Kukës** | 2 | 0 | 2 | 3 | 0 | 3 | Oborre në përdorim, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | **ASHK Lezhë** | 4 | 1 | 5 | 10 | 1 | 11 | Legalizim, Aplikime për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore, Kartelë pasurie, Aplikime për procedurat e legalizimit, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | **ASHK Lushnje** | 18 | 0 | 18 | 30 | 0 | 30 | Regjistrim i tokave bujqësore, Regjistrim i aktit të trashëgimisë, Aplikime për procedurat e legalizimit, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese, Çertifikatë pronësie |
| | **ASHK Mirdite** | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 3 | E-albania, Çertifikatë pronësie |
| | **ASHK Sarandë** | 17 | 0 | 17 | 24 | 0 | 24 | Regjistrimi i Kontratave, Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni, Legalizim, Certifikate, Aplikime për procedurat e legalizimit |
| | **ASHK Shkodër** | 13 | 1 | 14 | 42 | 2 | 44 | Oborre në përdorim, Regjistrimi i Kontratave, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Kërkesë për informacion/kopje dokumentacioni, Informacion kadastral |
| | **ASHK Tepelene** | 5 | 0 | 5 | 10 | 0 | 10 | Çertifikatë pronësie, Regjistrimi i Kontratave, Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese |
| | **ASHK Tirana Jug** | 31 | 0 | 31 | 75 | 6 | 81 | Aplikime për regjistrim të akteve administrative/gjyqësore, Kërkesë për korrigjim dokumentacioni, Certifikate, Regjistrim i aktit të trashëgimisë, Fatura e pagesës |
| | **ASHK Tirana Rurale 1** | 22 | 0 | 22 | 52 | 2 | 54 | Kërkesë për korrigjim dokumentacioni, Leje legalizimi, Regjistrimi i Kontratave, Legalizim, Çertifikatë pronësie |
| | **ASHK Tirana Rurale 2** | 22 | 1 | 23 | 67 | 4 | 71 | Leje legalizimi, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Kërkesë për |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | informacion/kopje dokumentacioni, Kërkesë për korrigjim dokumentacioni, Informacion kadastral |
| | **ASHK Tirana Veri** | 35 | 0 | 35 | 87 | 9 | 96 | Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Regjistrim i aktit të trashëgimisë, Informacion kadastral, Regjistrim fillestar, Regjistrim/fshirje inskripti |
| | **ASHK Vlorë** | 18 | 1 | 19 | 52 | 2 | 54 | Regjistrime Fillestare, Regjistrim/fshirje inskripti, Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Aplikim Oborre në përdorim, Regjistrimi i Kontratave |
| | **ASHK Zonat e Stimuluara** | 2 | 0 | 2 | 2 | 0 | 2 | Legalizim, Aplikim Ndërtim pa leje |
| | **Drejtoria Qëndrore e ASHK** | 3 | 0 | 3 | 40 | 7 | 47 | Çertifikatë pronësie/ Kartelë pasurie /Hartë treguese, Regjistrimi i Kontratave, Ankim administrativ / apelim, Shërbimi kadastral, Kërkesë për Legalizim të Objektit |
| | **Agjencia Shtetërore e Kadastrës** | 32 | 0 | 32 | 337 | 4 | 341 | Informacion, Denoncim, Ankesë administrative, Regjistrim i tokave bujqësore, Leje legalizimi |
| | **ASHK Elbasan-Librazhd-Gramsh-Peqin** | 2 | 0 | 2 | 2 | 0 | 2 | Vërtetim Negativ/Pozitiv për pasuri të paluajtshme, Legalizim |
| | **ASHK Berat-Kuçovë-Skrapar** | 1 | 0 | 1 | 2 | 0 | 2 | Çertifikatë pronësie, Informacion kadastral |
| | **ASHK Fier-Mallakastër** | 2 | 0 | 2 | 3 | 0 | 3 | Oborre në përdorim, Legalizim |
| | **TOTAL** | **389** | **15** | **404** | **1,225** | **55** | **1,280** | |

## Sektori i Apelimit

Sektori i Apelimit për vitin 2024, në cilësinë strukturës përgjegjëse për ankimet administrative ka patur si objekt të veprimtarisë shqyrtimin e ankimeve administrative ndaj vendimeve, veprimeve, mosveprimeve të drejtorive vendore të ASHK duke ushtruar kontrollit administrativ të akteve, veprimeve, mosveprimeve të drejtorive vendore bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

## I. SASIA E KORRESPONDENCËS SË ADMINISTRUAR

Gjatë vitit 2024, janë administruar gjithsej **1,544** shkresa të klasifikuara si më poshtë:

- **412 kërkesa nga subjektet**;
- **710 ankesa ndaj vendimeve/veprimeve të drejtorive vendore të ASHK**;
- **322 shkresa përgjigjeje nga drejtoritë vendore të ASHK.**

## II. ANALIZA E TEMATIKAVE TË KËRKESAVE DHE ANKESAVE

Përmbajtja tematike e kërkesave dhe ankesave të paraqitura për trajtim përfshin:

- **335 raste** me objekt **procesin e legalizimit** të objekteve ndërtimore dhe raste për **kalimin në pronësi të objekteve pa titull** të ndërtuara para datës 10.8.1991 dhe **oborreve në përdorim**;
- **1,109 raste** që kanë të bëjnë me **regjistrimin e titujve të pronësisë**, si (akte administrative, vendime gjyqësore, akte noteriale, etj.

## III. TRAJTIMI ADMINISTRATIV I KËRKESAVE/ANKESAVE

Nga totali i shkresave të administruara (**1,544**), janë përpunuar dhe trajtuar **1,082 raste**, në formatet e mëposhtme:

### 1. Shqyrtim administrativ dhe vendimmarrje:

- **32 raste** janë shqyrtuar në mënyrë të plotë në aspektin e ankimit administrativ. Nga të cilat:
  **29 raste** janë **rrëzuar** për tematika: -regjistrim objektesh pas procesit të legalizimit (VKM nr. 1040/2020);- objekte pa titull dhe oborre në përdorim (VKM nr. 827/2020).
  **3 raste** janë **pranuar**, për tematika: -1 rast legalizim;-1 rast oborr në përdorim dhe -1 rast regjistrim vendimi gjyqësor.

### 2. Veprime të tjera procedurale:

- **280 raste**: kthim përgjigjeje shteruese për subjektet, me udhëzime për mjetet dhe afatet ligjore të ankimit;
- **374 raste**: delegim për kompetencë në drejtorinë vendore përkatëse, me orientim të qartë ligjor;
- **140 raste**: udhëzim për vijimin e trajtimit nga drejtoria vendore;
- **172 raste**: kërkesë për informacion/dokumentacion të nevojshëm për shqyrtimin administrativ;
- **36 raste**: kthim dosjeje për plotësim të ankesës nga subjekti;
- **32 raste**: delegim për kompetencë brenda DPASHK-së (drejtori/sektorë të tjerë);
- **16 raste**: tërheqje vëmendje për vonesa në përgjigje nga drejtoritë vendore.

### 3. Shkresa të tjera të administruara:

- Shkresa të arkivuara për shkak të trajtimit të përfunduar nga drejtoritë vendore;
- Shkresa për dijeni;
- Shkresa të trajtuara në vitin pasardhës.

## V. SHPËRNDARJA E ANKESAVE SIPAS DREJTORIVE VENDORE

Tabela e mëposhtme paraqet ndarjen e ankesave sipas drejtorive vendore të ASHK.

| Drejtoria vendore | Nr. ankesave |
|---|---|
| Tiranë Jug | 134 |
| Tiranë Veri | 124 |
| Vlorë | 117 |
| Sarandë | 103 |
| Berat | 60 |
| Shkodër | 56 |
| Durrës | 55 |
| Korçë | 49 |
| Fier | 44 |

| | |
|---|---|
| Kamëz - Vorë | 41 |
| Gjirokastër | 36 |
| Tirana Rurale 1 | 35 |
| Tirana Rurale 2 | 34 |
| Elbasan | 20 |
| Lushnje | 20 |
| Kukës | 20 |
| Lezhë | 20 |
| Pogradec | 12 |
| Të tjera (DVASHK/ZVASHK) | pjesa e mbetur |

## IV. PROBLEMATIKAT E KONSTATAURA GJATË VITIT 2024

Gjatë analizës së praktikave të trajtuara, janë konstatuar problematika të përsëritura në lidhje me performancën dhe korrespondencën e drejtorive vendore si:

- **Mosrespektim i afateve të kthimit të përgjigjeve** nga drejtoritë vendore, përkundrejt kërkesave të Sektorit të Apelimit;
- **Përgjigje të paplota**, të paargumentuara ligjërisht dhe pa dokumentacionin përkatës;
- **Moszbatim haptazi** të akteve ligjore e nënligjore në trajtimin e aplikimeve**.**

## V. REKOMANDIME.

1. Përmirësimin e qarkullimit të informacionit dhe dokumentacionit, ndërmjet nivelit qendror dhe drejtorive vendore, ku kërkesa për dokumentacion e Sektorit të Apelimit dhe kthimi i përgjigjes nga drejtoria vendore të bëhet nëpërmjet postës elektronike zyrtare;
2. Krijimi i një sistemi monitorimi për ndjekjen e zbatimit të afateve të kthimit të përgjigjeve të kërkesave të Sektorit të Apelimit.
3. Krijimi i një sistemi monitorimi për zbatimin e rekomandimeve të Sektorit të Apelimit.

# IX. SHËRBIMET, INVESTIMET DHE BURIMET NJERËZORE

## Sektori i Prokurimeve

Referuar regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2024, statusi i procedurave të prokurimit, është sa vijon:

- Janë përfunduar procedurat e prokurimit me objekt:

1- Blerje pjesë këmbimi, goma dhe bateri për automjete (Blerje e përqëndruar);
2- Blerje karburanti për nevoja të Qendrës së Kadastrës Digjitale (QKD);
3- Shërbim ngarkim-shkrkim dhe transport për nevoja të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Durrës;
4- Marrje makina me qira për nevoja të Qendrës së Kadastrës Digjitale (QKD);
5- Shërbim për riparimin e automjeteve të ASHK-së;
6- Blerje kancelari dhe letër (*Blerje e përqëndruar*);
7- Siguracioni i mjeteve të transportit;
8- Blerje karta sim dhe shërbime telefonike;
9- Blerje aksesor zyre;
10- Blerje tonera (*Blerje e përqëndruar*);
11- Blerje pajisje GPS (*Blerje e përqëndruar*);
12- Shpenzim për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit (*Blerje e përqëndruar*);
13- Blerje bileta transporti ndërkombëtar;
14- Blerje materiale dhe vegla pune për IT;
15- Mirëmbajtje kondicionerësh;
16- Blerje materiale elektrike, elektronike dhe ndriçimi;
17- Mbikqyrja e punimeve të rikonstruksionit të brendshëm për një pjesë të katit përdhe të godinës së ASHK-së Vlorë;
18- Blerje karburanti (*Blerje e përqëndruar*);
19- Mbikqyrja e punimeve të rpërforcimit dhe rikonstruksionittë godinës së Drejtorsë Vendore të ASHK-së Kukës;
20- Blerje telefon.
21- Blerje dosje/kuti arkive;
22- Sigurimi i godinave të ASHK (Blerje e përqëndruar);
23- Kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Rr Jordan-Misja;
24- Kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Vlorës;
25- Abonime në shtyp (Procedurë më vlerë nën 100.000 lekë që zhvillohet në fund të vitit aktual për vitin pasardhës);

- **Në proces procedurat e prokurimit për vitin 2025** me objekt:

1- Shpenzime për mirmbajtjen e pajisjeve të zyrave (printera-fotokopje) – (Priten orientime ose heqje pezullimi nga Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim vijimin e hapave të mëtejshme të procedurës);

2- Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi – (Në pritje të përfundimit të afateve të ankimit me qëllim publikimin e Njoftimit të fituesit përfundimtar dhe vijimin e hapave të mëtejshme të procedurës);
3- Kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit të brendshëm për një pjesë të katit përdhe të ASHK-së Vlorë .
4- Kolaudimi i punimeve të përforcimit dhe rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Kukës (Në pritje të përfundimit të punimeve të rikonstruksionit të godinës);

- Janë anuluar procedurat e prokurimit me objekt:

1- Rikonstruksioni i godinës së Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lushnje;
2- Rikonstruksioni i godinës së Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gjirokastër

- Janë të pa realizuara procedurat e prokurimit me objekt:

1- Shpenzime për libra dhe publikime profesionale;*
2- Blerje materiale për riparimin e rafteve të arkivës;*
3- Blerje kondicionerë;*
4- Blerje materiale për ambientet për pritjen me popullin;
5- Rikonstruksion i godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Elbasan (nuk është vijuar me zhvillimin e procedurës për shkak të mangësive në projekt);
6- Mbikqyrja e punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Elbasan;
7- Kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Elbasan;
8- Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca;*
9- Mbikqyrja e punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Lushnje;
10- Mbikqyrja e punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Gjirokastër;
11- Kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Lushnje;
12- Kolaudimi i punimeve të rikonstruksionit të godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Gjirokastër;
13- Blerje karta check in dhe badge;*
14- Blerje materiale te ndryshme per zyrat (brava dyersh, hidraulike, etj. ndertimi e vegla pune);*
15- Mirëmbajtje e sistemit ngrohës-ftohës (chilleri, fancoil kondicioner);
16- Blerje orendi zyre;*
17- Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore;*
18- Shpenzime për mirëmbajtje e rrjeteve hidraulike, elektrike etj;*
19- Sherbim per zevendesimin e bombulave te fikjes se zjarrit;*
20- Mirëmbajtje gjeneratori;*
21- Blerje për këndin e ndihmës së shpejtë dhe të tjera;*
22- Sherbime te printimit dhe publikimit;*
23- Blerje gjeneratore;*
24- Shpenzime për pritje e përcjellje;*

25- Shpenzime për dekorime të ndryshme;*
26- Shpenzime te tjera transporti;*
27- Shpenzime për shërbime speciale (Fushatë ndërgjegjësimi dhe sondazhi);*
28- Shpenzime per lyerje ambientesh;*
29- Shërbim transporti për aktive dhe materiale;*
30- Blerje Server Nas Storage për nevoja të Qendrës së Kadastrës Digjitale (Kërkuar specifikime teknike nga specialistët IT të QKD, për mallin objekt procedure) ;
31- Shërbim për organizim eventesh (foni, ndricim);*

* Procedura të pa realizuara, pasi nuk ka lindur nevoja për mallin/shërbimin/punimet objekt procedure.

**Sektori i Investimeve dhe Shërbimeve**

Viti 2024 për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) ka qenë një periudhë me zhvillime intensive në drejtim të rijetësimit dhe rikonstruksionit të godinave ekzistuese si dhe trajtimit të sfidave infrastrukturore që lidhen me ristrukturimin institucional. Këto veprime janë ndërmarrë me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe optimizimin e shërbimeve për qytetarë

Një pjesë e godinave të ASHK si ato ekzistuese, ashtu edhe ato që janë marrë së fundmi në përgjegjësi administrimi, janë godina të ndërtuara para viteve 90^të^ dhe mbartin problematika të amortizimit dhe, në kuadër të rijetësimit të tyre në funksion të nevojave të këtyre drejtorive, kanë pasur të nevojshëm rikonstruksionin e tyre. Në këtë drejtim, Sektori i Investimeve dhe Shërbimeve gjatë vitit 2024, në zbatim të detyrave të tij, është fokusuar në zërin "investime" me qëllim përfundimin e rikonstruksionit të disa godinave dhe fillimin e punës për zbatimin e projekteve për rikonstruksion për disa godina të drejtorive vendore, në vijim të përmbylljes së procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave nga sektori i prokurimeve.

Gjatë 2024 përfunduan punimet e rikonstruksionit në godinat, si vijon:

- Godina 6 katëshe e ASHK në rrugën "Jordan Misja", katër katet e para, (punimet për rikonstruksionin e kësaj godine, janë zhvilluar në dy faza); Pas përfundimit në janar 2024, të rikonstruksionit të katër kateve të godinës "Jordan Misja", Tiranë, u bë transferimi në këto ambiente i drejtorive vendore të ASHK Tiranë, (Jug, Veri, Rurale 1, Rurale 2, Kamëz Vorë), Durrës - Kavajë – Krujë, Vlorë dhe Shkodër.
- Godina e Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë, një pjesë e katit përdhe, kati i parë dhe i dytë (punimet për rikonstruksionin e kësaj godine, janë zhvilluar në dy faza); Punimet për rikonstruksionin e katit të parë, katit të dytë dhe një pjesë të katit përdhe, (pasi pjesa tjetër ishte në administrim të ADISA) të cilat kishin filluar më datë 14.07.2022, përfunduan në datë 29.03.2024.

Po ashtu gjatë vitit 2024, filluan punimet e rikonstruksionit për godinat, si vijon:

- Filluan punimet për rikonstruksionin e brendshëm, për pjesën e mbetur, të Godinës në rrugën "Jordan Misja", kati i pestë dhe i gjashtë;

- Filluan punimet për rikonstruksionin e brendshëm, për pjesën e mbetur, të katit përdhe të godinës së Drejtorisë Vendore të ASHK-s Vlorë (ish ADISA);
- Filluan punimet për rikonstruksionin e Godinës e Drejtorisë Vendore të ASHK Kukës.

Për vitin 2024 ishin parashikuar në projekt buxhet por edhe në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike kryerja e rikonstruksioneve të godinave për disa drejtori vendore, të cilat nuk u realizuan, si vijon:
- Rikonstruksioni i godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Gjirokastër
- Rikonstruksion i godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Elbasan
- Rikonstruksion i godinës së drejtorisë vendore të ASHK-së Lushnje

Ristrukturimi i ASHK, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 110, datë 16.07.2024, i ndryshuar, ka kërkuar nga ana e sektorit ndjekjen e procesit të bashkimit të disa drejtorive dhe zyrave vendore dhe ndjekjen e problematikës së gjetjes së hapësirave për të akomoduar punonjësit dhe arkivat e drejtorive dhe zyrave vendore që bashkoheshin. Nisur nga fakti që hapësirat e ambienteve të punës, në shumë prej drejtorive janë të kufizuara, procesi i ristrukturimit, u pasua nga nevoja për ambiente shtesë për drejtoritë vendore ku u shkrinë zyrat vendore duke thelluar edhe më shumë problematikën, për një pjesë të tyre, të cilat për shkak të nevojës për ambiente shtesë janë detyruar të sistemohen në ambiente me qira, në pamundësi për të gjetur ambiente të përshtatshme shtetërore.

Sa i takon plotësimit të kërkesave për mallra dhe shërbime, në zbatim të Udhëzimit nr. 2422, datë 20.11.2023 "Për zhvillimin e procedurave të Prokurimit në mënyrë të përqëndruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës", Sektori i Investimeve dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me strukturat e tjera në Drejtorinë e Përgjithshme, ka ndjekur dhe vlerësuar kërkesat e depozituara nga drejtoritë vendore, jo vetëm në kuadër të planifikimit në buxhet por, për disa nga zërat e buxhetit, edhe në kuadër të realizimit të procedurave të prokurimit në formën e blerjeve të përqëndruara nga Drejtoria e Përgjithshme.

**Sektori i Burimeve Njerëzore**

Raporti përfundimtar i sektorit të Burimeve Njerëzore për vitin 2024 pasqyron të gjithë veprimtaritë dhe zhvillimet kryesore të ndodhura gjatë vitit, me theks të veçantë në procesin e ristrukturimit të institucionit, i cili ndikoi drejtpërdrejt në organizimin, personelin dhe funksionet e sektorit.

Ky raport synon të japë një pasqyrë të qartë dhe të dokumentuar të situatës së burimeve njerëzore gjatë vitit 2024 dhe të japë rekomandime për përmirësim në vitin pasardhës.

**BURIMET NJERËZORE, REKRUTIMET DHE ECURITË DISIPLINORE.**

Me miratimin e strukturës dhe organikës së re të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, miratuar me Urdhrin nr.236, datë 22.12.2023 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kastrës, kanë pësuar ndryshime vetem 3 Drejtori si me poshte vijon;

- Drejtoria Vendore e ASHK-së Durrës
- Drejtoria Vendore e ASHK-së Vlorë
- Drejtoria Vendore e ASHK-së Shkodër

Si rezultat i ristrukturimit këto Drejtori kanë pësuar këto ndryshime në numër punonjësish.

- Numri total i pozicioneve në strukturë për DVASHK Durrës: (para 62 punonjës dhe pas 39 punonjës)
- Numri total i pozicioneve në strukturë për DVASHK Vlorë: (para 70 punonjës dhe pas 44 punonjës)
- Numri total i pozicioneve në strukturë për DVASHK Shkodër: (para 50 punonjës dhe pas 34 punonjës)

Me miratimin e strukturës dhe organikës së re të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, miratuar me Urdhrin nr.110, datë 16.07.2024 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës", i ndryshuar me urdhrin nr. 147 datë 01.08.2024, është krijuar një drejtori e re dhe shkrirja e drejtorive dhe zyrave vendore të ASHK, si vijon:

Krijimi i Drejtorisë së re, Drejtoria e Pronave Shtetërore.
Shkrirja e 2 drejtorive vendore të ASHK-së Kuçovë dhe Tepelenë.
Shkrirja e 8 zyrave vendore të ASHK-së si vijon:

- **Zyra Vendore Përmet** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gjirokastër.
- **Zyra Vendore Skrapar** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Berat.
- **Zyrat Vendore Gramsh, Librazhd dhe Peqin** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Elbasan.
- **Zyra Vendore Mallakastër** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Fier
- **Zyrat Vendore Devoll dhe Kolonjë** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Korçë.
- **Zyrat Vendore Has dhe Tropojë** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kukës
- **Zyrat Vendore Kurbin dhe Mirditë** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lezhë
- **Zyra Vendore Pukë** në varësi të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Shkodër

Si rezultat i ristrukturimit:

- Numri total i pozicioneve në strukturë: [para 1228 punonjës dhe pas 1178 punonjës
- Pozicione të shfuqizuara: 50 nga të cilat 21 Drejtoria e Përgjithshme dhe 29 Drejtoritë/Zyrat Vendore të ASHK-së;

  Punonjës që kanë dalë nga institucioni si pasojë e ristrukturimit: 31 punonjës
  Punonjës të strukturës që janë larguar me kërkesën e tyre: 107 punonjës
  Punonjës me kontratë të përkohshme që janë larguar me kërkesën e tyre: 38 punonjës

Për vitin 2024 në respektim të dispozitave të Kodit të Punës, për punonjësit e strukturës dhe ata me kontratë të përkohshme, Drejtoria e Përgjithhsme ka dhënë gjithsej  masa disiplinore, nga të cilat, 3 "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", 4 "Vërejtje me shkrim", 16 "Vërejtje", dhe 2 "Tërheqje vëmendje".

MASA DISIPLINORE 2024




Ligji nr.111/2018 "Për Kadastrën", Neni 11 "Marrëdhëniet e punës, kriteret, statusi dhe rekrutimi i punonjësve" në pikën 3 të tij parashikon një risi në lidhje me rekrutimin e burimeve njerëzore përkundër sa parashikonte legjislacioni përkatës mbi bazën e të cilit vepronin institucionet që u përfshinë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës ku parashikon që kandidatët për t'u punësuar pranë ASHK-së i nënshtrohen procedurës së konkurrimit.

Por duke qënë se institucioni ka kaluar dy ristrukturime brenda një viti, nuk është kryer asnjë procedurë rekrutimi me konkurs.

Në respektim të kësaj dispozite, duke marrë parasysh që ka një vakum aktesh nënligjore që rregullojnë këto aspekte të punësimit që lidhen me rekrutimin, etj., për institucionet ku marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës është e nevojshme të miratohen akte të brendshme ku të përcaktohen procedurat dhe modalitetet e nevojshme për tu respektuar në vijimësi

Duke patur në vëmendje të veçantë faktin që cilësia e burimeve njerëzore ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni i ASHK-së ku, pozicionimi i personelit është shumë i rëndësishëm pasi punonjës të caktuar mbulojnë detyra kyçe e zëvendësimi i tyre nuk është i lehtë dhe për më tepër kërkon një kosto shtesë edhe në trajnimin e punonjësve të rinj.

Duke vlerësuar sa më sipër, gjatë vitit 2024 i është dhënë përparësi rritjes së nivelit profesional të punonjësve, dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre. Një rëndësi e veçantë i është dhënë zhvillimit të trajnimeve të brendshme me karakter të posaçëm, që lidhen me kryerjen e detyrave të veçanta të punonjësve apo sektorëve të ndryshëm të drejtorive të ASHK-së. Me Urdhrin nr. 688, Datë 04.06.2024, është miratuar Programi dhe Kalendari Vjetor i Trajnimit të ASHK-së për vitin 2024. Ky program ka pasur 10 tema trajnimi.

Nga muaji Tetor 2024, muaj i cili jep efektin financiar në lidhje me strukturën e re, duke qene se Sektori i Trajnimit dhe Vlerësimit të Performancës është shkrirë dhe është krijuar Drejtori e re e emërtuar Drejtoria e Statistikave dhe Performancës, trajnimet i kanë kaluar në kompetencë kësaj drejtorie.

## X. ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I SISTEMEVE

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Sistemeve ka mbuluar me sukses të gjithë spektrin e funksioneve të saj për vitin 2024, duke ofruar asistencë teknike, administrim të sistemeve, si dhe menaxhimin e riskut, në mbështetje të funksionimit të drejtorive vendore të ASHK-së si dhe drejtorisë se pergjithshme.
Strukturimisht, drejtoria ndahet në dy sektorë:

1. Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut
2. Sektori i Asistencës Teknike

### I. SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË SISTEMEVE DHE VLERËSIMIT TË RISKUT

Ky sektor është përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemeve informatike, administrimin e përdoruesve, trajnimet dhe koordinimin me institucionet ndërvepruese. Ndër detyrat e kryera gjatë vitit 2024 përfshihen:

**1. Krijimi dhe administrimi i përdoruesve (userave)**

- Krijimi i përdoruesve të rinj për sistemet operative të ASHK
- Përfshirja e userave në organigramat përkatëse të drejtorive vendore
- Vendosja e privilegjeve të aksesit sipas profilit të punës dhe rolit institucional
- Çaktivizimi i përdoruesve në rastet e largimit apo ndryshimit të funksionit

**2. Zgjerimi dhe mirëmbajtja e strukturës institucionale në sistem**

- Krijimi dhe shtimi i institucioneve të reja në sistemet ASHK
- Përdorimi i një strukture hierarkike të saktë për menaxhimin e moduleve

**3. Trajnime të specializuara për përdorimin e sistemeve**

- Trajnime intensive për specialistët e drejtorive vendore: juristë, hartografë, finance, drejtorë dhe specialistë të tjerë
- Udhëzime praktike për përdorimin e moduleve të brendshme të sistemit dhe për raportimin e problematikave

**4. Menaxhimi i adresave elektronike (email):**

- Hapja dhe mbyllja e adresave zyrtare për punonjësit
- Reset i fjalëkalimeve dhe menaxhimi i aksesit në rast të bllokimeve ose ndryshimeve
- Koordinimi me AKSHI përmes HelpDesk për çdo problematikë me platformën email zyrtare (gov.al)

**5. Menaxhimi i komunikimeve dhe ndërveprimeve ndërinstitucionale**

- Administrimi i modulit ASHK-Institucione, për bashkëveprim të drejtpërdrejtë me njësi si:bashkitë, tatime, gjykata, ministritë, prokuroritë, etj.
- Verifikime të dokumenteve zyrtare dhe të certifikatave të pronësisë të dorëzuara nga institucione të treta përmes emailit zyrtar per AZHBR

**6. Suport për platforma e tjera**

- Mbështetje teknike për përdorues që aksesojnë:
  - Platformën e Bashkëqeverisjes – për gjithë Shqipërinë
  - FTP serverin – për transferimin dhe ndarjen e dokumenteve ndërmjet institucioneve
  - Platformën e Legalizimeve dhe sistemet përkatëse

**7. Menaxhimi i riskut në sistem**

- Auditime të brendshme për përdorimin e aksesit në sistem

- Hartimi i raporteve të sigurisë dhe rekomandimeve për mirëadministrimin e të dhënave

8. Përdorimi i emailit funksional: multifunksional@ashk.gov.al

Ky email është pikë kyçe komunikimi për:

- Problemikat e përditshme të sistemit nga çdo profil përdoruesi (juristë, hartografë, financa, drejtues, etj.)
- Problematikat e karakterit teknik dhe harduerik në drejtoritë vendore dhe qendrore
- Koordinimi për çështje që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme ose diagnostikim të detajuar

## II. Sektori i Asistencës Teknike

Ky sektor ka mbuluar të gjitha aspektet teknike që garantojnë funksionimin e infrastrukturës digjitale të ASHK-së, me fokus në mirëmbajtje, suport teknik dhe ndërhyrje në terren.

**1. Suport teknik i përditshëm**

- Asistencë me akses remote për përdorues në të gjithë Shqipërinë për problematika nga më të ndryshmet:
  - Instalime software-ësh
  - Lidhje printerash dhe skanerash
  - Konfigurime të rrjetit dhe privilegjeve në kompjuter
  - Azhornime dhe diagnostikime për kompjuterë që kanë ngadalësim ose ndërprerje funksioni

**2. Administrimi i rrjetit dhe pajisjeve në drejtoritë vendore**

- Instalimi i rrjeteve kompjuterike dhe konfigurimi i pajisjeve në terren
- Ndërtimi i një liste të centralizuar IP për të gjitha pajisjet në drejtoritë vendore dhe qendrore, për të mundësuar akses të shpejtë dhe ndërhyrje në kohë reale

**3. Mirëmbajtje dhe përditësim i faqes zyrtare të ASHK**

- Popullimi i përmbajtjes së re, përditësimi i strukturës dhe dizajnit
- Sigurimi i funksionimit të vazhdueshëm të webit dhe integrimi i përmbajtjeve të reja në kohë reale

**4. Raportim periodik i konsumit të energjisë**

- Hartimi dhe dërgimi i raporteve mujore për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha drejtoritë vendore

**Statistika për vitin 2024:**

- 650+ përdorues të rinj të krijuar në sistem
- 30+ trajnime dhe asistenca on-site për drejtori vendore
- 3,000+ ndërhyrje teknike remote për PC, printera, rrjet
- 6000+ kërkesa të adresuara në multifunksional@ashk.gov.al
- 700+ pajisje të formatuara dhe instaluara
- 650+ adresa email të reja të hapura dhe administruara

**Objektivat për vitin 2025**

- Automatizimi i raportimit të problematikave dhe klasifikimi sipas natyrës teknike ose sistemike
- Platformë unike për kërkesat teknike me sistem gjurmimi (ticketing system)
- Forcimi i sigurisë së rrjeteve dhe auditimi i aksesit në sistem
- Rritja e kapaciteteve për trajnime digjitale (online) në kohë reale
- Mbështetje më e strukturuar për institucionet ndërvepruese

Ky raport pasqyron përkushtimin dhe profesionalizmin e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Sistemeve për të garantuar që ASHK të funksionojë me standarde të larta teknologjike dhe organizative.

**EVIDENCA E PROCESIT TË INVENTARIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË PRONAVE SHTETËRORE**

**Drejtoria e Pronave Shtetërore**

Drejtoria e Pronave Shtetërore - është krijuar pranë ASHK-së me Urdhrin nr. 147, datë 1.8.2024, të Kryeministrit.
Drejtoria e Pronave Shtetërore është përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të inventarizimit/përditësimit të listave të inventarëve të pronave shtetërore nga institucionet shtetërore, qendrore, si dhe përditësimin e listave të pronave publike të shtetit, të transferuara në pronësi apo përdorim të njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim regjistrimin e tyre në regjistrin e pasurive të paluajtshme.
Ky proces kryhet në bashkëpunim me institucionet shtetërore, qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Gjatë vitit 2024, institucionet shtetërore për përditësimin e listave të inventarëve dhe regjistrimin e pronave të tyre kanë proceduar duke e ndarë punën në fasha, me nga 30 prona prioritare, të përzgjedhura nga secila ministri, dhe institucionet e tyre në varësi.
DPSH, pranë ASHK, ka bashkëpunuar me Strukturat e Posaçme të ngritura pranë institucioneve shtetërore, të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin kadastral publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.
Nga ana e DPSH-së është kryer trajnimi i Strukturave të Posaçme, të cilët janë njohur me procedurën që duhet të ndiqet nga ana e tyre për rishikimin e listave të pronave shtetërore sipas rregullave të përcaktuara në ligjn 20/2020, me qëllim hartimin e listave përfundimtare, pasi të jetë kryer përditësimi i plotë i informacionit mbi gjendjen faktike, si dhe mbi të drejtat apo detyrimet që rëndojnë mbi to.
Me asistencën e Drejtorisë së Pronave Shtetërore, nga ana e institucioneve shtetërore, është proceduar me tre kategorizime procesesh njëkohësisht: inventarizim/transferim; përditësim; dhe regjistrim. Me qëllim miratimin e listës së pronave shtetërore të përditësuar, institucionet shtetërore kanë plotësuar dokumentacionin tekniko-ligjor, të domosdoshëm, që ka shërbyer për hartimin e projekvendimeve që ASHK-ja, ka paraqitur për shqyrtim pranë Kryeministrit.

Konkretisht, gjatë vitit 2024 janë trajtuar për inventarizim/përditësim dhe regjistrim 375 prona të fashës së parë prioritare, nga të cilat:

- 298 prona janë certifikuar,
- për 70 prona, janë konstatuar problematika, dhe
- 11 prona në proces përditësimi, aktualisht janë për shqyrtim projektvendimet pranë Këshillit të Ministrave.

Më poshtë, në mënyrë të detajuar, paraqitet informacioni për Fashën e Parë, të pronave prioritare, sipas Instititucioneve Shtetërore:

| INSTITUCIONI | NR PRONAVE PRIORITARE | NR PRONAVE TE CERTIFIKUARA | NR PRONAVE PA DOKUMENTACION IN E PLOTE/PROBLEMATIKA | NR I PRONAVE NE PROCES HARTIMI I PROJEKT VENDIMIT | NR PRONAVE QE ESHTE DERGUAR PER MIRATIM PROJEKT VKM NE KM | NR PRONAVE MIRATUAR PROJEKT VKM NE KM |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KM | 44 | 44 | 0 | 0 | 12 | 12 |
| MAS | 32 | 32 | 0 | 0 | 19 | 19 |
| MSHMS | 32 | 27 | 5 | 0 | 21 | 21 |
| MIE | 32 | 18 | 7 | 0 | 14 | 7 |
| MEPJ | 22 | 22 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| MFE | 28 | 16 | 12 | 0 | 0 | 0 |
| MK | 31 | 25 | 9 | 0 | 20 | 20 |
| MTM | 30 | 23 | 7 | 0 | 20 | 20 |
| MB | 34 | 23 | 7 | 0 | 14 | 10 |
| MBZHR | 30 | 29 | 1 | 0 | 24 | 24 |
| MD | 30 | 19 | 11 | 0 | 0 | 0 |
| MM | 30 | 20 | 11 | 0 | 10 | 10 |
| Totali | 375 | 298 | 70 | 0 | 154 | 143 |

Paralelisht, ka vazhduar procesi për inventarizimin dhe përditësimin e pronës shtetërore për prona jashtë fashës prioritare, sipas kërkesave të institucioneve dhe bashkive, bazuar në kërkesat e tyre, rast pas rasti. Si rezultat janë përditësuar dhe regjistruar gjithsej 247 prona nëpërmjet miratimit të 26 VKM-ve:

- 20 VKM për Institucione Qendrore, me 227 prona
- 6 VKM për NJVV-të, me 20 prona.

Të detajuara këto të dhëna, sipas institucioneve shtetërore, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

| INSTITUCIONI | NR VKM TE MIRATUARA Viti 2024 | NR PRONAVE MIRATUARA ME VKM Viti 2024 |
|---|---|---|
| KM | 2 | 107 |
| MAS | | |
| MSHMS | 1 | 29 |
| MIE | 3 | 51 |
| MEPJ | | |
| MEKI | 2 | 2 |
| MF | | |
| MTM | | |
| MB | 1 | 1 |
| MBZHR | | |
| MD | 3 | 3 |
| MM | 1 | 11 |
| Bashki | 6 | 20 |
| Te pavarura | 7 | 23 |
| Totali | 26 | 247 |